

**URDHËR<sup>1</sup>**  
**Nr. 326, datë 29 8.2019**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR  
PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE  
ZBATUESE TË VLEFSHMËRISË AJRORE  
DHE TË CERTIFIKIMIT MJEDISOR TË  
MJETEVE FLUTURUESE DHE TË  
PRODUKTEVE QË KANË LIDHJE ME  
TO, PJSËVE DHE PAJISJEVE, SI DHE  
PËR CERTIFIKIMIN E ORGANIZATAVE  
TË PROJEKTIMIT DHE PRODHIMIT**

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të neneve 25, 28, 29 dhe 30 të ligjit nr. 10040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në përputhje me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një zone të përbashkët të aviacionit evropian”,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e rregullore “Për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor të mjeteve fluturuese dhe të produkteve që kanë lidhje me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe për certifikimin e organizatave të projektimit dhe prodhimit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

<sup>1</sup> Ky urdhër përaftron rregulloren e Komisionit (BE) nr. 748/2012 e datës 3 gusht 2012, për përcaktimin e rregullave të zbatimit të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor të avionëve dhe të produkteve që kanë lidhje me ta, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe për certifikimin e organizatave të projektimit dhe prodhimit, botuar në Fletoren Zyrtare të BE, L 224, 21.8.2012, f.1, e ndryshuar me rregulloret e Komisionit (BE) nr. 7/2013 e 8 janar 2013, nr.69/2014 e 27 janar 2014, nr. 2015/1039 e 30 qershor 2015 dhe nr. 2016/5 e 5 janar 2016, botuar në Fletoren Zyrtare të BE, L4, 9.1.2013, f.36; Fletoren Zyrtare të BE, L23, 28.1.2014, f.12, Fletoren Zyrtare të BE, L167, 1.7.2015, f.1 dhe Fletoren Zyrtare të BE, L3, 6.1.2016, f.3.

2. Urdhri i ministrit nr. 149, datë 7.4.2014 “Për miratimin e rregullore për përcaktimin e rregullave të zbatimit të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor të avionëve dhe të produkteve që kanë lidhje me ta, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe për certifikimin e organizatave të projektimit dhe prodhimit”, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Autoritetit i Aviacionit Civil për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE  
ENERGJISË

**Belinda Balluku**

**RREGULLORE**  
**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE ZBATUESE**  
**TË VLEFSHMËRISË AJRORE DHE TË**  
**CERTIFIKIMIT MJEDISOR TË MJETEVE**  
**FLUTURUESE DHE TË PRODUKTEVE QË KANË**  
**LIDHJE ME TO, PJSËVE DHE PAJISJEVE, SI DHE**  
**PËR CERTIFIKIMIN E ORGANIZATAVE TË**  
**PROJEKTIMIT DHE PRODHIMIT**

Neni 1

**Qëllimi dhe përkufizimet**

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, në përputhje me nenin 5 (5) dhe 6 (3) të udhëzimit të ministrit nr. 3, datë 7.2.2011 “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, i ndryshuar, në lidhje me:

- a) lëshimin e certifikatave të tipit, certifikatave të kufizuara të tipit, certifikatave plotësuese të tipit dhe ndryshimet në ato certifikata;
  - b) lëshimin e certifikatave të vlefshmërisë ajrore, certifikatave të kufizuara të vlefshmërisë ajrore, lejeve për të fluturuar dhe certifikatave të autorizuar të lejimit në shërbim;
  - c) lëshimin e miratimeve të projektit të riparimit;
  - d) demonstrimin e pajtueshmërisë me kërkesat e mbrojtjes së mjedisit;
  - e) lëshimin e certifikatave të zhurmës;
  - f) identifikimin e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve;
  - g) certifikimin e disa pjesëve dhe pajisjeve;
  - h) certifikimin e organizatave të projektimit dhe prodhimit;
  - i) lëshimin e direktivave të vlefshmërisë ajrore.
2. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:
- a) “AAC” nënkupton “Autoritetin e Aviacionit Civil Shqiptar.

b) “JAA” nënkupton “Autoritetet e Bashkuara të Aviacionit Civil”.

c) “JAR” nënkupton “Kërkesat e Përbashkëta të Aviacionit”.

d) Tjesa 21’ nënkupton kërkesat dhe procedurat për certifikimin e avionëve dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve që kanë lidhje me to, si dhe të organizatave të projektimit dhe prodhimit të përcaktuara në aneksin I të kësaj rregulloreje.

e) “Pjesa M” nënkupton kërkesat e zbatueshme të vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore të miratuara sipas udhëzimit të ministrit. nr. 3, datë 7.2.2011 “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”.

f) “Vendi kryesor i biznesit” nënkupton zyrën qendrore ose zyrën e regjistruar të ndërmarrjes në të cilën ushtrohen funksionet kryesore financiare dhe kontrolli operacional i aktiviteteve të përmendura në këtë rregullore.

g) “Artikull” nënkupton çdo pjesë dhe pajisje të përdorur në avionët civilë.

h) “Agjencia” nënkupton Agjencinë Evropiane të Sigurisë së Aviacionit (EASA) të krijuar me Rregulloren e Komisionit Evropian nr. 216, datë 20.2.2008.

i) “ETSO” nënkupton Urdhrin e Standardit Teknik Evropian. Urdhri i Standardit Teknik Evropian është një specifikim i detajuar i vlefshmërisë ajrore, i lëshuar nga Agjencia Evropiane e Sigurisë së Aviacionit (Agjencia) për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat e kësaj rregulloreje, si një standard minimal i performancës për nenet e specifikuara.

j) “MEP” nënkupton miratimin evropian të pjesës. Miratimi evropian i pjesës së një artikulli nënkupton që artikulli është prodhuar në përputhje me të dhënat e miratuara të projektimit që nuk i përkasin mbajtësit të certifikatës së tipit të produktit përkatës, me përjashtim të artikujve të ETSO-s.

k) “Avionët ELA1” nënkupton avionët e lehtë të pilotuar evropianë si më poshtë:

i) një aeroplan me një masë maksimale ngritjeje (MTOM) prej 1 200 kg ose më pak që nuk është klasifikuar si mjet ajror kompleks me fuqi motorike;

ii) një planer (glajder) apo një planer me motor me masë 1 200 kg ose më pak;

iii) një balonë me gaz e projektuar me kapacitet maksimal mbajtës të volumit të gazit ngritës ose ajrit të ngrohtë jo më shumë se 3 400 m<sup>3</sup> për balonat me ajër të nxehtë, 1 050 m<sup>3</sup> për balonat me gaz, 300 m<sup>3</sup> për balonat e lidhura me gaz;

iv) një aerostat i projektuar për jo më shumë se 4 persona dhe me një kapacitet maksimal të volumit të gazit ngritës ose ajrit të nxehtë prej jo më shumë se 3 400 m<sup>3</sup> për aerostatet me ajër të nxehtë dhe 1 000 m<sup>3</sup> për aerostatet me gaz;

l. “Avionët ELA 2” nënkupton avionët e lehtë të pilotuar evropianë si më poshtë:

i) një aeroplan me një masë maksimale ngritjeje (MTOM) prej 2 000 kg ose më pak që nuk është klasifikuar si avion kompleks me motor;

ii) një planer (glajder) ose planer me motor me një masë maksimale ngritjeje (MTOM) prej 2 000 kg ose më pak;

iii) një balonë;

iv) një aerostat me ajër të nxehtë;

v) një Aerostat me gaz në përputhje me të gjitha nga karakteristikat e mëposhtme:

- 3% peshë maksimale statike ,

- forcë shtytëse jo vektoriale (përveç forcës shtytëse të kundërt),

- projektim konvencional dhe të thjeshtë të: strukturës, sistemit të kontrollit dhe sistemit të ballonetit,

- kontrolle pa fuqi motorike ndihmëse;

vi) një Rotorcraft (helikopter ose xhironkraft) shumë i lehtë.

## Neni 2

### **Certifikimi i produkteve, pjesëve dhe pajisjeve**

1. Produkteve, pjesëve dhe pajisjeve u lëshohet certifikate siç specifikohet në aneksin I (pjesa 21).

2. Pa cenuar paragrafin 1, avionët, duke përfshirë çdo produkt, pjesë apo pajisje, të instaluar në to, të cilët nuk janë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë përjashtohen nga dispozitat e nënpjesëve H dhe I të pjesës 21. Ata, gjithashtu, përjashtohen nga dispozitat e nënpjesës P të aneksit I (Pjesa 21), përveç kur shenjat identifikuese të avionëve janë të përshkruara në urdhrin e ministrit nr. 113, datë 12/10/2012 “Për regjistrimin e avionëve civil shqiptar”.

## Neni 3

### **Vazhdueshmëria e vlefshmërisë së certifikatave të tipit dhe certifikatave përkatëse të vlefshmërisë ajrore**

1. Për sa u përket produkteve të cilët kanë pasur një certifikate tipi apo një dokument që lejon lëshimin e një certifikatë të vlefshmërisë ajrore, të lëshuar para 28

shtatorit 2003, zbatohen dispozitat e mëposhtme:

a) produkti konsiderohet të ketë një certifikate tip të lëshuar në përputhje me këtë rregullore kur:

i) baza e tij e certifikimit të tipit ka qenë:

- baza e certifikimit të tipit sipas JAA, për produktet që janë certifikuar sipas procedurave të JAA, siç përcaktohet në fletën e tyre të dhënave sipas JAA, ose

- për produktet e tjera, baza e certifikimit të tipit siç përcaktohet në fletën e të dhënave të certifikatës së tipit të Shtetit të projektimit, nëse ai Shtet projektimi ka qenë:

- Republika e Shqipërisë, një Shtet Anëtar i BE- së ose i ZPEA-së, sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, përveç nëse përkatësisht AAC ose Agjencia përcakton, duke marrë parasysh në veçanti specifikimet e certifikimit të përdorura dhe përvojën e shërbimit, që një bazë e tillë e certifikimit të tipit nuk siguron një nivel sigurie të barabartë me atë të kërkuar nga urdhri i ministrit nr. 3, datë 7.2.2011 “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil” dhe nga kjo Rregullore, ose

- një Shtet me të cilin Shqipëria ka lidhur një marrëveshje dypalëshe të vlefshmërisë ajrore ose një marrëveshje të ngjashme sipas të cilit produktet e tilla janë certifikuar në bazë të specifikimeve të certifikimit të atij Shteti të Projektimit, përveçse nëse AAC përcakton se këto specifikime certifikimi ose përvoja e shërbimit ose sistemi i sigurisë i atij Shteti të projektimit nuk siguron një nivel sigurie të barabartë me atë të kërkuar në urdhrin e ministrit nr. 3, datë 7.2.2011 “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil” dhe në këtë rregullore.

Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar (AAC) bën një vlerësim të parë të implikimit të dispozitave të paragrafit të dytë, në mënyrë që të japë një opinion për ministrin, duke përfshirë ndryshimet e mundshme të kësaj rregulloreje;

ii) kërkesat për mbrojtjen e mjedisit janë ato të përcaktuara në aneksin 16 të Konventës së Çikagos, siç aplikohen te produkti;

iii) direktivat e zbatueshme të vlefshmërisë ajrore kanë qenë ato të shtetit të projektimit.

b) projektimi i një avioni të vetëm, që është regjistruar në regjistër para 28 shtatorit 2003, miratohet sipas kësaj rregulloreje kur:

i) projekti bazë i tipit të tij të ketë qenë pjesë e certifikatës së tipit referuar pikës (a);

ii) të gjitha ndryshimet e këtij projekti bazë tip, të cilat nuk kanë qenë nën përgjegjësinë e mbajtësit të certifikatës tip, kanë qenë miratuar.

iii) direktivat e vlefshmërisë ajrore të lëshuara ose adoptuara nga shteti i regjistrit para 28 shtatorit 2003 kanë qenë në përputhje, duke përfshirë çdo ndryshim, me direktivat e vlefshmërisë ajrore të shtetit të projektimit të pranuar nga shteti i regjistrit.

2. Referuar produkteve për të cilat procesi i certifikimit tip është kryer më 28 shtator 2003, aplikohen sa më poshtë:

a) nëse një produkt është nën certifikim nga disa shtete, si referencë përdoret projekti më i avancuar;

b) pikat 21.A.15(a), (b) dhe (c) të aneksit I (pjesa 21) nuk aplikohen;

c) me përjashtim të pikës 21.A.17A të aneksit I (pjesa 21), baza e certifikimit të tipit është ajo e përcaktuar nga JAA ose, aty ku është e zbatueshme, nga Shteti Anëtar i BE-së ose ZPEA-ja, ose Republika e Shqipërisë në datën e aplikimit për miratim;

d) gjetjet e përputhshmërisë të bëra sipas procedurave të JAA ose të Shtetit Anëtar konsiderohen se janë bërë nga AAC ose Agjencia sipas rastit me qëllim të përputhjes me pikat 21.A.20 (a) dhe (d) të aneksit I (pjesa 21).

3. Referuar produkteve që kanë një certifikate tip kombëtare ose ekuivalente dhe për të cilat procesi i miratimit të një ndryshimi të kryer nga një shtet i BE-së nuk ka mbaruar në kohën kur certifikata e tipit duhet të ishte në përputhje me këtë rregullore, zbatohet sa më poshtë:

a) nëse është duke u kryer një proces miratimi nga disa shtete, si referencë përdoret projekti më i avancuar;

b) pika 21.A.93 e aneksit I (pjesa 21) nuk aplikohet;

c) bazat e aplikueshme të certifikimit tip përcaktohen nga JAA ose kur është e aplikueshme, nga AAC në datën e aplikimit për miratimin e ndryshimit;

d) gjetjet e përputhshmërisë të kryera nga procedurat e JAA ose AAC-së konsiderohen si të kryera nga Agjencia me qëllim përmbushjen e pikave 21.A.103(a)(2) dhe (b) të aneksit I (pjesa 21), nëse Shqipëria është asociuar në EASA.

4. Për sa u përket produkteve që kanë një certifikate tip kombëtare ose ekuivalente dhe për të cilat procesi i miratimit të riparimeve madhore projektuese nuk ka mbaruar në kohën kur certifikata tip duhet të përcaktohej në përputhje me këtë rregullore, gjetjet e përputhshmërisë sipas procedurave konsiderohen si të kryera nga AAC për të përmbushur pikat 21.A.433(a) të aneksit I (pjesa 21), ose EASA, nëse Shqipëria është asociuar në EASA.

5. Certifikata e vlefshmërisë ajrore e lëshuar nga AAC e cila vërteton përshtatshmërinë me certifikatën tip

të përcaktuar në përputhje me pikën 1, duhet të konsiderohet në përputhje me këtë rregullore.

#### Neni 4

##### **Vazhdueshmëria e vlefshmërisë së certifikatës tip plotësuese**

1. Referuar certifikatës tip plotësuese të lëshuar nga Republika e Shqipërisë sipas procedurave të JAA ose procedurave të zbatueshme kombëtare, referuar ndryshimeve të produkteve të propozuara nga persona të tjerë nga mbajtësit e certifikatës tip të produktit, që kanë qenë të miratuara sipas procedurave të aplikueshme kombëtare, n.q.s. certifikata tip plotësuese ose ndryshimi ka qenë i vlefshëm deri në 2003, certifikata tip plotësuese ose ndryshimi konsiderohen si të lëshuara sipas kësaj rregulloreje.

2. Referuar certifikatave tip plotësuese, për të cilat procesi i certifikimit është ndërmarrë në vitin 2003 sipas procedurave të aplikueshme të JAA për certifikatën tip plotësuese dhe referuar ndryshimeve madhore të produkteve të propozuara nga persona të tjerë nga mbajtësit e certifikatës tip të produktit, për të cilën procesi i certifikimit është ndërmarrë në vitin 2003 sipas procedurave të aplikueshme kombëtare, vepohet si më poshtë:

- a) n.q.s. procesi i certifikimit është ndërmarrë nga disa shtete, projekti më i avancuar përdoret si referencë;
- b) pikat 21.A.113 (a) dhe (b) të aneksit I (pjesa 21) nuk zbatohen;
- c) bazat e aplikueshme të certifikimit duhet të përcaktohen nga JAA ose kur është e aplikueshme nga AAC në datën e aplikimit për aprovimin e certifikatës tip plotësuese ose ndryshimeve madhore;
- d) gjetjet e përputhshmërisë të kryera nga procedurat kombëtare konsiderohen si të kryera nga AAC me qëllim përmbushjen e pikave 21.A.115(a) të aneksit I (pjesa 21).

#### Neni 5

##### **Vazhdueshmëria e vlefshmërisë së certifikatave të pjesëve dhe pajisjeve**

1. Miratimet e pjesëve dhe pajisjeve të lëshuara dhe të vlefshme në 28 shtator 2003 konsiderohen si të jenë lëshuar në përputhje me këtë rregullore.
2. Referuar pjesëve dhe pajisjeve, për të cilat procesi i miratimit ose autorizimit ka qenë i ndërmarrë më datë 28 shtator 2003, vepohet si më poshtë:

a) Nëse procesi i autorizimit është kryer nga disa shtete të ZPEA-së sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, si referencë përdoret projekti më i avancuar;

b) Pika 21.A.603 e aneksit I (pjesa 21) nuk aplikohet;

c) Kërkesat e të dhënave të zbatueshme të përcaktuara në pikën 21.A.605 të aneksit I (pjesa 21) janë ato të përcaktuara nga AAC, në datën e aplikimit për miratimin ose autorizimin.

d) Gjetjet e përputhshmërisë të bëra nga AAC konsiderohen si të bëra për përmbushjen e pikës 21.A.606(b) të aneksit I (pjesa 21).

#### Neni 6

##### **Leja e fluturimit**

1. Kushtet e përcaktuara për lejet e fluturimit ose certifikatat e tjera të vlefshmërisë ajrore të lëshuara për avionë të cilët nuk mbajnë një certifikate të vlefshmërisë ajrore ose një certifikate të kufizuar të vlefshmërisë ajrore sipas kësaj rregulloreje, konsiderohen si në përputhje me këtë rregullore, përveç kur AAC konstaton se këto kushte nuk provojnë një ekuivalent të nivelit të sigurisë të kërkuar nga udhëzimi i ministrit nr. 3, datë 7.2.2011 “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, ose nga kjo rregullore.

#### Neni 7

##### **Organizatat e projektimit**

1. Një organizatë përgjegjëse për projektimin e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve, ose për ndryshime ose riparimin e tyre duhet të vërtetojë aftësinë e saj në përputhje me aneksin 1 (pjesën 21).

2. Me përjashtim të paragrafit 1 të mësipërm, një organizatë, vendi kryesor i biznesit ose selia e së cilës është në çdo vend përveç Shqipërisë, mund të vërtetojë aftësinë e saj duke mbajtur një certifikate të lëshuar nga ai shtet për produktin, pjesën ose pajisjen për të cilën aplikon, me kusht që:

a) ai Shtet të jetë Shteti i projektimit; dhe

b) AAC, ose Agjencia nëse është e aplikueshme, të ketë përcaktuar që sistemi i atij shteti ka të njëjtin nivel pavarësie të kontrollit të pajtueshmërisë në përputhje me këtë rregullore, qoftë nëpërmjet një sistemi ekuivalent të miratimeve të organizatave ose nëpërmjet përfshirjes së drejtpërdrejtë të autoritetit kompetent të atij shteti.

3. Miratimet e organizatave të projektimit të lëshuara

ose të njohura nga Republika e Shqipërisë në përputhje me kërkesat dhe procedurat e JAA dhe të vlefshme para vitit 2003 duhet të konsiderohen se janë në përputhje me këtë rregullore.

#### Neni 7a

### **Të dhënat e përshtatshmërisë operacionale**

1. Mbajtësi i një certifikatë tip të avionit të lëshuar para datës 17 shkurt 2014 që synon të dorëzojë një avion të ri te një operator i Shqipërisë ose BE-së sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe pas 17 shkurtit 2014, duhet të marrë miratimin në përputhje me pikën 21.A.21 (e) të aneksit I (pjesa 21) me përjashtim të programit minimal të trajnimit për kualifikimin e personelit të caktuar për certifikimin e mirëmbajtjes dhe me përjashtim të të dhënave të burimit të vlefshmërisë së avionit për të mbështetur kualifikimin objektiv të simulatorit (-ëve). Miratimi do të merret përpara se avioni të përdoret nga një operator i Shqipërisë ose BE-së sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe cilado që është më e fundit. Të dhënat e përshtatshmërisë operacionale mund të kufizohen në modelin që është dorëzuar.

2. Aplikanti për një certifikatë tipi të avionit për të cilën është paraqitur kërkesa përpara 17 shkurtit 2014 dhe për të cilën nuk është lëshuar certifikata e tipit përpara 17 shkurtit 2014 duhet të marrë miratimin në përputhje me pikën 21.A.21 (e) të shtojcës I (pjesa 21) me përjashtim të programit minimal të trajnimit për kualifikimin e personelit të caktuar për certifikimin e mirëmbajtjes dhe me përjashtim të të dhënave të burimit të vlefshmërisë së avionit për të mbështetur kualifikimin objektiv të simulatorit (-ëve). Miratimi do të merret përpara se avioni të përdoret nga një operator i Shqipërisë ose BE-së sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, cilado që është më e fundit. Gjetjet e përputhshmërisë të bëra nga autoritetet në proceset e Bordit të Vlerësimit Operacional të kryera nën përgjegjësinë e JAA ose Agjencisë përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, pranohen nga Agjencia pa verifikime të mëtejshme.

3. Raportet e Bordit të Vlerësimit Operacional dhe master-listat e pajisjeve minimale të lëshuara në përputhje me procedurat e JAA ose Agjencisë përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje do të konsiderohen si të dhëna të përshtatshmërisë operacionale të miratuara në përputhje me pikën 21.A.21 (e) të aneksit I (pjesa 21) dhe duhet të përfshihen në certifikatën përkatëse të tipit.

4. Mbajtësit e një certifikatë të tipit duke përfshirë të dhënat e përshtatshmërisë operacionale duhet të marrin miratimin e një zgjatjeje të fushëveprimit të miratimit të organizatës së tyre të projektimit ose të procedurave alternative për miratimin e organizatës projektuese.

#### Neni 8

### **Organizatave të prodhimit**

1. Një organizatë përgjegjëse për prodhimin e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve vërteton aftësinë e saj në përputhje me dispozitat e pjesës 21.

2. Me përjashtim të paragrafit 1, një prodhues, vendi kryesor i biznesit ose selia e të cilit është në një shtet tjetër mund të demonstrojë aftësinë e tij duke mbajtur një certifikatë të lëshuar nga Shteti për produktin, pjesën dhe pajisjen për të cilën ai aplikon, me kusht që:

a) ai shtet të jetë shteti prodhues; dhe

b) AAC, ose Agjencia nëse është e aplikueshme, sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, të ketë përcaktuar që sistemi i atij Shteti ka të njëjtin nivel pavarësie të kontrollit të pajtueshmërisë në përputhje me këtë rregullore, qoftë nëpërmjet një sistemi ekuivalent miratimesh të organizatave ose nëpërmjet përfshirjes së drejtpërdrejt të autoritetit kompetent të atij Shteti.

3. Miratimet e organizatave të prodhimit të lëshuara ose të njohura nga Republika e Shqipërisë në përputhje me kërkesat dhe procedurat e JAA dhe të vlefshme para vitit 2003, konsiderohen si në përputhje me këtë rregullore.

#### Neni 9

### **Masat e AAC-së**

1. AAC, organizatat dhe personeli i tyre përdorin, për të vërtetuar përmbushjen e parashikimeve të aneksit I (pjesa 21) të kësaj rregulloreje, specifikimet e certifikimit, mjetet e pranuar të përputhshmërisë dhe materialet udhëzuese të hartuara nga Agjencia, sipas rishikimit të tyre të fundit.

2. Mjetet e pranuar të përputhshmërisë të lëshuara nga Agjencia as nuk shfaqin kërkesa të reja as nuk lehtësojnë kërkesat e aneksit I (pjesa 21) të kësaj rregulloreje.

3. Pa cenuar udhëzimin e ministrit nr. 3, datë 7.2.2011 "Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil", kur janë përdorur procedurat e pranueshme të pajtueshmërisë (mjetet e pranuar të

përputhshmërisë) të lëshuara nga Agjencia, kërkesat e lidhura me aneksin I (pjesa 21) të kësaj rregulloreje konsiderohen të plotësuara pa demonstrim të mëtejshëm.

Neni 10

### Dispozita kalimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, aplikantët ose mbajtësit e një lejeje fluturimi mund të vazhdojnë të përdorin shërbimet e pilotëve të angazhuar në kategorinë tre ose katër të testeve të fluturimit të përmendura në shtojcën XII të aneksit I të urdhrit të ministrit nr. 149, datë 7.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor të avionëve dhe të produkteve që kanë lidhje me ta, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe për certifikimin e organizatave të projektimit dhe prodhimit”, dhe të inxhinierëve të testit të fluturimit që zhvillonin aktivitetet e testimit të fluturimit në përputhje me rregullat e zbatueshme të ligjit kombëtar përpara kësaj date. Çdo përdorim i tillë mbetet i kufizuar në fushëveprimin e funksioneve të anëtarëve të ekuipazhit të fluturimit të testit të fluturimit siç është përcaktuar para 31 dhjetorit 2017.

Fushëveprimi i funksioneve të anëtarëve të ekuipazhit fluturues të testimit në fluturim përcaktohet nga aplikanti ose zotëruesi i një lejeje për të fluturuar që përdor ose planifikon të përdorë shërbimet e tyre, bazuar në përvojën dhe trajnimin e anëtarëve të ekuipazhit fluturues për testimin në fluturim dhe në të dhënat përkatëse të aplikantit ose zotëruesit të lejes për të fluturuar. Ky fushëveprim i funksioneve të një anëtari të ekuipazhit fluturues të testimit në fluturim i vihet në dispozicion autoritetit kompetent.

Çdo shtesë ose ndryshim tjetër në fushëveprimin e funksioneve të përcaktuara për këta anëtarë të ekuipazhit fluturues të testit në fluturim nga kërkuesi ose zotëruesi i një lejeje fluturimi që përdor ose planifikon të përdorë shërbimet e tyre, është në përputhje me kërkesat e shtojcës XII të aneksit I të urdhrit të ministrit nr. 149, datë 7.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor të avionëve dhe të produkteve që kanë lidhje me ta, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe për certifikimin e organizatave të projektimit dhe prodhimit”.

ANEKSI I

PJESA 21

## CERTIFIKIMI I MJETEVE FLUTURUESE DHE PRODUKTEVE, PLESËVE DHE PAJISJEVE PËRKATËSE, DHE I ORGANIZATAVE TË PROJEKTIMIT DHE PRODHIMIT

Përmbajtja

21.1 E përgjithshme

PJESA A - KËRKESAT TEKNIKE

NËNPJESA A - DISPOZITAT TË PËRGJITHSHME

21.A.1 Qëllimi

21.A.2 Nisma nga një person tjetër, përveç aplikantit ose mbajtësit të një certifikate

21.A.3A Dështimet, keqfunksionimet dhe defektet

21.A.3B Direktivat e Vlefshmërisë Ajrore

21.A.4 Koordinimi midis projektimit dhe prodhimit

NËNPJESA B - CERTIFIKATAT E TIPIT DHE

CERTIFIKATAT E TIPIT TË KUFIZUAR

21.A.11 Qëllimi

21 A. 13 Pranueshmëria

21.A.14 Demonstrimi i Kapacitetit

21.A.15 Aplikimi

21.A.16A Specifikimet e certifikimit

21.A.16B Kushtet e veçanta

21.A.17A Baza e Certifikimit të tipit

21.A.17B Baza e të dhënave të certifikimit për përshtatshmërinë operacionale

21.A.18 Përcaktimi i kërkesave të zbatueshme të mbrojtjes mjedisore dhe specifikimeve të certifikimit

21.A.19 Ndryshimet që kërkojnë një certifikatë tipi të re

21.A.20 Pajtuueshmëria me bazën e certifikimit të tipit, me bazën e të dhënave të certifikimit të përshtatshmërisë operacionale dhe me kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.

21.A.21 Lëshimi i një certifikate tip.

21.A.23 Lëshimi i një certifikate të kufizuar tipi

21.A.31 Projekti i tipit

21.A.33 Investigimi dhe provat

21.A.35 Provat e Fluturimit

21.A.41 Certifikata e tipit

21.A.44 Detyrimet e Mbajtësit

21 .A.47 Mundësia për t'u transferuar

21.A.51 Kohëzgjatja dhe vazhdueshmëria e vlefshmërisë

21.A.55 Mbajtja e të dhënave

21.A.57 Manualet

21.A.61 Udhëzimet për vazhdueshmëria e vlefshmërisë ajrore

21.A.62 Disponueshmëria e të dhënave të përshtatshmërisë operacionale

(NËNPJESA C - JO E ZBATUESHME)

NËNPJESA D - NDRYSHIMET NË CERTIFIKATAT E TIPIT DHE CERTIFIKATAT E TIPIT TË KUFIZUARA

- 21.A.90A Fushëveprimi
  - 21.A.90B Ndryshimet standarde
  - 21.A.91 Klasifikimi i ndryshimeve në një certifikatë tip
  - 21.A.92 Pranueshmëria
  - 21.A.93 Aplikimi
  - 21.A.95 Ndryshimet e vogla
  - 21.A.97 Ndryshimet madhore
  - 21.A.101 Përcaktimi i specifikimeve të zbatueshme të certifikimit dhe i kërkesave të mbrojtjes së mjedisit
  - 21.A.103 Lëshimi i miratimit
  - 21.A.105 Mbajtja e të dhënave
  - 21.A.107 Udhëzime për vazhdueshmëria vlefshmërisë ajrore
  - 21.A.108 Disponueshmëria e të dhënave të përshtatshmërisë operacionale
  - 21.A.109 Detyrimet dhe Shënjimi MEP
- NËNPJESA E - CERTIFIKATAT E TIPIT PLOTËSUESE
- 21.A.111 Fushëveprimi
  - 21.A.112A Pranueshmëria<sup>38</sup>
  - 21.A.112B Demonstrimi i aftësisë
  - 21.A.113 Aplikimi për një certifikatë tip plotësuese
  - 21.A.114 Tregimi i përpunueshmërisë
  - 21.A.115 Lëshimi i një certifikate tip plotësuese
  - 21.A.116 Mundësia për t'u transferuar
  - 21.A.117 Ndryshimet në atë pjesë të produktit që mbulohet nga një certifikatë e tipit plotësuese
  - 21.A.118A Detyrimet dhe shënjimi MEP
  - 21.A.118B Kohëzgjatja dhe vlefshmëria në vazhdueshmëri
  - 21.A.119 Manualet
  - 21.A.120A Udhëzimet për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore
  - 21.A.120B Disponueshmëria e të dhënave të përshtatshmërisë operacionale
- NËNPJESA F - PRODHIMI PA MIRATIMIN E ORGANIZATËS PRODHUESE
- 21.A.121 Qëllimi
  - 21.A.122 Pranueshmëria
  - 21.A.124 Aplikimi
  - 21.A.125A Lëshimi i një letërmarrëveshjeje
  - 21.A.125B Gjetjet
  - 21.A.125C Kohëzgjatja dhe vazhdueshmëria e vlefshmërisë
  - 21.A.126 Sistemi i inspektimit të prodhimit
  - 21.A.127 Provat: avionët

21.A.128 Provat: motorët dhe helikat

21.A.129 Detyrimet e prodhuesit

21.A.130 Deklarata e përputhshmërisë

NËNPJESA G - MIRATIMI I ORGANIZATËS PRODHUESE

21.A.131 Qëllimi

21.A.133 Pranueshmëria

21.A.134 Aplikimi

21.A.135 Lëshimi i miratimit të organizatës prodhuese

21.A.139 Sistemi i Cilësisë

21 A. 143 Manuali

21.A.145 Kërkesat e miratimit

21.A.147 Ndryshimet në organizatën prodhuese të miratuar

21.A.148 Ndryshimet e vendndodhjes

21.A.149 Mundësia për t'u transferuar

21.A.151 Kushtet e miratimit

21.A.153 Ndryshimet në kushtet e miratimit

21.A.157 Inspektimet

21.A.158 Gjetjet

21.A.159 Kohëzgjatja dhe vazhdueshmëria e vlefshmërisë

21.A.163 Privilegjet

21.A.165 Detyrimet e mbajtësit

NËNPJESA H - CERTIFIKATAT E VLEFSHMËRISË AJRORE DHE CERTIFIKATAT E KUFIZUARA TË VLEFSHMËRISË AJRORE

21.A.171 Qëllimi

21.A.172 Pranueshmëria

21.A.173 Klasifikimi

21.A.174 Aplikimi

21.A.175 Gjuha

21.A.177 Përmirësimi ose modifikimi

21.A.179 Mundësia për t'u transferuar dhe rilëshimi brenda Republikës së Shqipërisë

21.A.180 Inspektimet

21.A.181 Kohëzgjatja dhe vazhdueshmëria e vlefshmërisë

21.A.182 Identifikimi i avionit

NËNPJESA I - CERTIFIKATAT E ZHURMËS

21.A.201 Qëllimi

21.A.203 Mundësia për t'u zgjedhur

21.A.204 Aplikimi

21.A.207 Përmirësimi ose modifikimi

21.A.209 Mundësia për t'u transferuar dhe rilëshimi brenda Republikës së Shqipërisë

21.A.210 Inspektimet

21.A.211 Kohëzgjatja dhe vazhdueshmëria e vlefshmërisë

NËNPJESA J - MIRATIMI I ORGANIZATËS SË PROJEKTIMIT

21.A.231 Qëllimi	21.A.607 Privilegjet e autorizimit ETSO
21.A.233 Pranueshmëria	21.A.608 Deklarata e Projektimit dhe Performancës (DPP)
21.A.234 Aplikimi	21.A.609 Detyrimet e mbajtësve të autorizimeve ETSO
21.A.235 Lëshimi i miratimit të organizatës projektuese	21.A.610 Miratimi për devijimet
21.A.239 Sistemi i garantimit të projektit	21.A.611 Ndryshimet e projektit
21.A.243 Të dhënat	21.A.613 Ruajtja e të dhënave
21.A.245 Kërkesat e miratimit	21.A.615 Inspektimi nga AAC
21.A.247 Ndryshimet në sistemin e garantimit të projektit	21.A.619 Kohëzgjatja dhe vazhdueshmëria e vlefshmërisë
21.A.249 Mundësia e transferimit	21.A.621 Transferueshmëria
21.A.251 Kushtet e miratimit	NËN PJESA P - LEJA PËR FLUTURIM
21.A.253 Ndryshimet në kushtet e miratimit	21.A.701 Qëllimi
21.A.257 Investigimet	21.A.703 Pranueshmëria
21.A.258 Gjetjet	21.A.705 Autoriteti kompetent
21.A.259 Kohëzgjatja e vazhdueshmërisë së vlefshmërisë	21.A.707 Aplikimi për leje për fluturim
21.A.263 Privilegjet	21.A.708 Kushtet e fluturimit
21.A.265 Detyrimet e mbajtësit NËNPJESA K -	21.A.709 Aplikimi për miratimin e kushteve të fluturimit
PJESËT DHE PAJISJET 21.A.301 Qëllimi	21.A.710 Miratimi i kushteve të fluturimit
21.A.303 Pajtueshmëria me kërkesat e zbatueshme	21.A.711 Lëshimi i lejes për të fluturuar
21.A.305 Miratimi i pjesëve dhe pajisjeve	21.A.713 Ndryshimet
21.A.307 Lejimi për instalim i pjesëve dhe pajisjeve	21.A.715 Gjuha
(NËNPJESA L - NUK ËSHTË E ZBATUESHME)	21.A.719 Transferueshmëria
NËNPJESA M - RIPARIMET	21.A.721 Inspektimet
21.A.431 Qëllimi	21.A.723 Kohëzgjatja dhe vazhdueshmëria e vlefshmërisë
21.A.431B Riparimet standarde	21.A.725 Rinovimi i lejes për fluturim
21.A.432A Pranueshmëria	21.A.727 Detyrimet e mbajtësit të një lejeje për fluturim
21.A.432B Demonstrimi i aftësisë	21.A.729 Ruajtja e të dhënave
21.A.433 Projekti i riparimit	NËN PJESA Q - IDENTIFIKIMI I PRODUKTEVE,
21.A.435 Klasifikimi i riparimeve	PJESËVE DHE PAJISJEVE
21.A.437 Lëshimi i një miratimi të riparimit të projektit	21.A.801 Identifikimi i produkteve
21.A.439 Prodhimi i pjesëve riparuese	21.A.803 Trajtimi i të dhënave të identifikimit
21.A.441 Kryerja e riparimit	21.A.804 Identifikimi i pjesëve dhe pajisjeve
21.A.443 Kufizimet	21.A.805 Identifikimi i pjesëve kritike
21.A.445 Dëmtim i riparuar	21.A.807 Identifikimi i artikujve ETSO
21.A.447 Mbajtja e të dhënave	SEKSIONI B - PROCEDURAT PËR
21.A.449 Udhëzimet për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë	AUTORITETET
ajrore	KOMPETENTE
21.A.451 Detyrimet dhe Shënimi MEP (NËNPJESA	
N - NUK ËSHTË E ZBATUESHME)	
NËNPJESA O - AUTORIZIMET E URDHËRIT	
EVROPIAN TË STANDARDEVE TEKNIKE	
21.A.601 Qëllimi	
21.A.602A Pranueshmëria	
21.A.602B Demonstrimi i aftësisë	
21.A.603 Aplikimi	
21.A.604 Autorizimi ETSO për një njësi ndihmëse të	
fuqisë (APU)	
21.A.605 Kërkesa për të dhëna	
21.A.606 Lëshimi i autorizimit ETSO	



NËNPJESA A - PARIME TË PËRGJITH- SHME

21.B.5 Qëllimi

21.B.20 Detyrimet e autoritetit kompetent

21.B.25 Kërkesat për organizimin e AAC-së

21.B.30 Procedurat e dokumentuara

21.B.35 Ndryshime në organizim dhe procedura

21.B.40 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

21.B.45 Reporting/ coordination

21.B.55 Ruajtja e të dhënave

21.B.60 Direktivat e vlefshmërisë ajrore

NËN PJESA B - CERTIFIKATAT E TIPIT DHE  
CERTIFIKATAT E KUFIZUARA TË TIPIT

(NËNPJESA C - NUK ËSHTË E ZBATUESHME)

NËNPJESA D - NDRYSHIME TË CERTIFIKATAVE  
TIP DHE CERTIFIKA- TAVE TË KUFIZUARA TË  
TIPIT

21.B.70 Miratimi i ndryshimeve në certifikatat e tipit

NËNPJESA E - CERTIFIKATA TIP PLOTËSUESE

NËNPJESA F - PRODHIMI PA MIRATIMIN E  
ORGANIZATËS PRODHU- ESE

21.B.120 Investigimi

21.B.125 Gjetjet

21.B.130 Lëshimi i letër marrëveshjes

21.B.135 Ruajtja e letër marrëveshjes

21.B.140 Ndryshimi i një letër marrëveshjeje

21.B.145 Kufizimi, pezullimi dhe revokimi i letër  
marrëveshjes

21.B.150 Mbajtja e të dhënave

NËNPJESA G - MIRATIMI I ORGANIZA- TËS  
PRODHUESE

21.B.220 Investigimi

21.B.225 Gjetjet

21.B.230 Lëshimi i Certifikatës

21.B.235 Mbikëqyrja e vazhdueshme

21.B.240 Ndryshimi i miratimit të organizatës prodhuese

21.B.245 Pezullimi dhe revokimi i miratimit të  
organizatës prodhuese

21.B.260 Mbajtja e të dhënave

NËNPJESA H - CERTIFIKATAT E VLEFSHMËRISË  
AJRORE DHE CERTIFIKA- TAT E KUFIZUARA TË  
VLEFSHMËRISË AJRORE

21.B.320 Investigimi

21.B.325 Lëshimi i certifikatave të vlefshmërisë ajrore

21.B.326 Certifikata e vlefshmërisë ajrore

21.B.327 Certifikata e kufizuar e vlefshmërisë ajrore

21.B.330 Pezullimi dhe revokimi i certifikatave të  
vlefshmërisë ajrore dhe certifikatave të vlefshmërisë

ajrore të kufizuara

21.B.345 Ruajtja e të dhënave

NËNPJESA I - CERTIFIKATAT E ZHURMËS

21.B.420 Investigimi

21.B.425 Lëshimi i certifikatave të zhurmës

21.B.430 Pezullimi dhe revokimi i certifikatës së  
zhurmës

21.B.445 Ruajtja e të dhënave

NËNPJESA J - MIRATIMI I ORGANIZATËS  
PRODHUESE

NËNPJESA K - PJSËT DHE PAJISJET

(NËNPJESA L - NUK ËSHTË E ZBATUESHME)

NËNPJESA M - RIPARIMET

(NËNPJESA N - NUK ËSHTË E ZBATUESHME)

NËNPJESA O - AUTORIZIMET E URDRIT  
EVROPIAN TË STANDARDEVE TEKNIKE  
(NËNPJESA P - LEJA PËR FLUTURIM)

21.B.520 Investigimi

21.B.525 Lëshimi i lejeve për fluturim

21.B.530 Revokimi i lejeve për fluturim

21.B.545 Mbajtja e dokumentacionit

NËNPJESA Q - IDENTIFIKIMI I PRODUKTEVE,  
PJSËVE DHE PAJISJEVE

Shtojcat

Shtojca I

Shtojca II Certifikata e rishikimit të vlefshmërisë  
ajrore — forma 15a AAC/EASA

Shtojca III Leja për fluturim — forma 20a  
AAC/EASA

Shtojca IV Leja për fluturim — forma 20b  
AAC/EASA

Shtojca V Certifikata e kufizuar e vlefshmërisë ajrore  
— forma 24 AAC/EASA

Shtojca VI Certifikata e vlefshmërisë ajrore — forma  
25 AAC/EASA

Shtojca VII Certifikata e zhurmave — forma 45  
AAC/EASA

Shtojca VIII Deklarata e pajtueshmërisë së avionit —  
forma 52 AAC/EASA

Shtojca IX Certifikata e lejimit në shërbim — forma 53 AAC/EASA

Shtojca X Certifikata e miratimit të organizatës së prodhimit referuar në nënpjesën G të aneksit I (pjesa 21) — forma 55 AAC/EASA

Shtojca XI Letër marrëveshje — forma 65 AAC/EASA

Shtojca XII Kategoritë e testeve të fluturimit dhe të kualifikimeve përkatëse të ekuipazhit të testimi të fluturimit

### **21.1 E përgjithshme**

Për qëllimin e kësaj pjese, “Autoriteti Kompetent” është:

a) për organizatat që e kanë vendin e tyre kryesor të biznesit ose selinë në Republikën e Shqipërisë, është AAC; ose Agjencia, kur Shqipëria të jetë anëtare e Bashkimit Evropian ose EASA-s dhe kjo kërkohet nga Shqipëria;

b) për organizatat që e kanë vendin kryesor të tyre të biznesit në çdo vend që nuk është i Bashkimit Evropian ose i Zonës së Përbashkët Evropiane sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, është Agjencia dhe/ose AAC, sipas rastit;

Agjencia do të jetë autoriteti kompetent për Shqipërinë, kur Shqipëria të jetë vend anëtar i BE- së apo EASA-s dhe kur kjo të kërkohet nga Shqipëria.

Këto parashikime nuk kufizojnë të drejtën e një organizate të vendosur në Republikën e Shqipërisë, për sa kohë Republika e Shqipërisë është një vend i tretë për BE-në, për të pasur si Autoritet Kompetent Agjencinë.

#### **PJESA A - KËRKESAT TEKNIKE**

#### **NËNPJESA A - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

##### **21.A.1 Fushëveprimi**

Kjo pjesë vendos dispozita të përgjithshme që udhëheqin të drejtat dhe detyrimet e aplikantit, ose mbajtësit, për çdo certifikate të lëshuar ose që do të lëshohet në përputhje me këtë pjesë.

##### **21.A.2 Nisma nga një person tjetër, përveç aplikantit ose mbajtësit të një certifikatë**

Veprimet ose detyrimet e kërkuara që të ndërmerren nga një mbajtës ose aplikant për certifikatën e një produkti, pjese ose pajisjeje sipas kësaj pjese mund që të ndërmerren në emër të tij nga një person tjetër fizik ose juridik, me kusht që mbajtësi ose aplikanti për atë certifikate të mund të tregojë se ka bërë një marrëveshje

me personin tjetër në mënyrë që të garantohet se detyrimet e mbajtësit janë dhe përmbushen siç duhet.

##### **21.A.3 Dështimet, keqfunksionimet dhe defektet**

a) Sistemi për mbledhjen, investigimin dhe analizimin e të dhënave

Mbajtësi i një certifikate të tipit, certifikate tip të kufizuar, certifikate tip plotësuese, autorizimi të Urdhrit Evropian për Standarde Teknike (ETSO), miratimi të projektit të një riparimi madhor ose i çdo miratimi tjetër përkatës i konsideruar si i lëshuar sipas kësaj rregulloreje, ka një sistem për mbledhjen, investigimin dhe analizimin e raporteve dhe të informacionit që ka lidhje me dështimet, keqfunksionimet, defektet ose ngjarje të tjera të cilat shkaktojnë ose mund të shkaktojnë efekte të dëmshme në vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të produktit, pjesës ose pajisjes të mbuluar nga certifikata e tipit, certifikata e tipit e kufizuar, certifikata e tipit plotësuese, autorizimi ETSO, miratimi të projektit të riparimit madhor ose çdo miratim tjetër përkatës që konsiderohet se është lëshuar sipas kësaj rregulloreje. Informacioni rreth këtij sistemi vihet në dispozicion të të gjithë operatorëve të njohur të produktit, pjesës ose pajisjes dhe, me kërkesë të çdo personi të autorizuar sipas rregullave zbatuese bashkëshoqëruese.

b) Raportimi në AAC, ose në Agjenci, në varësi të faktit se cili është autoriteti kompetent përkatës.

1. Mbajtësi i një certifikate të tipit, certifikate tip të kufizuar, certifikate tip plotësuese, autorizimi të Urdhrit Evropian për Standarde Teknike (ETSO), miratimi të projektit të një riparimi madhor ose i çdo miratimi tjetër përkatës i konsideruar si i lëshuar sipas kësaj rregulloreje, raporton në AAC/ Agjenci çdo dështim, keqfunksionim, defekt ose ngjarje tjetër e cila është e lidhur me produktin, pjesën ose mjetin e mbuluar nga certifikata e tipit, certifikata e tipit e kufizuar, certifikata e tipit plotësuese, autorizimi ETSO, miratimi i projektit të riparimit madhor ose nga çdo miratim tjetër përkatës që konsiderohet se është lëshuar sipas kësaj rregulloreje dhe i cili ka rezultuar ose mund të rezultojë me një gjendje të pasigurt.

2. Këto raportime bëhen sipas një forme dhe mënyre të vendosur nga AAC/ Agjencia, sa më shpejt që të jetë praktike dhe në çdo rast të

raportuara jo më vonë se 72 orë pas identifikimit të gjendjes së mundshme të pasigurt, me përjashtim të rastit kur rrethana të jashtëzakonshme nuk e lejojnë këtë gjë.

c) Investigimi i ngjarjeve të raportuara.

1. Kur një ngjarje e raportuar sipas paragrafit (b), ose sipas pikës 21.A.129(f)(2) ose pikës 21.A.165(f)(2) rezulton se ka mangësi në projektim ose në prodhim, mbajtësi i certifikatës së tipit, certifikatës së tipit të kufizuar, certifikatës së tipit plotësuese, autorizimit ETSO, miratimit të projektit të një riparimi madhor, ose çdo miratimi tjetër përkatës i konsideruar si i lëshuar sipas kësaj rregulloreje, ose prodhuesi si të jetë më e përshtatshme, investigon arsyen e mangësisë dhe raporton tek AAC/ Agjencia rezultatet e investigimit të tij dhe çdo veprim që është duke marrë ose propozon të marrë për të korrigjuar atë mangësi.

2. Nëse AAC/ Agjencia zbulon se kërkohet një veprim për të korrigjuar mangësinë, mbajtësi i certifikatës së tipit, certifikatës së tipit të kufizuar, certifikatës së tipit plotësuese, autorizimit ETSO, miratimit të projektit të një riparimi madhor, ose i çdo miratimi tjetër përkatës i konsideruar si i lëshuar sipas kësaj rregulloreje, ose prodhuesi si të jetë më e përshtatshme, dorëzon të dhënat përkatëse tek AAC/ Agjencia.

#### **21.A.3B Direktivat e vlefshmërisë ajrore**

a) Një direktivë e vlefshmërisë ajrore nënkupton një dokument, të pranuar ose lëshuar përkatësisht nga AAC dhe/ose Agjencia, i cili urdhëron veprimet që do të kryhen në një avion, për të risjellë një nivel të pranueshëm të sigurisë në fluturim, ku në të kundërt të dhënat tregojnë se niveli i sigurisë i këtij avioni mund të komprometohet.

b) Agjencia ose edhe AAC, lëshon një direktivë të vlefshmërisë ajrore kur:

1. Nga Agjencia ose/ edhe AAC është përcaktuar se në avion ekziston një gjendje e pasigurt si rrjedhojë e një mangësie në avion, ose në një motor, helikë, pjesë ose pajisje të instaluar në këtë avion; dhe

2. Ajo gjendje ka të ngjarë të ekzistojë ose të zhvillohet në avionët e tjerë.

c) Kur nga Agjencia ose edhe AAC lëshohet një direktivë e vlefshmërisë ajrore për të korrigjuar gjendjen e pasigurt të cituar në paragrafin (b), ose për të kërkuar kryerjen e një inspektimi, mbajtësi i certifikatës së tipit, certifikatës së tipit të kufizuar, certifikatës së tipit plotësuese, miratimit të projektit të një riparimi madhor, autorizimit ETSO ose çdo miratimi tjetër përkatës të vlerësuar si të lëshuar sipas kësaj rregulloreje:

1. propozon veprimet korrigjuese të përshtatshme ose inspektimet e kërkuara, ose të dyja, si dhe paraqet për miratim detajet e këtyre propozimeve në AAC.

2. pas miratimit nga Agjencia ose edhe AAC të propozimeve të cituara sipas nënparagrafit (1), vendos në dispozicion të gjithë operatorëve të njohur ose pronarëve të produktit, pjesës ose pajisjes dhe, me kërkesë, të çdo personi nga i cili kërkohet që të pajtohet me direktivën e vlefshmërisë ajrore, të dhëna përshkruese të përshtatshme dhe udhëzime të përmbushjes.

d) Një direktivë e vlefshmërisë ajrore përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

1. Një identifikim të gjendjes së pasigurt;

2. Një identifikim të avionit të prekur;

3. Veprimin (veprimet) e kërkuar;

4. Kohën e përputhjes me veprimin (veprimet) e kërkuar;

5. Datën e hyrjes në fuqi.

#### **21.A.4 Koordinimi midis projektimit dhe prodhimit**

Çdo mbajtës i certifikatës së tipit, certifikatës së tipit të kufizuar, certifikatës së tipit plotësuese, autorizimit ETSO, miratimit të një ndryshimi në projektin e tipit ose miratimit të një projekti riparimi, bashkëpunon me organizatën prodhuese sipas nevojës për të siguruar:

a) Koordinimin e kënaqshëm të projektimit me prodhimin të kërkuar nga pika 21.A.122 ose pika 21.A.130(b)(3) dhe (4), si dhe nga pika 21.A.165(c) (2) dhe (3), sipas nevojës, dhe;

b) Mbështetjen e duhur për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të produktit, pjesës ose pajisjes.

**NËNPJESA B - CERTIFIKATAT E TIPIT DHE CERTIFIKATAT E TIPIT TË KUFIZUAR**

#### **21.A.11 Fushëveprimi**

Kjo nënpjesë vendos procedurën për lëshimin e certifikatave tip për produktet dhe certifikatat e tipit të kufizuara për avionët, si dhe vendos të drejtat dhe detyrimet e aplikantëve dhe mbajtësve të këtyre certifikatave.

## 21 A. 13 Pranueshmëria

Çdo person fizik ose juridik, që ka demonstruar ose është në proces demonstrimi të aftësisë së tij në përputhje me pikën 21.A.14, do të ketë mundësi të pranohet si një aplikant për një certifikate tip ose një certifikate tip të kufizuar sipas kushteve të parashtruara në këtë nënpjesë.

### 21.A.14 Vërtetimi i kapacitetit

a) Çdo organizatë që aplikon për një certifikate tip ose certifikate tip të kufizuar, dëshmon aftësinë e saj duke pasur një miratim të organizatës projektuese, të lëshuar nga Agjencia ose edhe AAC në përputhje me nënpjesën J.

b) Me përjashtim të paragrafit (a), si një procedurë alternative për të dëshmuar aftësinë e tij, një aplikant mund të kërkojë miratimin e Agjencisë ose edhe AAC-së për përdorimin e procedurave që përcaktojnë praktikatat specifike të projektimit, burimet dhe rendin e aktiviteteve të nevojshme për t'u pajtuar me këtë aneks I (pjesa 21), kur produkti është një prej sa më poshtë:

1. Një avion ELA 2;
2. Një motor ose helikë e instaluar në avionin ELA 2;
3. Një motor me piston;
4. Një helikë me krah rrotullimi aksial të fletës, fiks ose të ndryshueshëm.

c) Me përjashtim të paragrafit (a), një aplikant mund të zgjedhë për vërtetimin e aftësive duke i dhënë Agjencisë ose edhe AAC-së një program certifikimi të kërkuar sipas pikës 21.A.20 (b) kur produkti është një prej sa më poshtë:

1. Një avion ELA 1;
2. Një motor apo helikë e instaluar në një avion ELA 1.

### 21.A.15 Aplikimi

a) Një aplikim për një certifikate tip ose një certifikate tip të kufizuar bëhet sipas formës dhe mënyrës së përcaktuar nga Agjencia ose edhe AAC.

b) Një aplikim për një certifikate tip të avionit ose një certifikate tip të kufizuar shoqërohet me një vizatim tredimensional të atij avioni dhe të dhëna paraprake bazë, duke përfshirë karakteristikat operuese dhe kufizimet e propozuara.

c) Një aplikim për një certifikate tip për një motor ose një helikë shoqërohet nga një vizatim i përgjithshëm përgatitor, një përshkrim të tipareve projektuese, karakteristikat operuese dhe kufizimet operuese të propozuara të motorit ose helikës.

d) Një aplikim për një certifikate tip ose për një certifikate të kufizuar të tipit për një avion përfshin ose plotësohet, pas aplikimit fillestar, me aplikimin për miratimin e të dhënave për përshtatshmërinë operacionale që, sipas rastit, përbëhet nga:

1. Programi minimal i trajnimit të pilotit sipas kategorizimit të tipit, duke përfshirë përcaktimin e kategorizimit të tipit;

2. Përcaktimi i fushëveprimit të burimit të të dhënave të vlefshmërisë së avionëve për të mbështetur kualifikimin objektiv të simulatorëve të lidhur me trajnimin e kategorizimit të tipit të pilotit ose të të dhënave të përkohshme për të mbështetur kualifikimin e tyre të përkohshëm;

3. Programi minimal i trajnimit të kategorisë së tipit të personelit të mirëmbajtjes, duke përfshirë përcaktimin e kategorisë së tipit;

4. Përcaktimi i tipit ose i variantit për ekuipazhin e kabinës dhe të dhënat specifike sipas tipit për ekuipazhin e kabinës;

5. Lista kryesore e pajisjeve minimale; dhe

6. Elementë të tjerë të përshtatshmërisë operacionale të lidhura me tipin.

### 21.A.16A Specifikimet e certifikimit

AAC sipas orientimeve të Agjencisë, harton specifikimet e certifikimit në përputhje me nenin 19 të urdhrin të ministrit nr. 3, datë 7.2.2011 “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, duke përfshirë specifikimet e certifikimit për të dhënat e përshtatshmërisë operacionale që transponon rregulloren (EC) 216/2008, si mjete standarde për të dëshmuar përputhshmërinë e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve me kërkesat përkatëse thelbësore të aneksit I, III dhe IV të urdhrin të ministrit nr. 3, datë 7.2.2011 “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”. Këto specifikime janë mjaft të hollësishme dhe specifike për t'i treguar aplikantëve kushtet sipas të cilave lëshohen, ndryshohen ose plotësohen certifikatat.

### 21.A.16B Kushtet e veçanta

a) AAC, sipas orientimeve të Agjencisë, përshkruan specifikime teknike të detajuara, me kushte të veçanta, për një produkt nëse specifikimet e certifikimit që lidhen me të nuk përmbajnë standarde të përshtatshme të sigurisë për produktin, sepse:

1. Produkti ka karakteristika të reja ose të pazakonta të projektimit në lidhje me praktikatat e

projektimit në të cilat bazohen specififikimet e zbatueshme të certifikimit; ose

2. Përdorimi i synuar i produktit është i pazakontë; ose

3. Përvoja nga produkte të tjera të ngjashme në shërbim ose produkte që kanë karakteristika të ngjashme të projektimit, ka treguar se mund të zhvillohen kushte të pasigurta.

Kushtet e veçanta përmbajnë standarde të tilla të sigurisë që Agjencia dhe, ose AAC i konsideron të nevojshme për të vendosur një nivel sigurie të barasvlershëm me atë të përcaktuar në specififikimet e zbatueshme të certifikimit.

#### **21.A.17A Baza e certifikimit të tipit**

a) Baza e certifikatës së tipit për t'u përdorur për lëshimin e një certifikatë tip ose një certifikatë tip të kufizuar përbëhet nga:

1. Specifikimet e zbatueshme të certifikimit të përcaktuara nga Agjencia ose AAC, që janë efektive në datën e aplikimit për atë certifikate përveç nëse:

i) është specifikuar ndryshe nga Agjencia ose AAC; ose

ii) pajtueshmëria me specififikimet e certifikimit ose me ndryshimet efektive të mëvonshme zgjidhet nga aplikanti ose kërkohet sipas pikave (c) dhe (d);

2. Çdo kusht i veçantë i përshkruar në përputhje me pikën 21.A.16B(a).

b) Një aplikim për një certifikate tip të aeroplanëve të mëdhenj dhe helikopterëve të mëdhenj është i vlefshëm për pesë vjet dhe një aplikim për çdo certifikate tjetër tip është efektiv për tre vjet, me përjashtim të rastit kur një aplikant tregon në kohën e aplikimit që produkti i tij kërkon një periudhë më të madhe kohore për projektimin, zhvillimin dhe testimin dhe Agjencia ose/ edhe AAC miraton një periudhë më të gjatë.

c) Në rastin kur një certifikate e tipit nuk është lëshuar, ose është e qartë se një certifikate e tipit nuk do të lëshohet, brenda periudhës kohore të vendosur nga paragrafi (b), aplikanti mundet që:

1. Të dorëzojë një aplikim të ri për një certifikate tip dhe të jetë në përputhje me të gjitha dispozitat e paragrafit (a) që janë të zbatueshme për një aplikim origjinal; ose

2. Të paraqesë një kërkesë për një zgjatje të aplikimit origjinal dhe të përputhjet me specififikimet e zbatueshme të certifikimit të cilat kanë qenë efektive në një datë, që do të përzgjidhet nga aplikuesi, duhet të dorëzohet jo më herët se data që i paraprin datës së lëshimit të certifikatës së tipit brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën (b) për

aplikimin fillestar.

Nëse aplikanti përzgjedh të jetë në përputhje me një specifikim certifikimi të një amendimi në kodet e vlefshmërisë ajrore, i cili është efektiv pas dorëzimit të aplikimit për një certifikate të tipit, aplikanti do të jetë në përputhje gjithashtu me çdo specifikim certifikimi tjetër që AAC dhe/ose Agjencia mendon se ka lidhje të drejtpërdrejtë.

#### **21.A.17B Baza e të dhënave të certifikimit për përshtatshmërinë operacionale**

a) AAC ose Agjencia, sipas rastit i komunikon aplikuesit bazën e të dhënave të certifikimit për përshtatshmërinë operacionale. Ajo përbëhet nga:

1. Specifikimet e zbatueshme të certifikimit për të dhënat e përshtatshmërisë operacionale të hartuara në përputhje me pikën 21.A.16A që janë efektive në datën e aplikimit ose të shtojcës së aplikimit, përveç në rastet kur:

i) Agjencia ose AAC pranon mjete të tjera për të demonstruar përputhshmërinë me kërkesat thelbësore përkatëse të anekseve I, III dhe IV të urdhrat të ministrit nr. 3, datë 7.2.2011 "Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil"; ose

ii) Pajtueshmëria me specififikimet e certifikimit ose të ndryshimeve të mëvonshme efektive zgjidhet nga aplikanti;

2. Çdo kusht i veçantë i përshkruar në përputhje me pikën 21.A.16B(a).

b) Nëse një aplikant vendos të jetë në përputhje me një ndryshim të specifikimeve të certifikimit që është efektiv pas aplikimit të kërkesës për një certifikate të tipit, aplikanti duhet të jetë gjithashtu në përputhje me çdo specifikim tjetër të certifikimit që Agjencia ose AAC e konstaton se ai lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë.

#### **21.A.18 Përcaktimi i kërkesave të zbatueshme të mbrojtjes mjedisore dhe specifikimeve të certifikimit**

a) Kërkesat e zbatueshme të zhurmës për lëshimin e një certifikatë tip për një avion janë të përshkruara sipas dispozitave të kapitullit 1 të aneksit 16, volumnit I, pjesa II të Konventës së Çikagos dhe:

1. Për aeroplanët me shpejtësi më të ulët se të zërit (subsonikë), në volumnin I, pjesa II, kapitujt 2, 3, 4 dhe 14 sipas rastit;

2. Për aeroplanët me helikë, në volumnin I, pjesa II, kapitujt 3, 4, 5, 6, 10 dhe 14, sipas rastit;

3. Për helikopterët, në volumnin I, pjesa II, kapitujt 8 dhe 11, sipas rastit;

4. Për aeroplanët me shpejtësi më të madhe se të zërit (supersonikë), në volumnin I, pjesa II, Kapitulli 12, sipas rastit; dhe

5. Për rotorët e pjerrësisë, në vëllimin I, pjesa II, kapitulli 13, sipas rastit.

b) Kërkesat e zbatueshme për emetimin e gazrave për lëshimin e një certifikate tip për një avion dhe motor janë të përshkruara në aneksin 16 të Konventës së Çikagos:

1. Për parandalimin e shkarkimit të qëllimshëm të karburantit në volumnin II, pjesa II, kapitulli 2;

2. Për emetimet e gazrave të motorëve turbo- reaktivë dhe turbo-helikë të synuar për forcë shtytëse vetëm në shpejtësi supersonike, në volumnin II, pjesa III, kapitulli 2; dhe

3. Për emetimet e gazrave të motorëve turbo- reaktivë dhe turbo-helikë të synuar për forcë shtytëse vetëm në shpejtësi supersonike, në volumnin II, pjesa III, kapitulli 3.

c) AAC lëshon, në përputhje me udhëzimin e ministrit nr. 3, datë 7.2.2011 “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, specifikime certifikimi duke siguruar mjete të pranueshme për të demonstruar pajtueshmërinë me kërkesat e zhurmës dhe të emetimit të gazrave të parashtruara në paragrafët (a) dhe (b) respektivisht.

#### **21.A.19 Ndryshimet që kërkojnë një certifikatë tipi të re**

Çdo person fizik ose juridik që propozon të ndryshojë një produkt, aplikon për një certifikatë tipi të re nëse AAC dhe/ose Agjencia zbulon se ndryshimi në projekt, fuqi, shtytje ose peshë është aq i madh sa që të kërkohej një investigim i plotë tërësor i pajtueshmërisë me bazën përkatëse të certifikimit të tipit.

#### **21.A.20 Pajtueshmëria me bazën e certifikimit të tipit, me bazën e të dhënave të certifikimit të përshtatshmërisë operacionale dhe me kërkesat për mbrojtjen e mjedisit**

a) Aplikanti për një certifikatë të tipit ose për një certifikatë të kufizuar të tipit demonstron pajtueshmërinë me bazën e zbatueshme të certifikimit të tipit, me bazën e të dhënave të certifikimit të përshtatshmërisë operacionale dhe me kërkesat për mbrojtjen e mjedisit dhe furnizon AAC-në dhe/ose Agjencinë me mjetet me të cilat është demonstruar përputhshmëria.

b) Aplikanti i jep AAC-së dhe/ose Agjencisë një

program certifikimi duke detajuar mjetet për demonstrimin e pajtueshmërisë. Ky dokument përditësohet sipas nevojës gjatë procesit të certifikimit.

c) Aplikanti shënon justifikimin e pajtueshmërisë në dokumentin e pajtueshmërisë në përputhje me programin e certifikimit të vendosur sipas paragrafit (b).

d) Aplikanti deklaron që ai ka demonstruar pajtueshmërinë me bazën e zbatueshme të certifikimit të tipit dhe kërkesat e mbrojtjes së ambientit, në përputhje me programin e certifikimit të përcaktuar sipas paragrafit (b).

e) Atëherë kur aplikanti mban një miratim të përshtatshëm të organizatës projektuese, deklarimi sipas paragrafit (d) bëhet sipas dispozitave të nënpjesës J.

#### **21.A.21 Lëshimi i një certifikate tip**

Aplikantit i jepet e drejta të ketë një certifikatë tip për një produkt të lëshuar nga AAC dhe/ose Agjencia pasi:

a) Të ketë demonstruar aftësinë e tij në përputhje me pikën 21.A.14;

b) Të ketë dorëzuar deklaratën e cituar te pika 21 A20(d); dhe

c) Ka treguar se:

1. Produkti që do të certifikohet i plotëson bazat e zbatueshme të certifikimit të tipit dhe kërkesat e mbrojtjes mjedisore të përcaktuara në përputhje me pikat 21.A.17A dhe 21.A.18;

2. Çdo dispozitë e vlefshmërisë ajrore e cila nuk është përmbushur është kompensuar nga faktorë që garantojnë një nivel ekuivalent sigurie;

3. Asnjë tipar ose karakteristikë e bën atë të pasigurt për përdorimet për të cilat është kërkuar certifikimi; dhe

4. Aplikanti i certifikatës tip ka deklaruar shprehimisht se është i përgatitur për t'u pajtuar me pikën 21 A.44.

d) Në rastin e një certifikate tip për një avion, motor ose helikë, ose të dyja, nëse janë të instaluar në avion, kanë një certifikatë tip të lëshuar ose përcaktuar në përputhje me këtë rregullore.

e) Në rastin e një certifikate të tipit të avionit, demonstron se të dhënat e përshtatshmërisë operacionale plotësojnë bazën e zbatueshme të certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operacionale të përcaktuara në përputhje me pikën 21.A.17B.

f) Me përjashtim të pikës (e) dhe me kërkesë të aplikantit të përfshirë në deklaratën e përmendur në pikën 21.A.20(d), një certifikatë tipi të avionit mund të lëshohet para se të demonstrohet përputhshmëria me bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operacionale, me kusht që aplikanti të demonstrojë përputhshmërinë me bazën e certifikimit të të dhënave të përshtatshmërisë operacionale para se të përdoren të dhënat e përshtatshmërisë operacionale.

#### **21.A.23 Lëshimi i një certifikate tipi të kufizuar**

a) Për një avion që nuk plotëson dispozitat e pikës 21.A.21(c), aplikanti ka të drejtë të ketë një certifikatë të kufizuar të tipit të lëshuar nga AAC dhe/ose Agjencia;

1. pas përputhshmërisë me bazën e duhur të certifikimit të tipit të përcaktuar nga AAC dhe/ose Agjencia duke garantuar siguri të përshtatshme në lidhje me përdorimin e parashikuar të avionit dhe me kërkesat e zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit;

2. pasi të ketë deklaruar shprehimisht se është i përgatitur të jetë në përputhje me pikën 21.A.44;

3. në rastin e një certifikate të kufizuar të tipit të avionit, pasi të ketë demonstruar se të dhënat e përshtatshmërisë operacionale plotësojnë bazën e zbatueshme të të dhënave të certifikimit të përshtatshmërisë operacionale të përcaktuara në përputhje me pikën 21.A.17B.

b) Me përjashtim të pikës 3, shkronja (a), me kërkesë të aplikantit të përfshirë në deklaratën e përmendur në pikën 21.A.20(d), mund të lëshohet një certifikatë e kufizuar e tipit para se të demonstrohet përçueshmëria me bazën e zbatueshme të të dhënave të certifikimit të përshtatshmërisë operacionale, me kusht që aplikanti të demonstrojë përputhshmërinë me bazën e të dhënave të certifikimit të përshtatshmërisë operacionale para se të përdoren të dhënat e përshtatshmërisë operacionale.

c) Motori ose helika e instaluar në avion, ose të dyja, duhet të:

1. kenë një certifikatë të tipit të lëshuar ose të vendosur në përputhje me këtë Rregullore; ose

2. kenë vërtetuar se janë në përputhje me specifikimet e certifikimit të nevojshme për të garantuar fluturimin e sigurt të avionit.

#### **21.A.31 Projekti i tipit**

a) Projekti i tipit përbëhet nga:

1. Vizatimet, specifikimet dhe një listë të atyre

vizatimeve dhe specifikimeve, të nevojshme për të përcaktuar konfigurimin dhe tiparet e projektimit të produktit që pajtohen me bazën e zbatueshme të certifikimit të tipit dhe kërkesat e mbrojtjes mjedisore;

2. Informacioni mbi materialet, proceset dhe mbi metodat e prodhimit dhe montimit të produktit të cilat janë të nevojshme për të siguruar konformitetin e produktit;

3. Një seksion i miratuar i kufizimeve të vlefshmërisë ajrore të udhëzimeve për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore siç përcaktohet nga specifikimet e zbatueshme të certifikimit; dhe

4. Çdo e dhënë tjetër e nevojshme që lejon me anë të krahasimit, përcaktimin e vlefshmërisë ajrore, karakteristikave të zhurmës, derdhjes së karburantit dhe emetimeve të gazrave të shkarkuara (atje ku është e përshtatshme) të produkteve të mëvonshme të të njëjtit tip.

b) Çdo projekt tipi identifikohet në mënyrë të përshtatshme.

#### **21.A.33 Investigimi dhe provat**

a) Aplikanti kryen të gjitha inspektimet dhe provat e nevojshme për të treguar pajtueshmërinë me bazën e zbatueshme të certifikimit tip dhe kërkesat e mbrojtjes mjedisore.

b) Përpara se të ndërmerret çdo provë e kërkuar nga paragrafi (a), aplikanti përcakton:

1. Për kampionin në provë:

i) Që materialet dhe proceset pajtohen në mënyrë të përshtatshme me specifikimet për projektin tip të propozuar;

ii) Që pjesët e produktit pajtohen në mënyrë të përshtatshme me vizatimet në projektin tip të propozuar;

iii) Që proceset e prodhimit, ndërtimit dhe montimit përputhen në mënyrë të përshtatshme me ato që specifikohen në projektin tip të propozuar; dhe

2. Që pajisja e provës dhe të gjitha mjetet matëse të përdorura për provat janë të përshtatshme për provën dhe janë të kalibruara në mënyrë të përshtatshme.

c) Aplikanti lejon AAC-në dhe/ose Agjencinë të bëjë çdo inspektim të nevojshëm për të kontrolluar pajtueshmërinë me paragrafin (b).

d) Aplikanti lejon AAC-në dhe/ose Agjencinë të rishikojë çdo raport, të bëjë çdo inspektim dhe të

kryejë ose dëshmojë çdo provë në fluturim ose në tokë të cilat janë të nevojshme për të kontrolluar vlefshmërinë e deklaratës së pajtueshmërisë së dorëzuar nga aplikanti sipas pikës 21.A.20(b) dhe për të përcaktuar se asnjë tipar ose karakteristikë e bën produktin të pasigurt për përdorimet për të cilat kërkohet certifikimi.

e) Për provat e kryera ose të dëshmuara nga AAC dhe/ose Agjencia sipas paragrafit (d):

1. Aplikanti i paraqet AAC-së dhe/ose Agjencisë një deklaratë të pajtueshmërisë me paragrafin (b); dhe

2. Produktit, pjesës ose pajisjes nuk mund t'u bëhet asnjë ndryshim në lidhje me provën, i cili do të ndikonte në deklaratën e pajtueshmërisë midis kohës së treguar për pajtueshmërinë me paragrafin (b) dhe kohës që ai është prezantuar tek AAC dhe/ose Agjencia për testim.

#### **21.A.35 Provat e fluturimit**

a) Prova e fluturimit për qëllimin e marrjes së një certifikate tip kryhet në përputhje me kushtet për një fluturim të tillë prove të specifikuar nga AAC dhe/ose Agjencia.

b) Aplikanti bën të gjitha provat e fluturimit që AAC dhe/ose Agjencia i shikon si të nevojshme:

Për të përcaktuar pajtueshmërinë me bazën e zbatueshme të certifikatës së tipit dhe kërkesat e mbrojtjes mjedisore, dhe;

1. Për të përcaktuar nëse ka siguri të arsyeshme se avioni, pjesët dhe pajisjet e tij janë të besueshme dhe funksionojnë siç duhet për avionët që do të certifikohen sipas kësaj shtojce I (pjesa 21), me përjashtim të:

- i) glajderave dhe glajderave me motor;
- ii) balonave dhe aerostateve të përcaktuara sipas ELA 1 dhe ELA 2;
- iii) aeroplanëve me peshë maksimale të ngritjes (MTOM) prej 2722 kg e më pak;
- c) (e rezervuar);
- d) (e rezervuar);
- e) (e rezervuar);
- f) Provat e fluturimit të përshkruara në paragrafin (b)(2) përfshijnë:

1. Për avionët që kanë të integruar motorë me turbinë të një tipi të papërdorur më parë në një certifikim tip të avionit, të paktën 300 orë operimi me një komplet të plotë motorësh që janë në përputhje me një certifikatë tip; dhe

2. Për të gjithë avionët e tjerë, të paktën 150 orë operimi.

#### **21.A.41 Certifikata e tipit**

Certifikata e tipit dhe certifikata e kufizuar e tipit

përfshijnë projektimin e tipit, kufizimet e operimit, fletën e të dhënave të certifikatës së tipit për vlefshmërinë ajrore dhe emetimet e gazrave, bazën e zbatueshme të certifikimit të tipit dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit me të cilat AAC dhe/ose Agjencia regjistron përputhshmërinë dhe çdo kusht ose kufizim tjetër të përshkruar për produktin në specifikimet e zbatueshme të certifikimit dhe në kërkesat për mbrojtjen e mjedisit. Certifikata e tipit të avionit dhe certifikata e kufizuar e tipit, përveç kësaj, duhet të përfshijnë të dyja bazën e zbatueshme të të dhënave operacionale të certifikimit, të dhënat e përshtatshmërisë operacionale dhe fletën e të dhënave të certifikatës së tipit për zhurmën. Format i të dhënave të certifikatës së tipit të motorit përfshin të dhënat e përputhshmërisë së emetimit të gazrave.

#### **21.A.44 Detyrimet e mbajtësit**

Çdo mbajtës i një certifikate tip ose certifikate tip të kufizuar:

a) ndërmerr detyrimet e përcaktuara në pikat 21.A.3A, 21.A.3B, 21.A.4, 21.A.55, 21.A.57, 21.A.61 dhe 21.A.62; dhe, për këtë qëllim, vazhdon të përmbushë kërkesat e kualifikimit për përshtatshmërinë sipas pikës 21.A.14; dhe;

b) specifikon shënimin në përputhje me nënpjesën Q.

#### **21 A.47 Mundësia për t'u transferuar**

Transferimi i një certifikate tip ose certifikate tip të kufizuar mund të bëhet vetëm te një person fizik ose juridik i cili është i aftë që të ndërmarrë detyrimet sipas pikës 21.A.44, dhe, për këtë qëllim, ka demonstruar aftësinë e tij për t'u kualifikuar sipas kriterit të parashikuar në pikën 21.A.14.

#### **21.A.51 Kohëzgjatja dhe vazhdueshmëria e vlefshmërisë**

a) Një certifikatë e tipit dhe një certifikatë e tipit të kufizuar lëshohen për një afat kohor të pakufizuar. Ato janë të vlefshme me kusht që:

1. Mbajtësi të mbetet në përputhje me këtë shtojcë I (pjesa 21); dhe

2. Certifikata të mos jetë dorëzuar ose revokuar sipas procedurave të zbatueshme administrative të vendosura nga AAC dhe/ose Agjencia.

b) Pas dorëzimit ose revokimit, certifikata e tipit dhe certifikata e tipit e kufizuar duhet t'i kthehet AAC dhe/ose Agjencisë.



### **21.A.55 Mbajtja e të dhënave**

Të gjitha informacionet përkatëse të projektimit, vizatimet dhe raportet e testimit, duke përfshirë të dhënat e inspektimit për produktin e testuar, mbahen nga zotëruesi i certifikatës së tipit ose i certifikatës së kufizuar të tipit në dispozicion të AAC-së dhe/ose Agjencisë dhe ruhen për të siguruar informacionin e nevojshëm për të garantuar vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore, vazhdueshmërinë e vlefshmërisë së të dhënave për përshtatshmërinë operacionale dhe përputhshmërinë me kërkesat e zbatueshme të mbrojtjes mjedisore të produktit.

### **21.A.57 Manualet**

Mbajtësi i një certifikate tipi ose certifikate të kufizuar tipi harton, mirëmban dhe përditëson kopjet origjinale të të gjithë manualeve të kërkuara nga baza e zbatueshme e certifikimit të tipit, nga baza e zbatueshme e të dhënave të certifikimit të përshtatshmërisë operacionale dhe nga kërkesat për mbrojtjen e mjedisit për produktin dhe i jep kopje AAC-së dhe/ose Agjencisë, sipas kërkesës.

### **21.A.61 Udhëzimet për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore**

a) Mbajtësi i certifikatës së tipit ose certifikatës së tipit të kufizuar i vendos në dispozicion, të paktën një sërë udhëzimesh të plota për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore, duke përfshirë të dhënat përshkruese dhe udhëzimet e përmbushjes të përgatitura në përputhje me bazën e zbatueshme të certifikimit të tipit, secilit pronar të njohur të një avioni ose më shumë avionëve, motori ose helike me dorëzim të tyre ose pas lëshimit të certifikatës së parë të vlefshmërisë ajrore për avionin në fjalë, dhe pas kësaj i vendos këto udhëzime në dispozicion pasi ka marrë kërkesë nga çdo person tjetër që kërkohet të pajtohet me ndonjë nga kushtet e atyre udhëzimeve. Disponueshmëria e disa manualeve ose e një pjese të udhëzimeve për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore, që kanë të bëjnë me kontrollin e përgjithshëm ose me format e tjera të mirëmbajtjes bazë, mund që të vonohet deri pasi produkti të ketë hyrë në shërbim, por duhet të vihet në dispozicion para se ndonjë nga produktet të arrijë vjetërsinë përkatëse ose orët/ ciklet e fluturimit.

b) Për më tepër, ndryshimet e bëra tek udhëzimet për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore bëhen të njohura për të gjithë operatorët e produktit dhe i vihen në dispozicion, me kërkesë, çdo personi të cilit i kërkohet që të pajtohet me ndonjë nga këto udhëzime. AAC-së

dhe/ose Agjencisë i dorëzohet një program që tregon se si janë shpërndarë ndryshimet në udhëzimet për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore.

### **21.A.62 Disponueshmëria e të dhënave të përshtatshmërisë operacionale**

Mbajtësi i certifikatës së tipit ose i certifikatës së kufizuar të tipit vë në dispozicion;

- a) të paktën një komplet të dhënash të plota të përshtatshmërisë operacionale të përgatitura në përputhje me bazën e zbatueshme të certifikimit të përshtatshmërisë operacionale, për të gjithë operatorët e njohur të avionit në Shqipëri, përpara se të dhënat e përshtatshmërisë operacionale të përdoren nga një organizatë trajnuese ose nga një operator shqiptar; dhe
- b) çdo ndryshim në të dhënat e përshtatshmërisë operacionale për të gjithë operatorët e njohur të avionit; dhe
- c) sipas kërkesës, të dhënat përkatëse të përmendura në pikat (a) dhe (b) më lart, për:

1. autoritetin kompetent përgjegjës për verifikimin e pajtueshmërisë me një ose më shumë elementë të këtij kompleti të të dhënave për përshtatshmërinë operacionale; dhe

2. çdo person të cilit i kërkohet të jetë në përputhje me një ose më shumë elementë të këtij kompleti të të dhënave për përshtatshmërinë operacionale.

(NËNPJESA C- JO E ZBATUESHME)

NËNPJESA D - NDRYSHIMET NË CERTIFIKATAT E TIPIT DHE CERTIFIKATAT E TIPIT TË KUFIZUARA

### **21.A.90A Fushëveprimi**

Kjo nënpjesë përcakton procedurën për miratimin e ndryshimeve në certifikatat e tipit dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e aplikantëve dhe mbajtësve të këtyre miratimeve. Kjo nënpjesë përcakton gjithashtu ndryshimet standarde që nuk i nënshtrohen një procesi miratimi sipas kësaj nënpjesë. Në këtë nënpjesë, referencat për certifikatat e tipit përfshijnë certifikatën e tipit dhe certifikatën e kufizuar të tipit.

### **21.A.90B Ndryshimet standarde**

a) Ndryshimet standarde janë ato ndryshime në një certifikatë tipi:

1. Në lidhje me:

- i) aeroplanët me peshë maksimale ngritjeje 5700 kg ose më pak;

ii) helikopterët me peshë maksimale ngritjeje 3175 kg ose më pak;

iii) deltaplanët, deltaplanët me motor, balonat dhe aerostatet siç përcaktohen në ELA 1 dhe ELA 2.

2. Që ndjekin të dhënat e projektit të përfshira në specifikimet e certifikimit të lëshuara nga AAC dhe/ose Agjencia, të cilat përmbajnë metodat, teknikat dhe praktikatat e pranueshme për të zbatuar dhe identifikuar ndryshimet standarde, duke përfshirë udhëzimet shoqëruese për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore.

3. Që nuk janë në konflikt me të dhënat e mbajtësit të certifikatës së tipit.

b) Pikat 21.A.91 deri në 21.A.109 nuk janë të zbatueshme për ndryshimet standarde.

#### **21.A.91 Klasifikimi i ndryshimeve në një certifikatë tip**

Ndryshimet në një certifikim tipi klasifikohen si të vogla dhe të mëdha. Një “ndryshim i vogël” është ai që nuk ka efekt të dukshëm në masën, balancën, forcën strukturore, besueshmërinë, karakteristikat operacionale, zhurmën, ventilimin e karburantit, shkarkimin e gazrave, të dhënat e përshtatshmërisë operacionale ose karakteristikat e tjera që ndikojnë në vlefshmërinë ajrore të produktit. Me përjashtim të pikës 21.A.19, të gjitha ndryshimet e tjera janë “ndryshime të mëdha” në përputhje me këtë nënpjesë. Ndryshimet e mëdha dhe të vogla duhet të miratohen në përputhje me pikat 21.A.95 ose 21.A.97, sipas rastit, si dhe duhet të identifikohen në mënyrë të përshtatshme.

#### **21.A.92 Pranueshmëria**

a) Vetëm mbajtësi i certifikatës së tipit mund të aplikojë për miratimin e një ndryshimi të madh në një certifikatë tipi në përputhje me këtë nënpjesë; të gjithë aplikantët e tjerë për një ndryshim të madh në një certifikatë tipi duhet të aplikojnë sipas nënpjesës E.

b) Çdo person fizik ose juridik mund të aplikojë për miratimin e një ndryshimi të vogël në një certifikim tipi në përputhje me këtë nënpjesë.

#### **21.A.93 Aplikimi**

Aplikimi për miratimin e një ndryshimi në një certifikim tipi bëhet në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga AAC dhe/ose Agjencia dhe përfshin:

a) Një përshkrim të ndryshimit që identifikon:

1. të gjitha pjesët e projektimit të tipit dhe manualët e miratuara të prekura nga ndryshimi; dhe
2. specifikimet e certifikimit dhe kërkesat për

mbrojtjen e mjedisit me të cilat është hartuar ndryshimi për të qene në përputhje me pikën 21.A.101.

b) Identifikimin e çdo rishqyrtimi të nevojshëm për të treguar përputhjen e produktit të ndryshuar me specifikimet e zbatueshme të certifikimit dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.

c) Kur ndryshimi ndikon në të dhënat e përshtatshmërisë operacionale, aplikimi duhet të përfshijë ose të plotësohet pas aplikimit fillestar, për të përfshirë ndryshimet e nevojshme në të dhënat e përshtatshmërisë operacionale.

#### **21.A.95 Ndryshimet e vogla**

Ndryshimet e vogla në një certifikatë tipi klasifikohen dhe miratohen ose:

a) nga AAC dhe/ose Agjencia; ose

b) nga një organizatë projektimi e miratuar në mënyrë të përshtatshme, sipas një procedure të rënë dakord me AAC-në dhe/ose Agjencinë.

#### **21.A.97 Ndryshimet madhore**

a) Një aplikant për një ndryshim madhor:

1. Paraqet pranë AAC-së dhe/ose Agjencisë të dhëna provuese së bashku me çdo të dhënë përshkruese të nevojshme për t'u përfshirë në projektin e tipit;

2. Tregon/vërteton se produkti i ndryshuar është në përputhje me specifikimet e zbatueshme të certifikimit dhe kërkesat e mbrojtjes mjedisore, siç specifikohet në pikën 21.A.101;

3. Tregon/vërteton se është në përputhje me pikat 21.A.20 (b), (c) dhe (d);

4. Atëherë kur aplikanti ka një miratim të përshtatshëm të organizatës projektuese, bën deklaratën sipas pikës 21.A.20 (d) të nënpjesës J;

5. Tregon/vërteton se është në përputhje me pikën 21.A.33 dhe atje ku është e zbatueshme, me pikën 21.A.35.

b) Miratimi i një ndryshimi të madh në një certifikatë tipi është i kufizuar në atë ose në ato konfigurime specifike në certifikatën e tipit mbi të cilën është bërë ndryshimi.

#### **21.A.101 Përcaktimi i specifikimeve të zbatueshme të certifikimit dhe i kërkesave të mbrojtjes së mjedisit**

a) Një aplikant për një ndryshim në një certifikatë tipi demonstroi se produkti i ndryshuar përputhet me specifikimet e certifikimit që janë të zbatueshme mbi produktin e ndryshuar dhe që janë në fuqi në datën e aplikimit për ndryshim, përveç

nëse përputhja me specifikimet e certifikimit të ndryshimeve të mëvonshme efektive zgjidhet nga aplikanti ose kërkohet sipas pikës (e) dhe (f), dhe nga kërkesat e zbatueshme të mbrojtjes së mjedisit të përcaktuara në pikën 21.A.18.

b) Me përjashtim të pikës (a), një aplikant mund të tregojë që produkti i ndryshuar përputhet me një ndryshim të mëparshëm të specifikimeve të certifikimit të përmendura në pikën (a) dhe me çdo specifikim tjetër të certifikimit që AAC dhe/ ose Agjencia çmon se lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Megjithatë, specifikimet e certifikimit të ndryshuara më përpara nuk i paraprijnë specifikimeve korresponduese të certifikimit të inkuorporuara me referencë në certifikatën e tipit. Aplikuesi mund të tregojë pajtueshmërinë me një ndryshim të mëparshëm të specifikimeve të certifikimit për secilën nga këto që vijojnë:

1. Një ndryshim që AAC dhe/ ose Agjencia nuk e konsiderohen të rëndësishëm. Në përcaktimin nëse një ndryshim specifik është i rëndësishëm, AAC dhe/ ose Agjencia merr parasysh ndryshimin në kontekst me të gjitha ndryshimet përkatëse të mëparshme të projektimit dhe të gjitha ndryshimet përkatëse të specifikimeve të zbatueshme të certifikimit të inkuorporuara në certifikatën e tipit llojit për produktin. Ndryshimet që plotësojnë një nga kriteret e mëposhtme konsiderohen automatikisht si të rëndësishme kur:

i) nuk ruhet konfigurimi i përgjithshëm ose parimet e ndërtimit;

ii) nuk mbeten të vlefshme supozimet e përdorura për certifikimin e produktit që do të ndryshohet.

2. Çdo zonë, sistem, pjesë ose pajisje që AAC dhe/ ose Agjencia çmon se nuk ndikohet nga ndryshimi.

3. Çdo zonë, sistem, pjesë ose pajisje që është prekur nga ndryshimi, për të cilat AAC dhe/ ose Agjencia konstaton se pajtueshmëria me specifikimet e certifikimit të përmendura në pikën (a) nuk kontribuon materialisht në nivelin e sigurisë së produktit të ndryshuar ose çmon se është jopraktike.

c) Një aplikant për një ndryshim në një avion (të ndryshëm nga një helikopter) me peshë maksimale prej 2 722 kg (6 000 lbs) ose më pak, ose në një helikopter pa turbinë me peshë maksimale prej 1 361 kg (3 000 lbs) ose më pak mund të tregojë se produkti i ndryshuar përputhet me bazën e certifikimit të tipit të përfshirë me referencë në certifikatën e tipit. Megjithatë, nëse AAC dhe/ose Agjencia konstaton se ndryshimi është i rëndësishëm në një zonë, AAC dhe/ ose Agjencia mund të përcaktojë

pajtueshmërinë me një ndryshim në bazën e certifikimit të tipit të përfshirë në referencën e certifikatës tip në fuqi në datën e aplikimit dhe çdo specifikim certifikimi që AAC konstaton se ka lidhje të drejtpërdrejtë, përveç nëse AAC dhe/ ose Agjencia, gjithashtu, konstaton se pajtueshmëria me atë ndryshim ose specifikim të certifikimit nuk kontribuon materialisht në nivelin e sigurisë së produktit të ndryshuar ose është jopraktike.

d) Nëse AAC dhe/ ose Agjencia konstaton se specifikimet e certifikimit në fuqi në datën e aplikimit për ndryshim nuk ofrojnë standarde të përshtatshme në lidhje me ndryshimin e propozuar, aplikanti, gjithashtu, përmbush çdo kusht të veçantë dhe ndryshimet në ato kushte të veçanta, të përshkruara sipas dispozitave të pikës 21.A.16B, për të siguruar një nivel sigurie të barabartë me atë të përcaktuar në specifikimet e certifikimit në fuqi në datën e aplikimit për ndryshim.

e) Një aplikim për një ndryshim në një certifikatë tipi për aeroplanë të mëdhenj dhe për helikopterë të mëdhenj është efektiv për pesë vjet dhe një aplikim për një ndryshim në çdo certifikatë tjetër tipi është efektiv për tre vjet. Në rast se ndryshimi nuk është miratuar ose është e qartë se nuk do të miratohet sipas afatit të përcaktuar në këtë pikë, aplikanti mund të:

1. Paraqesë një kërkesë të re për ndryshimin e certifikatës së tipit dhe të përputhet me të gjitha dispozitat e pikës (a) të zbatueshme për një kërkesë origjinale për një ndryshim; ose

2. Paraqesë një kërkesë për një shtyrje afati të kërkesës origjinale dhe të zbatojë dispozitat e pikës (a) për një datë efektive të aplikimit, që përzgjidhet nga aplikuesi, jo më herët se dita që i paraprin datës së miratimit të ndryshimit nga periudha kohore e përcaktuar në këtë pikë për kërkesën origjinale për ndryshimin.

f) Nëse një aplikant zgjedh të pajtohet me një specifikim certifikimi të një ndryshimi në specifikimet e certifikimit që është efektiv pas paraqitjes së kërkesës për një ndryshim në një tip, aplikanti gjithashtu duhet të jetë në përputhje me

çdo specifikim tjetër të certifikimit që AAC dhe/ ose Agjencia çmon se lidhet drejtpërdrejtë.

g) Kur kërkesa për një ndryshim në një certifikatë tipi për një avion përfshin ose plotësohet pas aplikimit fillestar për të përfshirë ndryshimet në të dhënat e përshtatshmërisë operacionale, baza e certifikimit të të dhënave për përshtatshmërinë operacionale përcaktohet në përputhje me pikat (a), (b), (c), (d) dhe (f) më lart.

#### **21.A.103 Lëshimi i miratimit**

a) Aplikanti ka të drejtën që të ketë një ndryshim të madh në një certifikatë tipi të miratuar pas:

1. Paraqitjes së deklaratës të përmendur në pikën 21.A.20 (d); dhe

2. Pasi të jetë demonstruar se:

i) produkti i ndryshuar i plotëson specifikimet e zbatueshme të certifikimit dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit, siç përcaktohet në pikën 21.A.101;

ii) çdo dispozitë e vlefshmërisë ajrore që nuk përmbushet kompensohet nga faktorët që sigurojnë një nivel të barabartë sigurie; dhe

iii) asnjë tipar ose karakteristikë nuk e bën produktin të pasigurt për përdorimet për të cilat kërkohet certifikimi.

3. Në rastin e një ndryshimi që ndikon në të dhënat e përshtatshmërisë operacionale, demonstron se ndryshimet e nevojshme të të dhënave të përshtatshmërisë operacionale plotësojnë bazën e zbatueshme të certifikimit të përshtatshmërisë operacionale të përcaktuar në përputhje me pikën 21.A.101 (g);

4. Me përjashtim të pikës 3, me kërkesë të aplikantit të përfshirë në deklaratën e përmendur në pikën 21.A.20 (d), një ndryshim i madh në një certifikatë tipi të avionit mund të miratohet përpara se të tregohet përputhshmëria me bazën e zbatueshme të certifikimit të të dhënave për përshtatshmërinë operacionale, me kusht që aplikanti të demonstron pajtueshmërinë me bazën e certifikimit të të dhënave për përshtatshmërinë operative përpara se të përdoren të dhënat e përshtatshmërisë operative.

b) Një ndryshim i vogël në një certifikatë tipi miratohet vetëm në përputhje me pikën 21.A.95 nëse tregohet se produkti i ndryshuar i plotëson specifikimet e zbatueshme të certifikimit, siç përcaktohet në pikën 21.A.101.

#### **21.A.105 Mbajtja e të dhënave**

Për çdo ndryshim, i gjithë informacioni përkatës i projektimit, vizatimet dhe raportet e testimit, duke përfshirë të dhënat e inspektimit për produktin e ndryshuar

të testuar, ruhen nga aplikanti për t'u vënë në dispozicion të AAC-së dhe/ ose Agjencisë dhe mbahen në mënyrë që të sigurojnë informacionin e nevojshëm për të garantuar vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore, vazhdueshmërinë e vlefshmërisë së të dhënave për përshtatshmërinë operacionale dhe përputhshmërinë me kërkesat e zbatueshme të mbrojtjes mjedisore të produktit të ndryshuar.

#### **21.A.107 Udhëzime për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore**

a) Mbajtësi i një miratimi të ndryshimit të vogël në certifikatën e tipit duhet të sigurojë të paktën një set të ndryshimeve të lidhura, nëse ka, me udhëzimet për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të produktit në të cilin do të instalohet ndryshimi i vogël, i përgatitur në përputhje me bazën e certifikatës së tipit të aplikueshëm, për secilin pronar të njohur të një ose më shumë avionëve, motorëve ose helikës që përfshin ndryshimin e vogël, pas dorëzimit të tij, ose me lëshimin e certifikatës së parë të vlefshmërisë ajrore për avionin e prekur, cilado që ndodh më vonë dhe më pas i vendos këto ndryshime në udhëzimet e disponueshme, sipas kërkesës, për çdo person tjetër që kërkohet të përmbushë ndonjë nga kushtet e këtyre udhëzimeve.

b) Për më tepër, ndryshimet në ato variacione të udhëzimeve për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore vihen në dispozicion të të gjithë operatorëve të njohur të një produkti që integron një ndryshim të vogël dhe i vihen në dispozicion, me kërkesë, çdo personi të cilit i kërkohet të pajtohet me ndonjë nga ato udhëzime.

#### **21.A.108 Disponueshmëria e të dhënave të përshtatshmërisë operacionale**

Në rastin e një ndryshimi që ndikon në të dhënat e përshtatshmërisë operacionale, zotëruesi i miratimit të ndryshimit të vogël vë në dispozicion:

a) të paktën një komplet të ndryshimeve për të dhënat e përshtatshmërisë operacionale të përgatitura në përputhje me bazën e zbatueshme të certifikimit të përshtatshmërisë operacionale, për të gjithë operatorët e njohur të avionit të ndryshuar, përpara se të dhënat e përshtatshmërisë

operacionale të përdoren nga një organizatë trajnuese ose një operator vendas; dhe

b) çdo ndryshim tjetër në të dhënat e prekura të përshtatshmërisë operationale, për të gjithë operatorët e njohur të avionit të ndryshuar; dhe

c) sipas kërkesës, pjesët përkatëse të ndryshimeve në pikat (a) dhe (b) më lart për:

1. autoritetin kompetent përgjegjës për verifikimin e përputhshmërisë me një ose më shumë elementë të të dhënave të prekura të përshtatshmërisë operationale; dhe

2. çdo person të cilit i kërkohet që të jetë në përputhshmëri me një ose me më shumë elementë të këtij grupi të të dhënave të përshtatshmërisë operationale.

#### **21.A.109 Detyrimet dhe shënjimi MEP**

Zotëruesi i miratimit të një ndryshimi të vogël në një certifikatë tip:

a) Merr përsipër detyrimet e parashtruara në pikat 21.A.4, 21.A.105, 21.A.107 dhe 21.A.108; dhe

b) specifikon shenjën, duke përfshirë shkronjat MPE (Miratimi Evropian i Pjesës, në përputhje me pikën 21.A.804 (a).’;

**NËNPJESA E - CERTIFIKATAT PLOTË- SUESE TË TIPIT**

#### **21.A.111 Fushëveprimi**

Kjo nënpjesë përcakton procedurën për miratimin e ndryshimeve të mëdha të certifikatës së tipit sipas procedurave të certifikatës plotësuese të tipit dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e aplikantëve, si dhe të zotëruesve të këtyre certifikatave.

#### **21.A.112A Pranueshmëria**

Çdo person fizik ose juridik (organizatë), që ka demonstruar ose është në proces demonstrimi të aftësisë së tij në përputhje me pikën 21.A.112B ka mundësinë të pranohet si një aplikant për një certifikatë tip plotësuese sipas kushteve të parashtruara në këtë nënpjesë.

#### **21.A.112B Demonstrimi i aftësisë**

a) Çdo organizatë që aplikon për një certifikatë tip plotësuese demonstroi aftësinë e saj duke pasur një miratim të organizatës projektuese, të lëshuar nga AAC dhe/ose Agjencia në përputhje me nënpjesën J.

b) Me përjashtim të paragrafit (a), si një procedurë alternative për të demonstruar aftësinë e tij, një aplikant mund të kërkojë miratimin e AAC- së dhe/ose Agjencisë për përdorimin e procedurave që përcaktojnë praktikat specifike të projektimit, burimet dhe rendin e aktiviteteve

të nevojshme për t’u përputhur me këtë nënpjesë.

c) Me përjashtim të paragrafëve (a) dhe (b), një aplikant mund të zgjedhë për demonstrimin e aftësisë nëpërmjet miratimit nga AAC dhe/ose Agjencia të një programi të certifikuar që detajon mjetet për demonstrimin e përputhshmërisë për një certifikatë tip plotësuese të një avioni, motori dhe helike të përcaktuar në pikën 21.A.14(c).

#### **21.A.113 Aplikimi për një certifikatë plotësuese të tipit**

a) Një aplikim për një certifikatë tip plotësuese bëhet sipas formës dhe mënyrës së përcaktuar nga AAC dhe/ose Agjencia.

B0 Një aplikim për një certifikatë plotësuese të tipit përfshin përshkrimet, identifikimin dhe ndryshimet në të dhënat e përshtatshmërisë operationale të kërkuara nga pika 21.A.93. Përveç kësaj, një aplikim i tillë duhet të përfshijë një justifikim që informacioni mbi të cilin bazohen këto elemente është i përshtatshëm ose nga burimet e vetë aplikantit, ose nëpërmjet një marrëveshjeje me zotëruesin e certifikatës së tipit.

#### **21.A.114 Tregimi i përputhshmërisë**

Një aplikant për një certifikatë tip plotësuese duhet të jetë në përputhje me pikën 21.A.97.

#### **21.A.115 Lëshimi i një certifikate plotësuese të tipit**

Aplikantit i jepet e drejta të ketë një certifikatë tip plotësuese të lëshuar nga AAC dhe/ose Agjencia pasi:

a) të ketë dorëzuar deklaratën sipas pikës 21.A.20(d); dhe

b) të ketë demonstruar se:

1. Produkti i ndryshuar përputhet me specifikimet e zbatueshme të certifikimit dhe kërkesat e mbrojtjes së mjedisit siç specifikohet në pikën 21.A.101;

2. Çdo parashikim i vlefshmërisë ajrore që nuk është në përputhshmëri kompensohet nga faktorë që sigurojnë një nivel ekuivalent të sigurisë; dhe

3. Asnjë tipar apo karakteristikë e bën produktin të pasigurt për përdorimin për të cilin kërkohet;

c) të ketë demonstruar aftësinë e tij në përputhje me pikën 21.A.112B

d) atëherë kur, sipas pikës 21.A.113(b), aplikanti të ketë hyrë në një marrëveshjeje me mbajtësin e certifikatës së tipit.

1. Mbajtësi i certifikatës së tipit të ketë njoftuar se nuk ka kundërshtime teknike në lidhje me informacionin e paraqitur sipas pikës 21.A.93; dhe

2. Mbajtësi i certifikatës së tipit të ketë pranuar të bashkëpunojë me mbajtësin e certifikatës së tipit plotësuese për të siguruar përmbushjen e të gjitha detyrimeve për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të produktit të ndryshuar nëpërmjet pajtueshmërisë me pikat 21.A.44 dhe 21.A.118A.

#### **21.A.116 Mundësia për t'u transferuar**

Një certifikatë e tipit plotësuese transferohet vetëm te një person fizik ose juridik i cili është në gjendje të ndërmarrë detyrimet e pikës 21.A.118A dhe për këtë qëllim ka demonstruar aftësinë e tij për t'u kualifikuar sipas kriterëve të pikës 21.A.112B me përjashtim të avionëve ELA1 për të cilët personi fizik ose juridik ka kërkuar marrëveshjen e AAC-së dhe/ose Agjencisë për përdorimin e procedurave që përcaktojnë aktivitetet e tij për të ndërmarrë këto detyrime.

#### **21.A.117 Ndryshimet në atë pjesë të produktit që mbulohet nga një certifikatë e tipit plotësuese**

a) Ndryshimet e vogla në atë pjesë të produktit të mbuluar nga një certifikatë e tipit plotësuese klasifikohen dhe miratohen në përputhje me nënpjesën D.

b) Çdo ndryshim madhor në atë pjesë të produktit të mbuluar nga një certifikatë e tipit plotësuese miratohet si një certifikatë e tipit plotësuese më vete në përputhje me këtë nënpjesë.

c) Me përjashtim të paragrafit (b), një ndryshim i madh i pjesës së produktit të mbuluar nga një certifikatë e tipit plotësuese e paraqitur nga vetë mbajtësi i certifikatës së tipit plotësuese mund të miratohet si një ndryshim ndaj certifikatës së tipit plotësuese ekzistuese.

#### **21.A.118A Detyrimet dhe shënjimi MEP**

Çdo mbajtës i një certifikate tipi plotësuese:

a) Merr përsipër detyrimet:

1. E përcaktuara në pikat 21.A.3A, 21.A.3B, 21.A.4, 21.A.105, 21.A.119, 21.A.120A dhe 21.A.120B;

2. Të nënkuptuara në bashkëpunim me mbajtësin e certifikatës së tipit në përputhje me pikën 21.A.115 (d) (2); dhe për këtë qëllim vazhdon të plotësojë kriteret e pikës 21.A.112B;

b) Specifikon shënimin, duke përfshirë shkronjat MEP, në përputhje me pikën 21.A.804(a).

#### **21.A.118B Kohëzgjatja dhe vlefshmëria në vazhdueshmëri**

a) Një certifikatë e tipit plotësuese lëshohet për një periudhë kohore pa afat. Ajo mbetet e vlefshme në varësi të:

1. Qëndrimin të mbajtësit në pajtueshmëri me këtë aneks (pjesa 21); dhe

2. Mos dorëzimit ose revokimit të certifikatës sipas procedurave të zbatueshme administrative të vendosura nga AAC dhe/ose Agjencia.

b) Pas dorëzimit ose revokimit, certifikata e tipit plotësuese i kthehet AAC-së dhe/ose Agjencisë.

#### **21.A.119 Manualet**

Mbajtësi i një certifikate plotësuese të tipit prodhon, ruan dhe përditëson kopjet origjinale të ndryshimeve në manualët e kërkuara nga baza e zbatueshme e certifikimit të tipit, nga baza e zbatueshme e certifikimit të përshtatshmërisë operationale dhe nga kërkesat e mbrojtjes mjedisore për produktin, të nevojshme për të mbuluar ndryshimet e paraqitura në certifikatën plotësuese të tipit dhe ia dorëzon kopjet e këtyre manualeve AAC-së dhe/ose Agjencisë, sipas kërkesës.

#### **21.A.120A Udhëzimet për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore**

a) Mbajtësi i certifikatës plotësuese të tipit për një avion, motor ose helikë, i jep, të paktën një komplet të variacioneve shoqëruese të udhëzimeve për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore, të përgatitura në përputhje me bazën e zbatueshme të certifikatës së tipit, secilit pronar të njohur të një avioni ose më shumë avionëve, motori ose helike duke përfshirë tiparet e një certifikate tip dhe pas dorëzimit të kësaj ose pas lëshimit të certifikatës së parë të vlefshmërisë ajrore për avionin e prekur nga ndryshimi, cilado që të ndodhë më vonë nga këto të dyja, i vendos këto udhëzime në dispozicion pasi të ketë marrë kërkesën nga çdo person tjetër të cilit i kërkohet që të pajtohet me ndonjë nga kushtet e këtyre udhëzimeve. Disponueshmëria e ndonjë manuali ose e një pjese të variacioneve të udhëzimeve për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore, që kanë të bëjnë me kontrollin e përgjithshëm ose me format e tjera të mirëmbajtjes bazë, mund që të vonohet deri pasi produkti të ketë hyrë në shërbim, por duhet të vihet në dispozicion

para se ndonjë nga produktet të arrijë vjetërsinë përkatëse ose orët/ ciklet e fluturimit.

b) Për më tepër, ndryshimet e bëra tek udhëzimet për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore bëhen të ditura për të gjithë operatorët e njohur të një produkti që integron në vetvete certifikatën e tipit plotësuese dhe i vihen në dispozicion, me kërkesë, çdo personi të cilit i kërkohet që të pajtohet me ndonjë nga këto udhëzime. AAC-së dhe/ose Agjencisë i dorëzohet një program që tregon se si ndryshimet në udhëzimet për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore janë të shpërndara.

#### **21.A.120B Disponueshmëria e të dhënave të përshtatshëmrisë operacionale**

Në rastin e një ndryshimi që ndikon në të dhënat e përshtatshëmrisë operacionale, zotëruesi i certifikatës plotësuese të tipit vë në dispozicion:

- a) të paktën një komplet ndryshimesh për të dhënat e përshtatshëmrisë operacionale të përgatitura në përputhje me bazën e zbatueshme të certifikimit të përshtatshëmrisë operacionale, për të gjithë operatorët e njohur të BE-së dhe ZPEA-së, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, ose operatorëve vendas të avionit të ndryshuar, përpara se të dhënat e përshtatshëmrisë operacionale të përdoren nga një organizatë trajnuese ose një operator vendas, ose i BE-së dhe ZPEA-së; dhe
- b) çdo ndryshim tjetër në të dhënat e prekura të përshtatshëmrisë operacionale, për të gjithë operatorët e njohur të BE-së dhe ZPEA-së, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, ose operatorëve vendas të avionit të ndryshuar; dhe
- c) sipas kërkesës, pjesët përkatëse të ndryshimeve në pikat (a) dhe (b) më lart, për:

1. Autoritetin kompetent përgjegjës për verifikimin e përputhshmërisë me një ose më shumë elementë të të dhënave të përshtatshëmrisë operacionale të prekura nga ndryshimi; dhe

2. Çdo person të cilit i kërkohet që të jetë në përputhshmëri me një ose më shumë elementë të këtij kompleti të të dhënave të përshtatshëmrisë operacionale.

NËNPJESA F - PRODHIMI PA MIRATIMIN E ORGANIZATËS PRODHUESE

#### **21.A.121 Qëllimi**

a) Kjo nënpjesë vendos procedurën për të demonstruar përputhshmërinë me të dhënat e zbatueshme të projektimit të një produkti, pjese, ose pajisjeje e cila synohet të prodhohet pa miratimin e një organizate prodhuese sipas

nënpjesës G.

b) Kjo nënpjesë vendos rregullat që drejtojnë detyrimet e prodhuesit të një produkti, pjese ose pajisjeje që prodhohet sipas kësaj nënpjesë.

#### **21.A.122 Pranueshmëria**

Çdo person fizik ose juridik mund të aplikojë për të treguar pajtueshmërinë e produkteve individuale, pjesëve dhe pajisjeve sipas kësaj nënpjesë, nëse:

- a) mban ose ka aplikuar për një miratim që mbulon projektin e atij produkti, asaj pjese ose pajisjeje; ose
- b) ka siguruar koordinimin e kënaqshëm midis prodhimit dhe projektimit, nëpërmjet një marrëveshjeje të përshtatshme me aplikantin ose mbajtësin e miratimit të një projekti të tillë.

#### **21.A.124 Aplikimi**

a) Çdo aplikim për një marrëveshje për të treguar pajtueshmërinë e produkteve individuale, pjesëve dhe pajisjeve sipas kësaj nënpjesë bëhet në një formë dhe mënyrë të vendosur nga AAC.

b) Një aplikim i tillë përmban:

1. Të dhëna që demonstrojnë, atje ku është e zbatueshme, se:

- i) lëshimi i një miratimi të organizatës prodhuese sipas nënpjesës G do të ishte i papërshtatshëm; ose
- ii) certifikimi ose miratimi i një produkti, pjese ose pajisjeje sipas kësaj nënpjesë është i nevojshëm në pritje të lëshimit të miratimit të një organizate prodhuese sipas nënujësës G.

2. Një përshkrim të informacionit të kërkuar nga pika 21.A.125(b).

#### **21.A.125A Lëshimi i një letër marrëveshjeje**

Aplikanti ka të drejtë të ketë një letër marrëveshjeje të lëshuar nga AAC duke rënë dakord për të treguar përputhshmërinë e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve individuale sipas kësaj nënpjesë, pasi:

a) të ketë vendosur një sistem të inspektimit të prodhimit i cili siguron se çdo produkt, pjesë ose pajisje përputhet me të dhënat e zbatueshme të projektimit dhe është në gjendje për operim të sigurt.

b) të ketë siguruar një manual i cili përmban:

1. Një përshkrim të sistemit të inspektimit të prodhimit të kërkuar sipas paragrafit (a),

2. Një përshkrim të mjeteve për përcaktimin e sistemit të inspektimit të prodhimit;

3. Një përshkrim të provave të kërkuara nga paragrafët 21.A.127 dhe 21.A.128, dhe emrat e personave të autorizuar për qëllimin e paragrafit 21.A.130(a).

c) të ketë demonstruar që është i aftë të japë asistencë në përputhje me pikat 21.A.3 dhe 21.A.129(d).

#### **21.A.125B Gjetjet**

a) Kur zbulohen të dhëna objektive të cilat tregojnë papajtueshmërinë e mbajtësit të letër marrëveshjes me kërkesat e zbatueshme të kësaj pjese, gjetjet klasifikohen si më poshtë:

1. Një gjetje e nivelit një është çdo papajtueshmëri me këtë pjesë e cila mund të çojë në papajtueshmëri të pakontrolluara me të dhënat e zbatueshme të projektimit dhe mund të ndikojë sigurinë e avionit.

2. Një gjetje e nivelit dy është çdo papajtueshmëri me këtë pjesë e cila nuk është e klasifikuar si niveli një.

b) Një gjetje e nivelit tre është çdo send në të cilin është identifikuar, me anë të të dhënave objektive, përmbajtja e problemeve potenciale të cilat mund të çojnë drejt një papajtueshmërie sipas paragrafit (a).

c) Pas marrjes së njoftimit për gjetjen sipas pikës 21.B.143:

1. Në rast të një gjetjeje të nivelit një, mbajtësi i letër marrëveshjes demonstroi veprimet korrigjuese për të përmbushur kërkesat e AAC-së brenda një periudhe jo më të madhe se 21 ditë pune pas konfirmimit me shkrim të gjetjes;

2. Në rastin e gjetjeve të nivelit dy, periudha e veprimit korrigjues e dhënë nga AAC është në përshtatje me natyrën e gjetjes, por në çdo rast si fillim nuk është më e madhe se tre muaj. Në rrethana të caktuara dhe në varësi të natyrës së gjetjes, AAC mund të zgjasë periudhën tre mujore në varësi të një plani veprimi korrigjues të pëlqyeshëm, të miratuar nga AAC.

3. Një gjetje e nivelit tre nuk kërkon veprim të menjëhershëm nga mbajtësi i letër marrëveshjes.

d) Në rastin e gjetjeve të nivelit një ose nivelit dy, letër marrëveshja mund t'i nënshtrohet një kufizimi, pezullimi dhe revokimi të pjesshëm ose të plotë sipas pikës 21.B.145. Mbajtësi i letër marrëveshjes jep në kohë një konfirmim të marrjes së njoftimit të kufizimit, pezullimit ose revokimit të letër marrëveshjes.

#### **21.A.125C Kohëzgjatja dhe vazhdueshmëria e vlefshmërisë**

a) Letër marrëveshja lëshohet për një kohëzgjatje të

kufizuar jo më të madhe se një vit. Ajo qëndron e vlefshme me përjashtim të rastit kur:

1 Mbajtësi i letër marrëveshjes nuk arrin të demonstrojë pajtueshmërinë me kërkesat e zbatueshme të kësaj nënpjesë; ose

2. Ka të dhëna që prodhuesi nuk mund të ruajë kontroll të kënaqshëm në prodhimin e produkteve, pjesëve, ose pajisjeve sipas marrëveshjes; ose

3. Prodhuesi nuk përmbush më kërkesat e pikës 21 A.122; ose

4. Letër marrëveshja është dorëzuar, revokuar sipas pikës 21 B.145, ose ka skaduar.

b) Pas dorëzimit, revokimit ose skadimit, letër marrëveshja i rikthehet AAC-së.

#### **21.A.126 Sistemi i inspektimit të prodhimit**

a) Sistemi i inspektimit të prodhimit i kërkuar sipas pikës 21.A.125A(a) duhet të japë mjetet për të përcaktuar që:

1. Materialet që vijnë dhe pjesët e blera ose të nënkontraktuar, të përdorura në produktin e përfunduar janë të njëjta siç janë specifikuar në të dhënat e zbatueshme të projektimit.

2. Materialet që vijnë dhe pjesët e blera ose të nënkontraktuar janë të identifikuar në mënyrën e duhur.

3. Proceset, teknikat e prodhimit dhe metodat e montimit që ndikojnë në cilësinë dhe sigurinë e produktit të përfunduar janë kryer në përputhje me udhëzimet e pranuar nga AAC.

4. Ndryshimet e projektit, duke përfshirë zëvendësimet e materialit, janë miratuar sipas nënpjesës D ose E dhe janë kontrolluar përpara se të integrohen në produktin e përfunduar.

b) Sistemi i inspektimit të prodhimit i kërkuar sipas pikës 21.A.125(a), duhet të jetë i tillë që të sigurojë që:

1. Pjesët në proces janë inspektuar për përputhshmëri me të dhënat e zbatueshme të projektimit në ato pika gjatë procesit në të cilat mund të bëhen përcaktime të sakta.

2. Materialet që dëmtohen dhe prishen, ruhen në mënyrë të përshtatshme dhe mbrohen në mënyrë të mjaftueshme.

3. Vizatimet aktuale të projektit janë të gatshme për personelin prodhues dhe inspektues dhe përdoren kur është e nevojshme.



4. Materialet dhe pjesët e refuzuara të jenë veçuar dhe identifikuar në një mënyrë e cila përjashton instalimin në produktin e përfunduar.

5. Materialet dhe pjesët që janë ndaluar për shkak të shmangieve nga të dhënat e projektit ose specifikimet, dhe të cilat duhet të merren në konsideratë për instalim në produktin e përfunduar, i nënshtrohen një procedure rishikimi inxhinierie dhe të prodhimit. Ato materiale dhe pjesë të përcaktuara nga kjo procedurë për të qenë në shërbim identifikohen në mënyrën e duhur dhe inspektohen përsëri nëse është e nevojshme, ripunohen ose riparohen. Materialet dhe pjesët e refuzuara nga kjo procedurë shënjohen dhe lihen mënjanë për të siguruar që ato nuk janë të integruara në produktin përfundimtar.

6. Të dhënat e prodhuara sipas sistemit të inspektimit të prodhimit mbahen të identifikuar me produktin ose pjesën e përfunduar atje ku është praktike dhe ruhen nga prodhuesi në mënyrë që ai të japë informacionin e nevojshëm për të garantuar vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të produktit.

#### **21.A.127 Provat: avionët**

a) Çdo prodhues i një avioni të prodhuar sipas kësaj nënpjesë vendos një bazë të miratuar prodhimi, një procedurë të testimit të fluturimit dhe format e kontrollit dhe në përputhje me këto forma, testohet çdo avioni i prodhuar, si një mënyrë e vendosjes së aspekteve përkatëse të pajtueshmërisë me pikën 21.A.125(a).

b) Çdo procedurë e testimit të prodhimit përfshin të paktën sa më poshtë:

1. Një kontroll mbi cilësitë e përdorimit;
2. Një kontroll mbi performancën e fluturimit (duke përdorur instrumentet normal të avionit);
3. Një kontroll mbi funksionimin e duhur të të gjitha pajisjeve dhe sistemeve të avionit;
4. Një përcaktim se të gjithë instrumentet janë të shënuar në mënyrën e duhur dhe të gjitha tabelat dhe manualat e kërkuara të fluturimit janë instaluar pas provës së fluturimit;
5. Një kontroll të karakteristikave funksionale të avionit në tokë;
6. Një kontroll mbi çdo artikull tjetër të veçantë të avionit të testuar.

#### **21.A.128 Provat: motorët dhe helikat**

Çdo prodhues motorësh, ose helikash të prodhuara sipas kësaj nënpjesë vendos çdo motor ose helikë me regjistrim

në një provë të pranueshme funksionale siç specifikohet në dokumentacionin e mbajtësit të certifikatës së tipit, për të përcaktuar nëse punon në mënyrën e duhur brenda funksionit për të cilën ka marrë certifikatë të tipit, si një mënyrë për të vendosur aspekte përkatëse të pajtueshmërisë me pikën 21.A.125(a).

#### **21.A.129 Detyrimet e prodhuesit**

Çdo prodhues i një produkti, pjese ose pajisjeje që prodhohet sipas kësaj nënpjesë:

a) Vendos në dispozicion çdo produkt, pjesë ose pajisje për inspektim nga AAC.

b) Ruan në vendin e prodhimit të dhënat dhe vizatimet teknike që janë të nevojshme për të përcaktuar nëse produkti pajtohet me të dhënat e zbatueshme të projektimit.

c) Ruan sistemin e inspektimit të prodhimit i cili siguron që çdo produkt përputhet me të dhënat e zbatueshme të projektimit dhe është në gjendje për operim të sigurt.

d) Jep asistencë për mbajtësin e certifikatës së tipit, certifikatës së tipit të kufizuar ose miratimit të projektit për sa i përket çdo veprimi të vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore që është i lidhur me produktin, pjesën ose pajisjen që është prodhuar.

e) Vendos dhe ruan një sistem të brendshëm të raportimit të ngjarjeve në interes të sigurisë operationale, për të mundësuar mbledhjen dhe vlerësimin e raporteve të ngjarjeve në mënyrë që të identifikohen tendencat e dëmshme ose për të adresuar mangësitë, si dhe për të nxjerrë ngjarje të raportueshme. Ky sistem duhet të përfshijë një vlerësim të informacionit paraprak në lidhje me ngjarjet dhe përhapjen e informacionit të ngjarjes.

f) 1. Raporton te mbajtësi i certifikatës së tipit, certifikatës së tipit të kufizuar ose miratimit të projektit, të gjitha rastet në të cilat produktet, pjesët ose pajisjet janë lejuar për shërbim nga prodhuesi dhe më vonë janë identifikuar me devijime nga të dhënat e zbatueshme të projektimit, si dhe inspekton së bashku me mbajtësin e certifikatës së tipit, certifikatës së tipit të kufizuar ose miratimit të projektit për të identifikuar ato devijime të cilat mund të çojnë në një gjendje të pasigurt.

2. Raporton pranë Agjencisë dhe AAC-së devijimet të cilat mund të çojnë në një gjendje të pasigurt të identifikuar sipas nënparagrafit (1). Raporte të tilla duhet të kryhen në formën dhe mënyrën e vendosur nga AAC sipas pikës

21.A.3(b)(2) ose të pranuar nga AAC kur ato janë vendosur nga Agjencia.

3. Atëherë kur prodhuesi vepron si furnizues për një organizatë tjetër prodhuese, raporton gjithashtu tek organizata tjetër të gjitha rastet kur ka lejuar në shërbim produkte, pjesë ose pajisje për atë organizatë dhe më vonë i ka identifikuar ato me devijime të mundshme nga të dhënat e zbatueshme të projektimit.

#### **21.A.130 Deklarata e përputhshmërisë**

a) Çdo prodhues i një produkti, pjesë ose pajisjeje të prodhuar sipas kësaj nënpjesë harton një deklaratë të përputhshmërisë, sipas një forme 52 të Republikës së Shqipërisë sipas modelit EASA (shiko shtojcën VIII), për gjithë avionin, ose sipas një forme 1 të Republikës së Shqipërisë sipas modelit të EASA-s (shiko shtojcën I), për produktet, pjesët ose pajisjet e tjera. Kjo deklaratë duhet të firmoset nga një person i autorizuar i cili mban një pozicion me përgjegjësi në organizatën prodhuese.

b) Një deklaratë përputhshmërie përfshin:

1. Për çdo produkt, pjesë ose pajisje, një deklaratë se produkti ose pajisja, është në përputhje me të dhënat e miratuara të projektit dhe është në gjendje për funksionim të sigurt; dhe

2. Për çdo avion, një deklaratë që avioni është kontrolluar në tokë dhe fluturim në përputhje me pikën 21A.127 (a); dhe

3. Për çdo motor ose helikë të ndryshueshme, një deklaratë që motori ose helika i është nënshtruar nga prodhuesi një testi funksional final në përputhje me pikën 21A.128; dhe

4. Përveç kësaj, në rastin e motorëve, një deklaratë që motori i kompletuar është në përputhje me kërkesat e zbatueshme të shkarkimeve të gazrave në datën e prodhimit të motorit.

c) Çdo prodhues i një produkti, pjesë ose pajisjeje të tillë prezanton:

1. Pas transferimit fillestar nga ai të pronësisë së një produkti, pjesë ose pajisjeje të tillë; ose

2. Pas aplikimit për lëshimin origjinal të një certifikate të vlefshmërisë ajrore të një avioni; ose

3. Pas aplikimit për lëshimin origjinal të një dokumenti lejimi të vlefshmërisë ajrore për një motor, një helikë, një pjesë ose pajisje, një deklaratë aktuale të përputhshmërisë, për miratim nga AAC.

d) AAC miraton nëpërmjet një kundër-firme deklaratën e përputhshmërisë nëse zbulon pas inspektimit se produkti, pjesa ose pajisja përputhet me të dhënat e

zbatueshme të projektimit dhe është në gjendje për operim të sigurt.

#### **NËNPJESA G - MIRATIMI I ORGANIZATËS PRODHUESE**

##### **21.A.131 Qëllimi**

Kjo nënpjesë vendos:

a) Procedurën për lëshimin e një miratimi të organizatës prodhuese për një organizatë prodhuese e cila tregon pajtueshmërinë e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve me të dhënat e zbatueshme të projektit.

b) Rregullat që drejtojnë të drejtat dhe detyrimet e aplikantit dhe mbajtësit të këtyre miratimeve.

##### **21.A.133 Pranueshmëria**

Çdo person fizik ose juridik ('organizatë') pranohet si një aplikant për një miratim sipas kësaj nënpjesë. Aplikanti duhet të:

a) justifikojë se, për një qëllim të caktuar pune, është i përshtatshëm një miratim sipas kësaj nënpjesë për qëllimin e demonstrimit të pajtueshmërisë me një projekt specifik; dhe

b) mbajë ose ketë aplikuar për një miratim të atij projekti specifik; ose

c) ketë siguruar, nëpërmjet një marrëveshjeje të përshtatshme me aplikuesin ose mbajtësin e miratimit të atij projekti specifik një koordinim të kënaqshëm midis prodhimit dhe projektit.

##### **21.A.134 Aplikimi**

Çdo aplikim për miratimin e një organizate prodhuese i drejtohet AAC-së në një formë dhe mënyrë të përcaktuar nga AAC dhe përfshin një përshkrim të informacionit të kërkuar nga pika 21.A.143, si dhe kushtet e miratimit të kërkuara për t'u lëshuar sipas pikës 21.A.151.

##### **21.A.135 Lëshimi i miratimit të organizatës prodhuese**

Një organizate i jepet e drejta të ketë një miratim të organizatës prodhuese të lëshuar nga AAC kur ajo të ketë treguar pajtueshmëri me kërkesat e zbatueshme të kësaj nënpjesë.

##### **21.A.139 Sistemi i cilësisë**

a) Organizata prodhuese demonstroi se ka vendosur dhe është e aftë të mbajë një sistem cilësie. Sistemi i cilësisë dokumentohet. Ky sistem cilësie është i tillë saqë t'i mundësojë organizatës të sigurojë që secili produkt, pjesë ose pajisje e prodhuar nga organizata ose nga partnerët e saj, ose e furnizuar apo e nënkontraktuar me palë të jashtme, është në përputhje me të dhënat e

zbatueshme të projektit, se është në gjendje për operim të sigurt dhe se ushtron kështu privilegjet e parashtruara te pika 21.A.163.

b) Sistemi i cilësisë përmban:

1. Siç është e zbatueshme brenda qëllimit të miratimit, procedura kontrolli për:

i) lëshimin, miratimin, ose ndryshimin e dokumentacionit;

ii) auditimin dhe kontrollin e vlerësimit të shitësit dhe nënkontraktuesit;

iii) verifikimin që produktet, pjesët, materialet, dhe pajisjet që vijnë, duke përfshirë artikujt e furnizuar të rinj ose të përdorur të furnizuar nga blerësit e produkteve, janë sipas specifikimeve në të dhënat e zbatueshme të projektimit;

iv) identifikimin dhe gjurmimin;

v) proceset e prodhimit;

vi) inspektimin dhe testimin, duke përfshirë provat në fluturim të produktit;

vii) kalibrimin e veglave, shablloneve dhe pajisjet e provave;

viii) kontrollin e sendeve për papajtueshmëri;

ix) koordinimin e vlefshmërisë ajrore me aplikantin ose mbajtësin e miratimit të projektit;

x) përmbushjen dhe ruajtjen e të dhënave;

xi) kompetencën dhe kualifikimin e personelit;

xii) lëshimin e dokumenteve të vlefshmërisë ajrore për lejimin në shërbim;

xiii) trajtimin, magazinimin dhe paketimin;

xiv) auditet e brendshme të cilësisë dhe veprimet korrigjuese që pasojnë;

xv) punën brenda kushteve të miratimit të kryera në çdo vendndodhje përveç objekteve të miratuara;

xvi) punën e kryer pas përfundimit të prodhimit, por para shpërndarjes, për të mbajtur avionin në një gjendje për operim të sigurt.

xvii) lëshimin e lejes për fluturim dhe miratimin e kushteve shoqëruese të fluturimit.

Procedurat e kontrollit kanë nevojë të përfshijnë udhëzime specifike për çdo pjesë kritike.

2. Një funksion të pavarur të garantimit të cilësisë për të monitoruar pajtueshmërinë, dhe kompetencën e procedurave të dokumentuara të sistemit të cilësisë. Ky monitorim përfshin një sistem mbështetës për personin ose grupin e personave të referuar në pikën 21.A.145(c)(2) dhe së fundi te menaxheri i cituar në pikën 21.A.145(c)(1) për të siguruar, sipas nevojës, veprime korrigjuese.

## 21 A. 143 Manuali

a) Organizata i paraqet AAC-së një Manual të organizatës prodhuese duke dhënë informacionin e mëposhtëm:

1. Një deklaratë të nënshkruar nga menaxheri përgjegjës që konfirmon se manuali i organizatës së prodhimit dhe çdo manual tjetër shoqërues të cilët përcaktojnë pajtueshmërinë e organizatës së miratuar të prodhimit me këtë nënpjesë, janë në përputhje me të gjatë gjithë kohës.

2. Pozicionin (pozicionet) dhe emrat e menaxherëve të pranuar nga AAC në përputhje me pikën 21.A.145(c)(2).

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e menaxherit (menaxherëve) siç kërkohet nga 21.A.145(c)(2) duke përfshirë çështjet me të cilat ata mund të merren direkt me AAC-në në emër të organizatës.

4. Një strukturë organizative që tregon zinxhirin e përgjegjësive të menaxherëve siç kërkohet nga pika 21.A.145(c)(1) dhe (2).

5. Një listë të stafit certifikues siç citohet në pikën 21.A.145(d).

6. Një përshkrim të përgjithshëm të burimeve të fuqisë njerëzore.

7. Një përshkrim të përgjithshëm të objekteve që ndodhen në secilën adresë të specifikuar në certifikatën e miratimit të organizatës prodhuese.

8. Një përshkrim të përgjithshëm të qëllimit të punës së organizatës prodhuese që ka lidhje me kushtet e miratimit.

9. Procedurën për njoftimin tek AAC të ndryshimeve organizative.

10. Procedurën për amendimin e Manualit të organizatës prodhuese.

11. Një përshkrim të sistemit të cilësisë dhe procedurat siç kërkohet nga pika 21.A.139(b)(1).

12. Një listë të palëve të jashtme të cituara në pikën 21.A.139(a).

13. Nëse duhet të kryhen teste të fluturimit, duhet të jepet një manual i operimeve të testimit të fluturimit që përcakton politikat dhe procedurat e organizatës në lidhje me testin e fluturimit. Manuali i operimeve të testimit të fluturimit përfshin:

i) një përshkrim të proceseve të organizatës për testimin e fluturimit, duke përfshirë pjesëmarrjen e organizatës së testimit të fluturimit në procesin për lëshimin e lejes së fluturimit;

ii) politikën e ekuipazhit, duke përfshirë përbërjen, kompetencën, kohëzgjatjet dhe kufizimet kohore të fluturimit, në përputhje me

shtojcën XII të këtij aneksi i (pjesa 21), aty ku është e aplikueshme;

iii) procedurat për transportimin e personave të ndryshëm nga anëtarët e ekuipazhit dhe për trajnimin e testit në fluturim, kur është e aplikueshme;

iv) një politikë për menaxhimin e rrezikut dhe menaxhimin e sigurisë në fluturim dhe metodologjitë përkatëse;

v) procedurat për identifikimin e instrumenteve dhe pajisjeve që do të kryhen;

vi) një listë me dokumentet që duhen përgatitur për testin e fluturimit.

b) Manuali i organizatës prodhuese amendohet sipas nevojës për të qëndruar si një përshkrim i përditësuar i organizatës dhe AAC-së duhet t'i jepen kopje të çdo amendimi.

#### **21.A.145 Kërkesat e miratimit**

Organizata prodhuese demonstroi, mbi bazën e informacionit të dorëzuar në përputhje me pikën 21.A.143, që:

a) për sa i përket kërkesave të përgjithshme të miratimit, objekteve, kushteve të punës, mjeteve dhe veglave, proceseve dhe materialeve shoqëruese, numrit dhe kompetencës së stafit, si dhe organizimit të përgjithshëm, ato janë të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet sipas pikës 21.A.165.

b) për sa i përket të gjitha të dhënave të nevojshme të vlefshmërisë ajrore, zhurmës, ventilimit të karburantit, dhe emetimeve të shkarkimeve:

1. Organizata prodhuese merr vazhdimisht të dhëna të tilla nga AAC dhe/ose Agjencia, dhe nga mbajtësi ose aplikanti për certifikatën e tipit, certifikatën e tipit të kufizuar, ose miratimin e projektit, për të përcaktuar pajtueshmëri me të dhënat e zbatueshme të projektit.

2. Organizata prodhuese ka vendosur një procedurë për të siguruar që vlefshmëria ajrore, zhurma, ventilimi i karburantit, dhe emetimet e shkarkimeve janë të integruara në mënyrë të saktë në të dhënat e saj të prodhimit.

3. Këto të dhëna mbahen të përditësuara dhe i vihen në dispozicion të gjithë personelit i cili ka nevojë që të hyjë te këto të dhëna për të kryer detyrat e tyre.

c) Në lidhje me menaxhimin dhe stafin:

1. Nga organizata prodhuese emërohet një menaxher dhe ai është përgjegjës ndaj AAC-së. Përgjegjësia e tij ose e saj brenda organizatës është që të sigurojë që i gjithë

prodhimi të kryhet sipas standardeve të kërkuara dhe që organizata prodhuese të jetë vazhdimisht në përputhje me të dhënat dhe procedurat e identifikuar në manual të cituara në pikën 21.A.143.

2. Nga organizata prodhuese emërohet një person ose grup personash për të siguruar që organizata është në përputhje me kërkesat e kësaj pjese dhe ata janë identifikuar së bashku dhe me shtrirjen e autoritetit të tyre. Një person ose persona të tillë veprojnë nën autoritetin e drejtpërdrejtë të menaxherit përgjegjës të cituar në nënparagrafin (1). Personat e emëruar duhet të jenë në gjendje të tregojnë njohuritë përkatëse, formimin dhe eksperiencën për të përmbushur përgjegjësitë e tyre.

3. Stafit në të gjitha nivelet i është dhënë autoriteti i duhur për të qenë në gjendje të ushtrorë kompetencat e caktuara, si dhe ka një koordinim të plotë dhe efektiv brenda organizatës prodhuese në lidhje me të dhënat e çështjeve të vlefshmërisë ajrore, zhurmës, ventilimit të karburantit dhe emetimit të shkarkimeve.

d) Në lidhje me stafin certifikues të autorizuar nga organizata prodhuese për të firmosur dokumentet e lëshuara në përputhje me pikën 21.A.163 sipas qëllimit ose kushteve të miratimit:

1. Njohuria, formimi (duke përfshirë funksione të tjera në organizatë) dhe eksperiencia e stafit certifikues janë të përshtatshme për të përmbushur përgjegjësitë e tyre të caktuara.

2. Organizata prodhuese ruan të dhënat e të gjithë stafit certifikues të cilat duhet të përfshijnë detaje të fushës së veprimit të autorizimit të tyre.

3. Stafit certifikues pajiset me të dhëna të fushës së veprimit të autorizimit të tyre.

#### **21.A.147 Ndryshimet në organizatën prodhuese të miratuar**

a) Pas lëshimit të një miratimi të organizatës prodhuese, çdo ndryshim në organizatën prodhuese të miratuar që është i rëndësishëm për të vërtetuar pajtueshmërinë ose vlefshmërinë ajrore dhe karakteristikat e zhurmës, ventilimit të karburantit dhe emetimeve të mbetjeve të produktit, pjesës ose pajisjes, veçanërisht ndryshimet në sistemin e cilësisë, miratohet nga AAC. AAC-së i paraqitet një aplikim me shkrim dhe organizata i demonstroi AAC-së përpara

zbatimit të ndryshimit, se do të vazhdojë të jetë në përputhje me këtë nënpjesë.

b) AAC vendos kushtet sipas së cilave një organizatë prodhuese e miratuar sipas kësaj nënpjesë mund të funksionojë gjatë ndryshimeve të tilla me përjashtim të rastit kur AAC përcakton se miratimi duhet të pezullohet.

#### **21.A.148 Ndryshimet e vendndodhjes**

Një ndryshim i vendndodhjes së strukturave prodhuese të organizatës prodhuese të miratuar konsiderohet me rëndësi dhe prandaj duhet të jetë në përputhje me pikën 21.A.147.

#### **21.A.149 Mundësia për t'u transferuar**

Përveçse rasteve të ndryshimit të pronësisë, që konsiderohen me rëndësi për qëllimet e pikës 21.A.147, miratimi i organizatës prodhuese nuk është i transferueshëm.

#### **21.A.151 Kushtet e miratimit**

Kushtet e miratimit duhet të identifikojnë qëllimin e punës, produktet ose kategoritë e pjesëve dhe pajisjeve, ose të dyja, për të cilat mbajtësi ka të drejtë të ushtrojë privilegjet sipas pikës 21.A.163.

Këto kushte lëshohen si pjesë e një miratimi të organizatës prodhuese.

#### **21.A.153 Ndryshimet në kushtet e miratimit**

Çdo ndryshim në kushtet e miratimit miratohet nga AAC. Një aplikim për një ndryshim në kushtet e miratimit duhet të bëhet sipas një forme dhe mënyre të vendosur nga AAC. Aplikanti pajtohet me kërkesat e zbatueshme të kësaj nënpjesë.

#### **21.A.157 Inspektimet**

Një organizatë prodhuese bën ato përgatitje që i lejojnë AAC-së të kryejë çdo inspektim, duke përfshirë inspektimet e partnerëve dhe nënkontraktuesve, të nevojshëm për të përcaktuar pajtueshmërinë dhe vazhdueshmërinë e pajtueshmërisë me kërkesat e zbatueshme të kësaj nënpjesë.

#### **21.A.158 Gjetjet**

a) Kur zbulohen të dhëna objektive të cilat tregojnë papajtueshmërinë e mbajtësit të miratimit të organizatës prodhuese me kërkesat e zbatueshme të kësaj pjesë, gjetjet klasifikohen si më poshtë:

1 Një gjetje e nivelit 1 është çdo papajtueshmëri me këtë pjesë e cila mund të çojë në papajtueshmëri të

pakontrolluara me të dhënat e zbatueshme të projektit dhe e cila mund të ndikojë në sigurinë e avionit.

2. Një gjetje e nivelit 2 është çdo papajtueshmëri me këtë pjesë e cila nuk është e klasifikuar si niveli një.

b) Një gjetje e nivelit 3 është çdo artikull në të cilin është identifikuar, me anë të të dhënave objektive, përmbajtja e problemeve potenciale të cilat mund të çojnë drejt një papajtueshmërie sipas paragrafit (a).

c) Pas marrjes së njoftimit të gjetjeve sipas pikës 21.B.225,

1. Në rast të një gjetjeje të nivelit një, mbajtësi i miratimit të organizatës prodhuese demonstroi veprime korrigjuese të pranueshme për AAC-në brenda një periudhe jo më të madhe se 21 ditë pune pas konfirmimit me shkrim të gjetjes;

2. Në rastin e gjetjeve të nivelit dy, periudha e veprimit korrigjues e dhënë nga AAC është në përshtatje me natyrën e gjetjes, por në çdo rast fillimisht nuk duhet të jetë më e madhe se tre muaj. Në rrethana të caktuara dhe në varësi të natyrës së gjetjes, AAC mund të zgjasë periudhën tre mujore në varësi të një plani veprimi korrigjues të pranuar nga AAC.

3. Një gjetje e nivelit 3 nuk kërkon veprim të menjëhershëm nga mbajtësi i miratimit të organizatës prodhuese.

d) Në rastin e gjetjeve të nivelit një ose nivelit dy, miratimi i organizatës prodhuese mund t'i nënshtrohet një kufizimi të pjesshëm ose të plotë, pezullimi ose revokimi sipas pikës 21.B.145. Mbajtësi i miratimit të organizatës prodhuese jep në kohë një konfirmim të marrjes së njoftimit të kufizimit, pezullimit ose revokimit të miratimit të organizatës prodhuese.

#### **21.A.159 Kohëzgjatja dhe vazhdueshmëria e vlefshmërisë**

a) Një miratim i organizatës prodhuese lëshohet për një kohëzgjatje të pakufizuar. Ai mbetet i vlefshëm me përjashtim kur:

1. Organizata prodhuese nuk arrin të demonstrojë pajtueshmërinë me kërkesat e zbatueshme të kësaj nënpjesë; ose

2. AAC pengohet nga mbajtësi ose nga ndonjë nga partnerët e tij ose nënkontraktuesi që të kryejë inspektimet në përputhje me pikën 21.A.157; ose

3. Ka të dhëna që organizata prodhuese nuk mund të ruajë kontroll të kënaqshëm në prodhimin e produkteve, pjesëve, ose pajisjeve sipas marrëveshjes; ose

4. Organizata prodhuese nuk përmbush më kërkesat e pikës 21.A.133; ose

5. Certifikata është dorëzuar ose revokuar sipas pikës 21.B.245.

b) Me dorëzimin ose revokimin, certifikata i kthehet AAC-së.

#### **21.A.163 Privilegjet**

Në vazhdimësi të kushteve të miratimit të lëshuara sipas pikës 21.A.135, mbajtësi i miratimit të organizatës prodhuese mundet:

a) Të kryejë aktivitete prodhuese sipas kësaj pjese;

b) Në rastin e avionit të plotë dhe pas prezantimit të një deklarate pajtueshmërie (forma 52 e Republikës së Shqipërisë sipas modelit të EASA-s) sipas pikës 21.A.174, të marrë një certifikatë të vlefshmërisë ajrore të mjetit fluturues dhe një certifikatë zhurme pa qenë nevoja e një demonstrimi të mëtejshëm;

c) Në rastin e produkteve, pjesëve ose pajisjeve të tjera, të lëshojë certifikatat e autorizuar të lejimit në shërbim (forma 1 e Republikës së Shqipërisë, sipas modelit të EASA-s) pa qenë nevoja e një demonstrimi të mëtejshëm;

d) Të mirëmbajë një avion të ri të cilin e ka prodhuar dhe të lëshojë një certifikatë të lejimit në shërbim (forma 53 e Republikës së Shqipërisë, sipas modelit EASA-s) për sa i përket asaj mirëmbajtjeje;

e) Sipas procedurave të rëna dakord me AAC- në për prodhimin, për një avion që ajo ka prodhuar dhe kur vetë organizata prodhuese kontrollon sipas miratimit të saj si organizatë prodhimi konfigurimin e avionit dhe vërteton konformitetin me kushtet e projektimit të miratuara për fluturim, të lëshojë një leje për të fluturuar në përputhje me pikën 21.A.711 (c) duke përfshirë miratimin e kushteve të fluturimit në përputhje me pikën 21.A.710 (b).

#### **21.A.165 Detyrimet e mbajtësit**

Mbajtësi i një miratimi të organizatës prodhuese:

a) Siguron se Manuali i organizatës prodhuese i ofruar, i përgatitur sipas pikës 21.A.143 dhe dokumentet të cilëve i referohet, përdoren si dokumente pune bazë brenda organizatës;

b) Mban organizatën prodhuese në pajtueshmëri me të dhënat dhe procedurat e miratuara për miratimin e organizatës prodhuese;

c) 1. Përcakton se çdo avion i kompletuar është në përputhje me projektin e tipit dhe është në gjendje për

operim normal përpara dorëzimit të deklaratave së pajtueshmërisë tek AAC; ose

2. Përcakton se produktet, pjesët ose pajisjet e tjera janë të plota dhe janë në përputhje me të dhënat e miratuara të projektimit dhe janë në gjendje për operim të sigurt para lëshimit të Formës 1 të Republikës së Shqipërisë sipas modelit të EASA-s, për të vërtetuar përputhshmërinë me të dhënat e miratuara të projektimit dhe kushtin për operim të sigurt;

3. Përveç kësaj, në rastin e motorëve, përcakton se motori i kompletuar është në përputhje me kërkesat e emetimit të gazrave të aplikueshme në datën e prodhimit të motorit;

4. Përcakton se produktet, pjesët ose pajisjet e tjera janë në përputhje me të dhënat e zbatueshme përpara lëshimit të formës 1 të Republikës së Shqipërisë sipas modelit të EASA-s si një certifikatë pajtueshmërie.

d) Regjistron të gjitha detajet e punës së kryer;

e) Vendos dhe ruan një sistem të brendshëm të raportimit të ngjarjeve në interes të sigurisë në fluturim, për të mundësuar mbledhjen dhe vlerësimin e raporteve të ngjarjeve në mënyrë që të identifikohen tendenca të dëmshme ose të adresohen mangësi dhe për të nxjerrë ngjarje të raportueshme. Ky sistem duhet të përfshijë një vlerësim të informacionit përkatës që lidhet me ngjarjet dhe përhapjen e informacionit përkatës;

f) 1. Raporton te mbajtësi i certifikatës së tipit ose miratimit të projektit, të gjitha rastet në të cilat produktet, pjesët ose pajisjet janë lejuar për shërbim nga organizata prodhuese dhe janë identifikuar më vonë me devijime nga të dhënat e zbatueshme të projektit, si dhe heton së bashku me mbajtësin e certifikatës së tipit ose miratimit të projektit për të identifikuar ato devijime të cilat mund të çojnë në një gjendje të pasigurt;

2. Raporton pranë Agjencisë dhe AAC-së devijimet të cilat mund të çojnë në një gjendje të pasigurt të identifikuar sipas nënparagrafit (1). Raporte të tilla kryhen në formën dhe mënyrën e vendosur nga AAC sipas pikës 21.A.3(b)(2) ose të pranuar nga AAC kur ato janë vendosur nga Agjencia;

3. Atje ku mbajtësi i miratimit të organizatës prodhuese vepron si furnizues për një organizatë tjetër prodhuese, raporton gjithashtu tek organizata tjetër të gjitha rastet kur ka lejuar në shërbim produkte, pjesë ose pajisje për atë organizatë dhe

më vonë i ka identifikuar ato me devijime të mundshme nga të dhënat e zbatueshme të projektimit;

g) Jep asistencë për mbajtësin e certifikatës së tipit ose miratimin e projektit në lidhje me çdo veprim të vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore që lidhet me produktet, pjesët ose pajisjet që janë prodhuar;

h) Vendos një sistem arkivimi i cili integron kërkesat e vendosura mbi partnerët e tij, furnizuesit dhe nënkontraktuesit, duke siguruar ruajtjen e të dhënave të përdorura për të justifikuar pajtueshmërinë e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve. Këto të dhëna janë në dispozicion të AAC-së dhe ruhen në mënyrë që të japin informacionin e nevojshëm për të siguruar vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të produkteve, pjesëve ose pajisjeve;

i) Atëherë kur, sipas kushteve të tij të miratimit, mbajtësi lëshon një certifikatë të lejimit në shërbim, përcakton se çdo avion i përfunduar i është nënshtruar mirëmbajtjes së nevojshme dhe është në gjendje për operim të sigurt, përpara lëshimit të certifikatës;

j) Kur është e zbatueshme, sipas privilegjit të paragrafit 21.A.163 (e), përcakton kushtet sipas të cilave lëshohet një leje për të fluturuar;

k) Kur është e zbatueshme, sipas privilegjit të pikës 21.A.163 (e), vendos përputhjen me paragrafët 21.A.711 (c) dhe (e) para se të lëshohet leja e fluturimit për një avion.

## NËNPJESA H - CERTIFIKATAT E VLEFSHMËRISË AJRORE DHE CERTIFIKATAT E KUFIZUARA TË VLEFSHMËRISË AJRORE

### 21.A.171 Fushëveprimi

Kjo nënpjesë vendos procedurën për lëshimin e certifikatave të vlefshmërisë ajrore.

### 21.A.172 Pranueshmëria

Çdo person fizik ose juridik në emrin e të cilit një avion është regjistruar ose do të regjistrohet në Republikën e Shqipërisë (shteti i regjistrimit), ose përfaqësuesi i tij, është i pranueshëm si një aplikant për një certifikatë të vlefshmërisë ajrore për atë mjet fluturues sipas kësaj nënpjesë.

### 21.A.173 Klasifikimi

Certifikatat e vlefshmërisë ajrore klasifikohen si më poshtë:

a) Certifikatat e vlefshmërisë ajrore i lëshohen avionit i cili është në përputhje me certifikatën e tipit që është lëshuar sipas kërkesave të këtij aneksi

I.

b) Certifikatat e kufizuara të vlefshmërisë ajrore duhet t'i lëshohen avionëve:

1. Të cilët përputhen me një certifikatë tip të kufizuar e cila është lëshuar në përputhje me këtë Aneks I; ose;

2. Të cilët i kanë treguar AAC dhe/ose Agjencisë së përputhen me specifikimet e veçanta të vlefshmërisë ajrore duke garantuar siguri operationale të mjaftueshme.

### 21.A.174 Aplikimi

a) Në vijim të parashikimeve të pikës 21.A.172, një aplikim për një certifikatë të vlefshmërisë ajrore bëhet sipas një mënyre dhe forme të vendosur nga AAC, pasi Shqipëria është shteti ku është bërë regjistrimi.

b) Çdo aplikim për një certifikatë të vlefshmërisë ajrore apo certifikatë të kufizuar të vlefshmërisë ajrore përfshin:

1. Klasin e certifikatës së vlefshmërisë ajrore për të cilën aplikohet;

2. Në lidhje me avionët e rinj:

i) Një deklaratë pajtueshmërie:

- të lëshuar sipas pikës 21.A.163 (b), ose

- të lëshuar sipas pikës 21.A.130, dhe të bërë të vlefshme nga AAC, ose

- për një avion të importuar, një deklaratë të firmosur nga autoriteti eksportues që avioni përputhet me një projekt të miratuar nga Agjencia.

ii) Një raport të peshës dhe balancës me një program ngarkimi.

iii) Manualin e fluturimit, kur kërkohet nga specifikimet e zbatueshme të certifikimit për avionin përkatës.

3. Në lidhje me avionët e përdorur:

i) që e kanë origjinën nga një shtet anëtar i BE- së ose i ZPEA-së, sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, një certifikatë rishikimi të vlefshmërisë ajrore, të lëshuar në përputhje me pjesën M;

ii) që e kanë origjinën nga çdo vend tjetër që nuk është i Bashkimit Evropian ose i Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe:

- një deklaratë nga autoriteti kompetent ku është, ose ishte, i regjistruar, duke reflektuar statusin e vlefshmërisë ajrore të avionit në regjistrin e tij në kohën e transferimit,

- një raport të peshës dhe balancës me një program ngarkimi,
  - manualin e fluturimit kur një material i tillë kërkohet nga kodi i zbatueshëm i vlefshmërisë ajrore për avionin e veçantë,
  - të dhënat nga historiku për të vendosur që standardet e prodhimit, modifikimit dhe mirëmbajtjes së avionit, duke përfshirë të gjitha kufizimet e lidhura me një certifikatë të kufizuar të vlefshmërisë ajrore sipas pikës 21.A.184 (c),
  - një rekomandim për lëshimin e certifikatës së vlefshmërisë ajrore ose certifikatës së kufizuar të vlefshmërisë ajrore dhe një certifikatë të rishikimit të vlefshmërisë mbas një rishikimi të vlefshmërisë ajrore në përputhje me pjesën M.
- c) Me përjashtim të rasteve kur është rënë dakord ndryshe, deklaratat e cituara në nënparagrafët (b)(2)(i) dhe (b)(3)(ii) lëshohen jo më shumë se 60 ditë përpara prezantimit të mjetit fluturues në AAC.

#### **21.A.175 Gjuha**

Manualet, tabelat njoftuese, listat, dhe shenjat e instrumenteve dhe informacionet e tjera të nevojshme të kërkuara nga specifikimet e zbatueshme të certifikimit prezantohen në gjuhën shqipe, angleze ose në një gjuhë tjetër zyrtare të Bashkimit Evropian të pranueshme nga AAC. Manualet mund të pranohen në gjuhën angleze.

#### **21.A.177 Përmirësimi ose modifikimi**

Një certifikatë e vlefshmërisë ajrore mund të përmirësohet ose modifikohet vetëm nga Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar, si autoriteti i vendit ku është bërë regjistrimi.

#### **21.A.179 Mundësia për t'u transferuar dhe rilëshimi brenda vendeve të Bashkimit Evropian**

- a) Atëherë kur ka ndryshuar pronësia e një avioni:
1. Nëse ai qëndron në të njëjtin regjistër, certifikata e vlefshmërisë ajrore, ose certifikata e kufizuar e vlefshmërisë ajrore që përputhet vetëm me një certifikatë të tipit, transferohet së bashku me avionin;
  2. Nëse avioni është i regjistruar në një Shtet tjetër Anëtar, certifikata e vlefshmërisë ajrore ose certifikata e kufizuar e vlefshmërisë ajrore që përputhet me një certifikatë të tipit të kufizuar lëshohet:
    - i) me paraqitjen e certifikatës së mëparshme të vlefshmërisë ajrore dhe një certifikate të vlefshme të rishikimit të vlefshmërisë ajrore të lëshuar sipas pjesës M; dhe

ii) kur plotëson pikën 21.A.175

- b) Kur pronësia e një avioni ka ndryshuar dhe avioni ka një certifikatë të kufizuar të vlefshmërisë ajrore që nuk përputhet me një certifikatë të tipit të kufizuar, certifikatat e vlefshmërisë ajrore do të transferohen së bashku me avionin me kusht që avioni të mbetet në të njëjtin regjistër ose të lëshohen vetëm me marrëveshje zyrtare të autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar të Regjistrimit në të cilin është transferuar.

#### **21.A.180 Inspektimet**

Mbajtësi i certifikatës së vlefshmërisë ajrore lejon hyrjen në avionin për të cilin është lëshuar certifikata e vlefshmërisë ajrore pas kërkesës së Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar, si autoriteti i vendit ku është bërë regjistrimi.

#### **21.A.181 Kohëzgjatja dhe vazhdueshmëria e vlefshmërisë**

- a) Një certifikatë e vlefshmërisë ajrore lëshohet për një kohëzgjatje të pakufizuar. Ajo qëndron e vlefshme në varësi të:

1. Pajtueshmërisë me projektin e zbatueshëm të tipit dhe kërkesat e vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore; dhe
2. Faktit nëse avioni mbetet në të njëjtin regjistër; dhe
3. Faktit nëse certifikata e tipit ose certifikata e kufizuar e tipit sipas së cilës është lëshuar nuk është bërë më parë e pavlefshme sipas pikës 21.A.51;
4. Faktit nëse certifikata nuk është dorëzuar ose revokuar sipas pikës 21.B.330.

- b) Pas dorëzimit ose revokimit, certifikata i kthehet Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar, si autoriteti i vendit ku është bërë regjistrimi.

#### **21.A.182 Identifikimi i avionit**

Çdo aplikant për një certifikatë të vlefshmërisë ajrore sipas kësaj nënpjesë demonstroi që avioni i tij është identifikuar në përputhje me nënpjesën Q.

#### **NËNPJESA I - CERTIFIKATAT E ZHURMËS**

##### **21.A.201 Qëllimi**

Kjo nënpjesë vendos procedurën për lëshimin e certifikatave të zhurmës.

##### **21.A.203 Mundësia për t'u zgjedhur**

Çdo person fizik ose juridik nën emrin e të cilit është regjistruar ose do të regjistrohet një avion, në Republikën e Shqipërisë (Shteti i regjistrimit), ose përfaqësuesi i atij personi, është i përzgjedhshëm si



një aplikant për një certifikatë zhurme për atë mjet fluturues sipas kësaj nënpjesë.

#### **21.A.204 Aplikimi**

a) Në vijim të pikës 21.A.203, aplikimi për një certifikatë zhurme kryhet sipas formës dhe mënyrës të vendosur nga AAC, si autoriteti i vendit ku është kryer regjistrimi.

b) Çdo aplikim përfshin:

1. Në lidhje me një avion të ri:

i) Një deklaratë përputhshmërie:

- të lëshuar sipas pikës 21 A.163(b), ose
- të lëshuar sipas pikës 21 A.130 dhe e quajtur e vlefshme nga AAC.

- ose, për avionët e importuar, një deklaratë, të firmosur nga autoriteti eksportues se avioni është në përputhje me një projekt të miratuar nga Agjencia, dhe

ii) informacionin e zhurmës të përcaktuar në përputhje me kërkesat e zbatueshme të zhurmës.

2. Në lidhje me një avion të përdorur:

i) informacionin e zhurmës të përcaktuar në përputhje me kërkesat e zbatueshme të zhurmës; dhe

ii) të dhënat nga historiku për të vendosur standardet e prodhimit, modifikimit dhe mirëmbajtjes së avionit;

c) me përjashtim të rasteve kur është rënë dakord ndryshe, deklarata e cituar në nënparagrafin (b)(1) lëshohet jo më shumë se 60 ditë përpara prezantimit të avionit para AAC-së ku është kryer regjistrimi.

#### **21.A.207 Përmirësimi ose modifikimi**

Një certifikatë zhurme mund të përmirësohet ose modifikohet vetëm nga AAC ku është kryer regjistrimi.

#### **21.A.209 Mundësia për t'u transferuar dhe rilëshimi brenda vendeve anëtare të BE-së**

Atëherë kur pronësia e një mjeti fluturues ka ndryshuar:

a) nëse mjeti fluturues qëndron në të njëjtin regjistër, certifikata e zhurmës transferohet së bashku me mjetin fluturues; ose

b) nëse mjeti fluturues zhvendoset në regjistrin e një vendi tjetër anëtar, certifikata e zhurmës lëshohet me paraqitjen e certifikatës së mëparshme të zhurmës.

#### **21.A.210 Inspektimet**

Mbajtësi i certifikatës së zhurmës lejon qasjen për inspektim në avionin për të cilin është lëshuar ajo certifikatë zhurme me kërkesë të AAC-së ku është kryer regjistrimi ose të Agjencisë.

#### **21.A.211 Kohëzgjatja dhe vazhdueshmëria e vlefshmërisë**

a) Një certifikatë zhurme lëshohet për një periudhë kohore të pakufizuar. Ajo mbetet e vlefshme në varësi të:

1. Pajtueshmërisë me tipin e projektit të zbatueshëm, kërkesave të mbrojtjes mjedisore dhe vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore; dhe

2. Faktit nëse avioni qëndron në të njëjtin regjistër; dhe

3. Faktit nëse certifikata e tipit ose certifikata e tipit e kufizuar sipas së cilës është lëshuar nuk është zhvleftësuar më parë sipas pikës 21.A.51.

4. Faktit nëse certifikata nuk është e dorëzuar ose revokuar sipas pikës 21.B.430.

b) pas dorëzimit ose revokimit, certifikata i kthehet AAC-së ku është kryer regjistrimi.

#### **NËNPJESA J - MIRATIMI I ORGANIZATËS SË PROJEKTIMIT**

##### **21.A.231 Qëllimi**

Kjo nënpjesë vendos procedurën për miratimin e organizatave të projektimit dhe rregullave që udhëheqin të drejtat dhe detyrimet e aplikantit dhe mbajtësit të këtyre miratimeve.

##### **21.A.233 Pranueshmëria**

Çdo person fizik ose juridik ('organizatë') është i pranueshëm si një aplikant për një miratim sipas kësaj nënpjesë:

a) në përputhje me pikat 21.A.14, 21.A.112B, 21.A.432B ose pikën 21.A.602B; ose

b) për miratim të ndryshimeve të vogla ose projekteve të ndryshimeve të vogla, kur kërkohen për qëllimin e fitimit të privilegjeve sipas pikës 21.A.263.

##### **21.A.234 Aplikimi**

Çdo aplikim për një miratim të organizatës projektuese bëhet sipas formës dhe mënyrës së vendosur nga AAC dhe/ose Agjencia dhe përfshin një përshkrim të informacionit të kërkuar nga pika 21.A.243, si dhe kushtet e miratimit të kërkuara për t'u lëshuar sipas pikës 21.A.251.

##### **21.A.235 Lëshimi i miratimit të organizatës projektuese**

Një organizatë ka të drejtën që të ketë një miratim të organizatës projektuese të lëshuar nga AAC dhe/ose Agjencia kur ajo të ketë demonstruar pajtueshmërinë me kërkesat e zbatueshme sipas kësaj nënpjesë.

### 21.A.239 Sistemi i garantimit të projektit

a) Organizata projektuese duhet të vërtetojë se ajo ka vendosur dhe është në gjendje të ruajë një sistem të garantimit të projektit për kontrollin dhe mbikëqyrjen e projektit, dhe të ndryshimeve të projektit, të produkteve, pjesëve dhe mjeteve të mbuluara nga aplikimi. Ky sistem i garantimit të projektit duhet të jetë i tillë që t'i mundësojë organizatës:

1. Që projektimi i produkteve, i pjesëve dhe i pajisjeve ose ndryshimi i projektimit të tyre të jetë në përputhje me bazën e zbatueshme të certifikimit të tipit, bazën e zbatueshme të certifikimit të përshtatshmërisë operationale dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit; dhe

2. Të garantojë që përgjegjësitë e saj përmbushen në mënyrën e duhur në përputhje me:

- i) Dispozitat e përshtatshme të kësaj pjese; dhe
- ii) Kushtet e miratuara të lëshuara sipas pikës 21.A.251.

3. Të monitorojë në mënyrë të pavarur pajtueshmërinë dhe mjaftueshmërinë e procedurave të dokumentuara të sistemit. Ky monitorim përfshin një sistem kthim-përgjigjeje ndaj një personi ose një grupi personash që kanë përgjegjësi për të garantuar veprime korrigjuese.

b) Sistemi i garantimit të projektit përfshin një funksion kontrollues të pavarur të tregimit/vërtetimit të pajtueshmërisë mbi bazën e të cilit organizata i paraqet AAC-së dhe/ose Agjencisë deklaratat e pajtueshmërisë dhe dokumentacionin shoqëruar.

c) Organizata projektuese specifikon mënyrën sipas së cilës sistemi i garantimit të projektit garanton pranimin e pjesëve ose mjeteve të projektuara ose detyrat e kryera nga partnerët ose nënkontraktuesi sipas metodave të cilat i nënshtrohen procedurave me shkrim.

### 21.A.243 Të dhënat

a) Organizata e projektimit vë në dispozicion të AAC-së dhe/ose Agjencisë një manual që përshkruan, drejtpërdrejt ose me referencë të tërthortë, organizatën, procedurat përkatëse dhe produktet ose ndryshimet në produktet që do të projektohen. Nëse duhet të kryhen testet e fluturimit, AAC-së i jepet/dorëzohet një manual i operimeve të testimit të fluturimit që përcakton politikat dhe procedurat e organizatës në lidhje me testimin e fluturimit. Manuali i operimeve të testimit të fluturimit përfshin:

i) një përshkrim të proceseve të organizatës për testimin e fluturimit, duke përfshirë pjesëmarrjen e organizatës së testimit të fluturimit në procesin për lëshimin e lejes për të fluturuar;

ii) politikën e ekuipazhit, duke përfshirë përbërjen, kompetencën, kohëzgjatjet dhe kufizimet kohore të fluturimit, në përputhje me shtojcën XII të këtij aneksi i (pjesa 21), aty ku është e aplikueshme;

iii) procedurat për transportimin e personave të ndryshëm nga anëtarët e ekuipazhit dhe për trajnimin e testit të fluturimit, kur është e aplikueshme;

iv) një politikë për menaxhimin e rrezikut dhe menaxhimin e sigurisë në fluturim dhe metodologjitë përkatëse;

v) procedurat që do të kryhen për identifikimin e instrumenteve dhe pajisjeve që do të merren në bord;

vi) një listë me dokumentet që duhen përgatitur për testin e fluturimit.

b) Atëherë kur ndonjë pjesë ose pajisje ose ndonjë ndryshim në produkte është projektuar nga organizata partnere ose nënkontraktuese, manuali duhet të përfshijë një deklaratë se si organizata projektuese e ka të mundur të japë, për të gjitha pjesët dhe pajisjet, sigurinë e pajtueshmërisë së kërkuar nga pika 21.A.239(b), si dhe duhet të përmbajë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me anë të citimeve, përshkrime dhe informacion mbi aktivitetet projektuese dhe organizimin e atyre partnerëve ose nënkontraktuesve, sipas nevojës që mund të ekzistojë për të hartuar këtë deklaratë.

c) Manuali përmirësohet sipas nevojës me qëllim që të vazhdojë të jetë një përshkrim i përditësuar i organizatës dhe AAC-së dhe/ose Agjencisë i jepen kopje të amendamenteve.

d) Organizata projektuese vë në dispozicion një deklaratë të kualifikimeve dhe eksperiencës së stafit menaxhial dhe të personave të tjerë me përgjegjësi për marrjen e vendimeve që ndikojnë në vlefshmërinë ajrore dhe mbrojtjen mjedisore të organizatës.

### 21.A.245 Kërkesat e miratimit

Organizata e projektimit demonstroi, në bazë të informacionit të paraqitur në përputhje me pikën 21.A.243, se përveç përmbushjes së kriteve të pikës 21.A.239:

a) personeli në të gjitha departamentet teknike është i mjaftueshëm në numër dhe përvojë dhe se

atij i është dhënë autoriteti i duhur për të qenë në gjendje që të përmbushë përgjegjësitë e përcaktuara dhe se këto, së bashku me akomodimin, facilitetet dhe pajisjet janë të përshtatshme për t'i mundësuar personelit që të arrijë vlefshmërinë ajrore, përshtatshmërinë operacionale dhe objektivat e mbrojtjes së mjedisit për produktin;

b) ekziston koordinimi i plotë dhe efikas midis departamenteve dhe brenda departamenteve në lidhje me vlefshmërinë ajrore, përshtatshmërinë operacionale dhe çështjet e mbrojtjes së mjedisit.

#### **21.A.247 Ndryshimet në sistemin e garantimit të projektit**

Pas lëshimit të një miratimi të organizatës së projektimit, çdo ndryshim në sistemin e garantimit të projektimit që është i rëndësishëm për të treguar përputhshmërinë ose për vlefshmërinë ajrore, përshtatshmërinë operacionale dhe mbrojtjen e mjedisit të produktit, miratohet nga AAC dhe/ose Agjencia. Një kërkesë për miratim i dorëzohet me shkrim AAC-së dhe/ose Agjencisë dhe organizata e projektimit i demonstroi AAC-së dhe/ose Agjencisë, në bazë të dorëzimit të ndryshimeve të propozuara në manual dhe para zbatimit të ndryshimit, se ajo vazhdon të jetë në përputhje me këtë nënpjesë pas zbatimit.

#### **21.A.249 Mundësia e transferimit**

Përveç rezultatit të një ndryshimi në pronësi, i cili konsiderohet i rëndësishëm për qëllimet e pikës 21.A.247, një miratim i organizatës projektuese nuk është i transferueshëm.

#### **21.A.251 Kushtet e miratimit**

Kushtet e miratimit identifikojnë llojet e punës së projektimit, kategoritë e produkteve, të pjesëve dhe të pajisjeve për të cilat organizata e projektimit ka një miratim të organizatës së projektimit, funksionet dhe detyrat që organizata është miratuar të kryejë në lidhje me vlefshmërinë ajrore, përshtatshmërinë operacionale dhe karakteristikat e zhurmës, ventilimin e karburantit dhe shkarkimin e gazrave të produkteve. Për miratimin e organizatës së projektimit që mbulon certifikimin e tipit ose autorizimin ETSO për Njësinë Ndihmëse të Energjisë (APU), kushtet e miratimit përmbajnë gjithashtu listën e produkteve ose APU-në. Këto kushte lëshohen si pjesë e miratimit të një organizate të projektimit.

#### **21.A.253 Ndryshimet në kushtet e miratimit**

Çdo ndryshim në kushtet e miratimit miratohet nga AAC dhe/ose Agjencia. Aplikimi për ndryshimin e kushteve të

miratimit bëhet në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga AAC dhe/ose Agjencia. Organizata projektuese duhet të jetë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të kësaj nënpjesë.

#### **21.A.257 Investigimet**

a) Organizata projektuese përgatitet me qëllim që t'i mundësojë AAC-së dhe/ose Agjencisë të kryejë çdo investigim, duke përfshirë investigime të partnerëve dhe nënkontraktuesve, që janë të nevojshme për të përcaktuar përputhshmërinë dhe vazhdueshmërinë e pajtueshmërisë me kërkesat e zbatueshme të kësaj nënpjesë.

b) Organizata projektuese i mundëson AAC-së dhe/ose Agjencisë të rishikojë çdo raport, të bëjë çdo inspektim dhe të kryejë ose dëshmojë çdo provë në fluturim dhe në tokë që janë të nevojshme për të kontrolluar vlefshmërinë e deklaratave të pajtueshmërisë të paraqitura nga aplikanti sipas pikës 21.A.239(b).

#### **21.A.258 Gjetjet**

a) Kur zbulohen të dhëna objektive që tregojnë papajtueshmërinë e mbajtësit të miratimit të organizatës projektuese me kërkesat e zbatueshme të këtij aneksi I, këto gjetje klasifikohen si më poshtë:

1. Një gjetje e nivelit 1 është çdo mospërputhje me këtë aneks I e cila mund të çojë në papajtueshmëri të pakontrolluara me kërkesat e zbatueshme dhe e cila mund të ndikojë në sigurinë e avionit.

2. Një gjetje e nivelit 2 është çdo mospërputhje me këtë aneks I e cila nuk është e klasifikuar si niveli një.

b) Një gjetje e nivelit 3 është çdo artikull në të cilin është identifikuar, me anë të të dhënave objektive, përmbajtja e problemeve potenciale të cilat mund të çojnë drejt një papajtueshmërie sipas paragrafit (a).

c) Pas marrjes së njoftimit të gjetjeve sipas procedurave të zbatueshme të vendosura nga AAC dhe/ose Agjencia:

1. Në rast të një gjetjeje të nivelit një, mbajtësi i miratimit të organizatës projektuese demonstroi veprimet korrigjuese të pranueshme nga AAC dhe/ose Agjencia brenda një periudhe jo më të madhe se 21 ditë pune pas konfirmimit me shkrim të gjetjes;

2. Në rastin e gjetjeve të nivelit dy, periudha e veprimit korrigjues e dhënë nga AAC dhe/ose

Agjencia duhet të jetë në përshtatje me natyrën e gjetjes, por në çdo rast fillimisht nuk duhet të jetë më e madhe se tre muaj. Në rrethana të caktuara dhe sipas natyrës së gjetjes, AAC dhe/ose Agjencia mund të zgjasë periudhën tre mujore në varësi të një plani veprimi korrigjues të pranueshëm, të rënë dakord nga AAC dhe/ose Agjencia.

3. Një gjetje e nivelit tre nuk kërkon veprim të menjëhershëm nga mbajtësi i miratimit të organizatës projektuese.

d) Në rastin e gjetjeve të nivelit një ose nivelit dy, miratimi i organizatës projektuese mund t'i nënshtrohet një pezullimi të pjesshëm ose të plotë ose revokimi sipas procedurave të zbatueshme administrative të vendosura nga AAC dhe/ose Agjencia. Mbajtësi i miratimit të organizatës projektuese jep në kohë një konfirmim të marrjes së njoftimit të pezullimit ose revokimit të miratimit të organizatës projektuese.

#### **21.A.259 Kohëzgjatja e vazhdueshmërisë së vlefshmërisë**

a) Miratimi i organizatës projektuese lëshohet për një kohëzgjatje të pakufizuar. Ai qëndron i vlefshëm me përjashtim të rastit kur:

1. Organizata projektuese nuk arrin të demonstrojë pajtueshmërinë me kërkesat e zbatueshme të kësaj nënpjese; ose

2. AAC dhe/ose Agjencia pengohet nga mbajtësi ose çdonjëri nga partnerët ose nënkontraktuesit e saj për të kryer investigime në përputhje me pikën 21.A.257; ose

3. Ka të dhëna se sistemi i garantimit të projektit nuk mund të ruajë kontrollin dhe mbikëqyrjen e mjaftueshme të projektit të produkteve ose ndryshimeve të tyre sipas miratimit; ose

4. Certifikata është dorëzuar ose revokuar sipas procedurave të zbatueshme administrative të vendosura nga AAC dhe/ose Agjencia.

b) Pas dorëzimit ose revokimit, certifikata i kthehet AAC-së dhe/ose Agjencisë.

#### **21.A.263 Privilegjet**

a) Mbajtësi i një miratimi të organizatës projektuese ka të drejtë të kryejë aktivitete projektuese sipas këtij aneksi I dhe brenda qëllimit të saj të miratimit.

b) Në varësi të pikës 21.A.257(b), AAC dhe/ose Agjencia pranon pa verifikim të mëtejshëm dokumentet e mëposhtme të pajtueshmërisë të paraqitura nga aplikanti për qëllimin e marrjes:

1. Miratimin e kushteve të fluturimit të kërkuara për

një leje për fluturim; ose

2. Një certifikatë tipi ose miratimin e një ndryshimi të madh në një certifikatë tipi; ose;

3. Një certifikatë tipi plotësuese; ose

4. Një autorizim ETSO sipas pikës 21.A.602(b)(1); ose

5. Një miratim të një riparimi të madh të projektit.

c) Mbajtësi i një miratimi të organizatës projektuese ka të drejtën, brenda kushteve të tij të miratimit dhe sipas procedurave përkatëse të sistemit të garantimit të projektit:

1. Të klasifikojë ndryshimet në certifikatën e tipit dhe riparimet si “të mëdha” ose “të vogla”;

2. Të miratojë ndryshime të vogla në certifikatën e tipit dhe riparime të vogla;

3. Të lëshojë informacione ose udhëzime që përmbajnë deklaratën e mëposhtme: “Përmbajtja teknike e këtij dokumenti është miratuar sipas autoritetit të certifikatës së miratimit të organizatës së projektimit nr. [AAC]. 21J. [XXXX];

4. Të miratojë ndryshime të vogla në manualin e fluturimit të avionit dhe të lëshojë ndryshime të tilla që mbajnë deklaratën vijuese: “Rishikimi nr. [XX] tek AFM ref. [ZZ], miratohet sipas autoritetit të certifikatës së miratimit të organizatës së projektimit nr. [AAC]. 21J. [XXXX];

5. Të miratojë projektin e riparimeve të mëdha për produktet ose njësitë ndihmëse të fuqisë (APU) për të cilat mban certifikatën e tipit ose certifikatën e tipit plotësuese ose autorizimin ETSO;

6. Për të miratuar kushtet sipas të cilave mund të lëshohet një leje për të fluturuar sipas pikës 21.A.710 (a)(2) përveç lejeve të fluturimit që do të lëshohen për qëllime sipas pikës 21.A.701 (a)(15);

7. Për të lëshuar një leje fluturimi sipas pikës 21.A.711(b) për një avion që ai ka projektuar apo modifikuar, apo për të cilin ai ka miratuar sipas pikës 21.A.263 (c)(6) kushtet sipas të cilave mund të lëshohet leja për të fluturuar, dhe kur vetë organizata e projektimit ka nën kontroll nëpërmjet miratimit të saj si organizatë projektimi konfigurimin e avionit dhe konformitetin e dëshmuar të tij me kushtet e projektimit të miratuara për fluturimin.

#### **21.A.265 Detyrimet e mbajtësit**

Mbajtësi i një miratimi të organizatës projektuese:

- a) Mban manualin në përputhje me sistemin e garantimit të projektit;
- b) Garanton se ky manual përdoret si një dokument bazë pune brenda organizatës;
- c) Përcakton se projekti i produkteve, ose ndryshimeve ose riparimeve të tyre, sipas nevojës për zbatim, është në përputhje me kërkesat e zbatueshme dhe se nuk ka asnjë tipar të pasigurt;
- d) Përveç ndryshimeve ose riparimeve të vogla të miratuara sipas privilegjit të pikës 21.A.263, i jep AAC-së dhe/ose Agjencisë deklaratat dhe dokumentacionin shoqërues që konfirmon pajtueshmërinë me paragrafin (c);
- e) Vë në dispozicion të AAC-së dhe/ose Agjencisë informacionin ose udhëzimet që lidhen me veprimet e kërkuara sipas pikës 21.A.3B;
- f) Nëse është e zbatueshme, përcakton sipas privilegjit të pikës 21.A.263 (c)(6), kushtet sipas të cilave mund të lëshohet një leje për të fluturuar;
- g) Nëse është e zbatueshme, vendos, sipas privilegjit të pikës 21.A.263 (c) (7), përputhje me pikat 21.A.711 (b) dhe (e) përpara se të lëshojë një leje për fluturim.

NËNPJESA K - PJESËT DHE PAJISJET

#### **21.A.301 Qëllimi**

Kjo nënpjesë vendos procedurën në lidhje me miratimin e pjesëve dhe pajisjeve.

#### **21.A.303 Pajtueshmëria me kërkesat e zbatueshme**

Vërtetimi i pajtueshmërisë së pjesëve dhe pajisjeve për t'u instaluar në një produkt me certifikatë tip bëhet:

- a) në përputhje me procedurat e certifikimit të tipit të nënpjesës B, D ose E për produktin në të cilin do të instalohet; ose
- b) atje ku është e zbatueshme, sipas procedurave të autorizimit ETSO të nënpjesës O; ose
- c) në rastin e pjesëve standarde, në përputhje me standarde të njohura zyrtarisht.

#### **21.A.305 Miratimi i pjesëve dhe pajisjeve**

Në të gjitha rastet kur miratimi i një pjese ose pajisje kërkohet shprehimisht nga ligji i Bashkimit Evropian ose nga masat e AAC-së dhe/ose Agjencisë, pjesa ose pajisja duhet të jetë në përputhje me ETSO-n e zbatueshme ose me specifikimet e pranuar si ekuivalente nga AAC dhe/ose Agjencia në rastin e veçantë.

#### **21.A.307 Lejimi për instalim i pjesëve dhe pajisjeve**

Një pjesë ose pajisje duhet të jetë e pranueshme për

instalim në një produkt të certifikuar sipas tipit kur është në gjendje për operim të sigurt dhe është:

- a) E shoqëruar nga një certifikatë e autorizuar e lejimit në shërbim (formulari 1 i Republikës së Shqipërisë sipas modelit të EASA-s), që certifikon se artikulli është prodhuar në përputhje me të dhënat e miratuara të projektit dhe është shënjuar në përputhje me nënpjesën Q;
- b) Një pjesë standarde;
- c) Në rastin e avionëve ELA 1 ose ELA 2, një pjesë apo pajisje që është:
  1. Jo me jetë të kufizuar shërbimi, nuk është pjesë e strukturës primare, nuk është pjesë e kontrollit të fluturimit;
  2. Prodhuar në përputhje me projektin e zbatueshëm;
  3. E shënuar sipas nënpjesës Q;
  4. E identifikuar për instalim në një avion specifik;
  5. Për t'u instaluar në një avion për të cilin pronari ka vërtetuar përputhje me kushtet 1 deri në 4 dhe që ka pranuar përgjegjësinë për këtë përputhje.

(NËNPJESA L - NUK ËSHTË E ZBATUESHME)

NËNPJESA M - RIPARIMET

#### **21.A.431 Fushëveprimi**

- a) Kjo nënpjesë vendos procedurën për miratimin e riparimit të projektit, si dhe vendos të drejtat dhe detyrimet e aplikantëve për miratim dhe mbajtësve të këtyre miratimeve.
- b) Kjo nënpjesë përcakton riparimet standarde që nuk janë subjekt i një procesi miratimi sipas kësaj nënpjesë.
- c) Një “riparim” nënkupton eliminimin e dëmtimit dhe/ose rikthimin në një gjendje të vlefshmërisë ajrore pas lejimit fillestar në shërbim nga prodhuesi të ndonjë produkti, pjese ose pajisjeje.
- d) Eliminimi i dëmtimit nëpërmjet zëvendësimit të pjesëve ose pajisjeve pa nevojën e aktiviteteve të projektimit konsiderohet si një detyrë mirëmbajtjeje dhe si rrjedhojë nuk kërkon kështu asnjë miratim sipas këtij aneksi I.
- e) Një riparim ndaj një artikulli ETSO përveç njësive ndihmëse të energjisë (APU) trajtohet si një

ndryshim ndaj projektit ETSO dhe përpunohet në përputhje me pikën 21.A.611.

#### **21.A.431B Riparimet standarde**

- a) Riparimet standarde janë riparime:
1. Në lidhje me:
    - i) aeroplanët me peshë maksimale ngritjeje (MTOM) 5700 kg ose më pak;
    - ii) helikopterët me MTOM 3175 kg ose më pak;
    - iii) deltaplanët dhe deltaplanët me motorë, balonat dhe aerostatët siç përcaktohet në ELA 1 dhe ELA 2
  2. Që zbatojnë të dhënat e projektit të përfshira në specifikimet e certifikimit të lëshuara nga AAC dhe/ose Agjencia, që përmbajnë metoda, teknika dhe praktika të pranueshme për kryerjen dhe identifikimin e riparimeve standarde, duke përfshirë udhëzimet përkatëse për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore; dhe
  3. Që s'janë në konflikt me të dhënat e zotëruesve të certifikatës së tipit (TC).
- b) Pikat 21.A.432A deri në 21.A.451 nuk janë të zbatueshme për riparimet standarde.

#### **21.A.432A Pranueshmëria**

- a) Çdo person fizik ose juridik që ka demonstruar, ose është në proces demonstrimi të aftësisë së tij sipas pikës 21.A.432 B, është i pranueshëm si një aplikant për një miratim riparimi të madh të projektit sipas kushteve të parashtruara në këtë nënpjesë.
- b) Çdo person fizik ose juridik është i pranueshëm të aplikojë për miratimin e një riparimi të vogël të projektit.

#### **21.A.432B Demonstrimi i aftësisë**

- a) Një aplikant për një miratim të një riparimi të madh të projektit demonstron aftësinë e tij duke mbajtur një miratim të organizatës projektuese, të lëshuar nga AAC dhe/ose Agjencia në përputhje me nënpjesën J.
- b) Me përjashtim të paragrafit (a), aplikanti mund të kërkojë miratimin e AAC-së dhe/ose Agjencisë, për përdorimin e procedurave që përcaktojnë praktikat specifike të projektimit, burimet dhe rendin e aktiviteteve të nevojshme për t'u pajtuar me këtë nënpjesë, si një procedurë alternative për demonstrimin e aftësisë së tij.
- c) Me përjashtim të paragrafëve (a) dhe (b) aplikanti mund të kërkojë miratimin e AAC-së dhe/ose Agjencisë, për miratimin e një programi certifikimi duke përcaktuar praktikat specifike të projektimit, burimet dhe rendin e aktiviteteve të nevojshme për t'u pajtuar me këtë Aneks 1, për riparimin në një produkt të përcaktuar në pikën 21.A.14(c).

#### **21.A.433 Projekti i riparimit**

- a) Aplikanti për miratimin e një projekti të riparimit:
1. Demonstron pajtueshmërinë me bazën e certifikimit tip dhe kërkesat e mbrojtjes mjedisore të integruara me anë të citimeve në certifikatën e tipit ose certifikatën e tipit plotësuese ose autorizimit APU ETSO, në varësi se cila është e zbatueshme, ose me ato që janë në fuqi në datën e aplikimit (për miratimin e riparimit të projektit), dhe për më tej me çdo amendim të atyre specifikimeve certifikuese ose kushteve të veçanta që AAC dhe/ose Agjencia i shikon si të nevojshme për të vendosur një nivel sigurie operacional të njëjtë me atë të vendosur nga baza e certifikatës së tipit e integruar me anë të citimeve në certifikatën e tipit ose certifikatën e tipit plotësuese ose autorizimit APU ETSO.
  2. Paraqet të gjitha të dhënat e nevojshme vërtetuese, kur kërkohet nga AAC dhe/ose Agjencia.
  3. Deklaron pajtueshmërinë me specifikimet e certifikimit dhe kërkesat e mbrojtjes mjedisore të nënparagrafit (a)(1).
- b) Atëherë kur aplikanti nuk është mbajtësi i certifikatës së tipit ose certifikatës së tipit plotësuese ose autorizimit APU ETSO, në varësi se cila është e zbatueshme, aplikanti mund të pajtohet me kërkesat e paragrafit (a) nëpërmjet përdorimit të burimeve të tij ose nëpërmjet një marrëveshjeje me mbajtësin e certifikatës së tipit ose certifikatës së tipit plotësuese ose autorizimit APU ETSO, në varësi se cila është e zbatueshme.

#### **21.A.435 Klasifikimi i riparimeve**

- a) Një riparim mund të jetë “madhor” ose “i vogël”. Klasifikimi duhet të bëhet në përputhje me kriteret e pikës 21.A.91 për një ndryshim në certifikatën e tipit;
- b) Një riparim klasifikohet si “madhor” ose “i vogël” sipas paragrafit (a):
1. Nga AAC dhe/ose Agjencia, ose
  2. Nga një organizatë projektuese e miratuar në mënyrën e duhur dhe sipas një procedure të dakordësuar nga AAC dhe/ose Agjencia.

#### **21.A.437 Lëshimi i një miratimi të riparimit të projektit**

Kur është deklaruar dhe është treguar se projekti i riparimit përmbush specifikimet e zbatueshme të certifikimit dhe kërkesat e mbrojtjes mjedisore të pikës 21.A.433(a)(1), ai miratohet:

- a) nga AAC dhe/ose Agjencia ose
- b) nga një organizatë e miratuar sipas mënyrës së duhur e cila është gjithashtu mbajtësja e certifikatës së tipit ose certifikatës së tipit plotësuese ose mbajtësit të autorizimit APU ETSO, sipas një procedure të rënë dakord me AAC-në dhe/ose Agjencinë, ose
- c) vetëm për riparime të vogla, nga një organizatë projektuese e miratuar sipas mënyrës së duhur sipas një procedure të rënë dakord me AAC- në dhe/ose Agjencinë.

#### **21.A.439 Prodhimi i pjesëve riparuese**

Pjesët dhe pajisjet për t'u përdorur për riparimin prodhohen në përputhje me të dhënat prodhuese duke u bazuar mbi të gjitha të dhënat e nevojshme projektuese të vendosura në dispozicion nga mbajtësi i miratimit të riparimit të projektit:

- a) Sipas nënpjesës F; ose
- b) Nga një organizatë e miratuar në mënyrën e duhur në përputhje me nënpjesën G; ose
- c) Nga një organizatë mirëmbajtjeje e miratuar në mënyrën e duhur.

#### **21.A.441 Kryerja e riparimit**

- a) Kryerja e riparimit kryhet në përputhje me pjesën M ose pjesën 145 sipas nevojës, ose nga një organizatë prodhimi e miratuar në mënyrën e duhur në përputhje me nënpjesën G, sipas privilegjit të pikës 21.A.163(d).
- b) Organizata projektuese i transmeton organizatës që kryen riparimin të gjitha udhëzimet e nevojshme të instalimit.

#### **21.A.443 Kufizimet**

Një projekt i riparimit mund të miratohet duke qenë subjekt i kufizimeve, rast në të cilin miratimi i riparimit të projektit duhet të përfshijë të gjitha udhëzimet dhe kufizimet e nevojshme. Këto udhëzime dhe kufizime i transmetohen operatorit nga mbajtësi i miratimit të riparimit të projektit në përputhje me një procedurë të rënë dakord me AAC-në dhe/ose Agjencinë.

#### **21.A.445 Dëmtim i riparuar**

- a) Kur një produkt, pjesë ose pajisje e dëmtuar, është

lënë e riparuar dhe nuk mbulohet nga të dhëna të miratuara më parë, vlerësimi i dëmtimit për pasojat e tij mbi vlefshmërinë ajrore mund të bëhet vetëm:

1. Nga AAC dhe/ose Agjencia ose
2. Nga një organizatë projektuese e miratuar siç duhet, sipas një procedure të rënë dakord me AAC-në dhe/ose Agjencinë.

Çdo kufizim i nevojshëm përpunohet në përputhje me procedurat e pikës 21.A.443.

- b) Atëherë kur organizata që vlerëson dëmtimin sipas paragrafit (a) nuk është as AAC dhe/ose Agjencia, as mbajtësi i certifikatës së tipit ose certifikatës së tipit të kufizuar ose mbajtësit të autorizimit APU ETSO, kjo organizatë duhet të justifikojë se informacioni mbi të cilin është bazuar vlerësimi është i mjaftueshëm qoftë nga burimet e veta të organizatës ose nëpërmjet një marrëveshjeje me mbajtësin e certifikatës së tipit ose certifikatës së tipit plotësuese ose mbajtësit të autorizimit APU ETSO, ose prodhuesi, në varësi se cila nga këto është e zbatueshme.

#### **21.A.447 Mbajtja e të dhënave**

Për çdo riparim, i gjithë informacioni përkatës i projektimit, vizatimet, raportet e testeve, udhëzimet dhe kufizimet e lëshuara mundësisht në përputhje me pikën 21.A.443, justifikimi për klasifikimin dhe të dhënat e miratimit të projektit:

- a) mbahen nga mbajtësi i miratimit të riparimit të projektit në dispozicion të AAC-së dhe/ose Agjencisë; dhe
- b) ruhen nga mbajtësi i miratimit të riparimit të projektit në mënyrë që të japë informacionin e nevojshëm për të garantuar vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të produkteve, pjesëve ose pajisjeve të riparuar.

#### **21.A.449 Udhëzimet për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore**

- a) Mbajtësi i miratimit të riparimit të projektit i jep çdo operatori të mjetit fluturues që integron riparimin, të paktën një komplet të plotë të atyre ndryshimeve të udhëzimeve për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të cilat vijnë nga projekti i riparimit, duke përfshirë të dhëna përshkruese dhe udhëzimet përmbushëse të përgatitura në përputhje me kërkesat e zbatueshme. Produkti, pjesa ose pajisja e riparuar mund të lejohen në shërbim para se të jenë përfunduar ndryshimet e këtyre udhëzimeve, por kjo duhet të jetë për një periudhë shërbimi të kufizuar dhe në marrëveshje me AAC- në dhe/ose Agjencinë. Këto ndryshime të udhëzimeve i vihen në dispozicion, me kërkesë,

çdo personi tjetër të cilit i kërkohet të jetë në përputhshmëri me çdo njërin nga kushtet e këtyre ndryshimeve të udhëzimeve. Disponueshmëria e ndonjë manuali ose pjese të ndryshimeve të udhëzimeve për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore, që ka të bëjë me kontrollin e përgjithshëm ose me format e tjera të mirëmbajtjes bazë, mund të vonohet deri pasi produkti të ketë hyrë në shërbim, por duhet të jetë në dispozicion përpara se ndonjë nga produktet të arrijë vjetërsinë ose orët/ciklet e fluturimit përkatës.

b) Nëse përditësimet e këtyre ndryshimeve të udhëzimeve për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore janë lëshuar nga mbajtësi i miratimit të riparimit të projektit pasi riparimi të jetë miratuar fillimisht, këto përditësime i jepen çdo operatori dhe vendosen në dispozicion, pasi të jetë paraqitur një kërkesë, të çdo personi tjetër nga i cili kërkohet që të pajtohet me çdo njërin nga kushtet e këtyre ndryshimeve të udhëzimeve. AAC-së dhe/ose Agjencisë i paraqitet një program që tregon se si janë të shpërndara përditësimet e ndryshimeve të udhëzimeve të vlefshmërisë ajrore.

#### **21.A.451 Detyrimet dhe shënimi MEP**

a) Çdo mbajtës i një miratimi për një riparim të madh të projektit:

1. Ndërmerr detyrat:

i) e parashtruara te pikat 21.A.3A, 21.A.3B, 21.A.4, 21.A.439, 21.A.441, 21.A.443, 21.A.447 dhe pika 21.A.449;

ii) që nënkuptohen në bashkëpunimin midis mbajtësit të certifikatës së tipit ose certifikatës së tipit plotësuese ose mbajtësit të autorizimit APU ETSO, sipas pikës 21.A.433 (b), në varësi të përshtatshmërisë.

2. Specifikon shënjimin, duke përfshirë shkronjat MEP (“Miratimi Evropian i Pjesës”), në përputhje me pikën 21.A.804(a).

b) Përveç mbajtësve të certifikatës së tipit për të cilën zbatohet pika 21.A.44, mbajtësi i miratimit për riparim të vogël të projektit:

1. Ndërmerr detyrimet e parashtruara te pika 21.A.4, 21.A.447 dhe pika 21.A.449; dhe

2. Specifikon shënjimin, duke përfshirë shkronjat MEP, në përputhje me pikën 21.A.804(a).

(NËNPJESA N - NUK ËSHTË E ZBATUESHME)

NËNPJESA O - AUTORIZIMET E URDRIT

EVROPIAN TË STANDARDEVE TEKNIKE

21.A.601 Qëllimi

Kjo nënpjesë përcakton procedurën për dhënien e

autorizimeve mbi standardet evropiane teknike (ETSO) dhe rregullat që rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e aplikantëve ose zotëruesve të këtyre autorizimeve.

#### **21.A.602A Pranueshmëria**

Çdo person fizik ose juridik që prodhon ose përgatitet për të prodhuar një artikull ETSO dhe që ka demonstruar ose është në proces demonstrimi të aftësisë sipas pikës 21.A.602B duhet të pranohet si aplikant për një autorizim ETSO.

#### **21.A.602B Demonstrimi i aftësisë**

Çdo aplikant për një autorizim ETSO vërteton aftësinë e tij si më poshtë:

a) Aftësinë për të prodhuar, duke marrë një miratim si organizatë prodhuese, të lëshuar në përputhje me nënpjesën G, ose duke përmbytur procedurat e nënpjesës F; dhe

b) Aftësinë për projektim:

1. Për një Njësi Ndihmëse të Energjisë (APU), duke marrë një miratim si organizatë projektimi, të lëshuar nga AAC dhe/ose Agjencia në përputhje me nënpjesën J;

2. Për të gjithë artikujt e tjerë, duke përdorur procedura që përcaktojnë praktikatat e veçanta të projektimit, burimet dhe sekuencat e aktiviteteve të nevojshme, të cilat janë në përputhje me këtë aneks I.

#### **21.A.603 Aplikimi**

a) Aplikimi për një autorizim ETSO bëhet sipas formës dhe mënyrës së përcaktuar nga AAC dhe/ose Agjencia dhe duhet të përmbajë një përmbledhje të informacionit të kërkuar nga pika 21.A.605.

b) Kur parashikohet një seri ndryshimesh të vogla në përputhje me pikën 21.A.611, aplikanti përcakton në aplikimin e tij numrin bazë të modelit të artikullit dhe numrat e pjesëve përkatëse me kllapa të hapura pas saj për të treguar se shkronjat e ndryshimit të prapashtesës ose numrat (ose kombinimet e tyre) do të shtohen kohë pas kohe.



#### **21.A.604 Autorizimi ETSO për një njësi ndihmëse të energjisë (APU)**

Në lidhje me autorizimin ETSO për njësinë ndihmëse të energjisë (APU):

- a) Zbatohen pikat 21.A.15, 21.A.16B, 21.A.17A, 21.A.17B, 21.A.20, 21.A.21, 21.A.31, 21.A.33, 21.A.44 duke përfshirë pikat 21.A.603, 21.A.606(c), 21.A.610 dhe 21.A.615, përveç se një Autorizim ETSO do të lëshohet në përputhje me 21.A.606 në vend të certifikatës së tipit;
- b) Për miratimin e ndryshimeve të projektimit zbatohet nënpjesa D ose nënpjesa E duke përfshirë pikën 21.A.611. Kur përdoret nënpjesa E, lëshohet një autorizim ETSO në vend të certifikatës tip plotësuese.
- c) Për miratimin e riparimit të projektimit zbatohet nënpjesa M.

#### **21.A.605 Kërkesa për të dhëna**

Aplikanti paraqet pranë AAC-së dhe/ose Agjencisë dokumentet si më poshtë:

- a) Një deklaratë pajtueshmërie që certifikon se aplikanti ka përmbushur kërkesat e kësaj nënpjesë.
- b) Një deklaratë të projektimit dhe performancës (DDP).
- c) Një kopje të të dhënave teknike që kërkohen nga ETSO-ja e zbatueshme.
- d) Prezantimin (ose një referencë për prezantimin) të përmendur në pikën 21.A.143 për qëllim të marrjes së një miratimi të përshtatshëm të organizatës prodhuese sipas nënpjesës G ose manualit (apo një referencë në manual) sipas pikës 21.A.125A (b) për qëllimin e prodhimit sipas nënpjesës F pa miratimin e organizatës prodhuese.
- e) Për një APU, manualin (ose një referencë të manualit), të përmendur në pikën 21.A.243, për qëllim të marrjes së një miratimi të përshtatshëm të organizatës projektuese sipas nënpjesës J.
- f) Për artikujt e tjerë, zbatohen procedurat sipas pikës 21.A.602B(b)(2).

#### **21.A.606 Lëshimi i autorizimit ETSO**

Aplikanti ka të drejtë të ketë një autorizim ETSO të lëshuar nga AAC dhe/ose Agjencia pasi:

- a) të vërtetojë aftësinë e tij në përputhje me pikën 21.A.602B; dhe
- b) të vërtetojë se artikulli përmbush kushtet teknike të zbatueshme të ETSO-s dhe të dorëzojë deklaratën

përkatëse të pajtueshmërisë.

- c) të tregojë shprehimisht se ai është i përgatitur të përmbushë kriteret e pikës 21.A.609

#### **21.A.607 Privilegjet e autorizimit ETSO**

Zotëruesi i autorizimit ETSO ka të drejtën për të prodhuar dhe shënjuar artikullin me shenjën e duhur të ETSO-s.

#### **21.A.608 Deklarata e projektimit dhe performancës (DPP)**

- a) DPP-ja përmban së paku informacionin si më poshtë:

1. Informacionin e kërkuar sipas pikës 21.A.31(a) dhe (b), që përcakton artikullin dhe projektimin e tij, si dhe standardet e testimit.
2. Performancën e vlerësuar të këtij artikulli, kur është e përshtatshme, ose drejtpërdrejt duke iu referuar dokumenteve të tjera plotësuese;
3. Një deklaratë pajtueshmërie që certifikon se artikulli përmbush siç duhet ETSO-n e duhur;
4. Referencën për raportet përkatëse të testimit.
5. Referencën në manualin e mirëmbajtjes së duhur, kontrollit të përgjithshëm dhe riparimit.
6. Nivelet e pajtueshmërisë, ku nivelet të ndryshme pajtueshmërie lejohen nga ETSO.
7. Listën e devijimeve të pranuar në përputhje me pikën 21.A.610.

- b) DPP nënshkruhet me datën dhe firmën e mbajtësit të autorizimit ose të një përfaqësuesi të autorizuar prej tij.

#### **21.A.609 Detyrimet e mbajtësve të autorizimeve ETSO**

Mbajtësi i një autorizimi ETSO sipas kësaj nënpjesë:

- a) Prodhon çdo artikull në përputhje me nënpjesën G ose nënpjesën F, që siguron se çdo artikull i përfunduar përputhet me të dhënat e tij të projektimit dhe është i sigurt për t'u instaluar.
- b) Përgatit dhe mban, për çdo model të çdo artikulli për të cilin është lëshuar një autorizim ETSO, një dosje aktuale të të dhënave të plota teknike dhe dokumentacionin në përputhje me pikën 21.A.613;
- c) Përgatit, mban dhe përditëson kopjet origjinale të të gjitha manualeve të kërkuara nga specifikimet e vlefshmërisë ajrore të zbatueshme për artikullin;
- d) Vë në dispozicion të përdoruesve të këtij neni dhe AAC-së dhe/ose Agjencisë, sipas kërkesës, manualin e mirëmbajtjes dhe riparimit të nevojshme për përdorimin dhe mirëmbajtjen e artikullit dhe ndryshimet në ato manuale;
- e) Shënjon çdo artikull në përputhje me pikën 21.A.807; dhe

f) Përputhet me pikat 21.A.3(b), (c), 21. A.3B dhe pikën 21. A.4.

g) Vazhdon të përmbushë kërkesat e kualifikimit në përputhje me pikën 21.A.602B.

#### **21.A.610 Miratimi për devijimet**

a) Çdo prodhues që kërkon miratim për të devijuar nga ndonjë standard performance të një ETSO-je demonstroi se standardet për të cilat kërkohet devijimi kompensohen nga faktorë apo karakteristika të projektimit që sigurojnë një nivel të barabartë të sigurisë.

b) Kërkesa për miratimin e devijimit, së bashku me të gjitha të dhënat përkatëse, i paraqiten AAC- së dhe/ose Agjencisë.

#### **21.A.611 Ndryshimet e projektit**

a) Mbjtësi i autorizimit ETSO mund të bëjë ndryshime të vogla në projektim (çdo ndryshim përveç ndryshimeve të mëdha) pa autorizim të mëtejshëm nga AAC dhe/ose Agjencia. Në këtë rast, artikulli i ndryshuar mban numrin e modelit origjinal (ndryshimet e numrit të pjesës apo ndryshime të tjera përdoren për të identifikuar ndryshimet e vogla) dhe mbajtësi i dërgon AAC-së dhe/ose Agjencisë çdo të dhënë të rishikuar që nevojitet për përputhshmërinë me pikën 21.A.603(b).

b) Çdo ndryshim projekti nga mbajtësi i autorizimit ETSO, që është aq i madh sa të kërkojë një investigim të plotë për të përcaktuar përputhshmërinë me një ETSO, është një ndryshim i madh. Përpara se të bëjë një ndryshim të tillë, mbajtësi përcakton një tip ose model të ri projektimi dhe aplikon për një autorizim të ri sipas pikës 21.A.603.

c) Asnjë ndryshim i bërë nga çdo person fizik ose juridik përveç mbajtësit të autorizimit ETSO, i cili ka dorëzuar deklaratën e pajtueshmërisë për artikullin, nuk ka të drejtë për miratim sipas kësaj nën-pjesë O, vetëm nëse personi që kërkon miratimin aplikon sipas pikës 21.A.603 për një autorizim ETSO të veçantë.

#### **21.A.613 Ruajtja e të dhënave**

Përveç kërkesave të ruajtjes së të dhënave të duhura ose të dhënave që lidhen me sistemin e cilësisë, të gjitha të dhënat përkatëse mbi projektin, vizatimet dhe raportet e testimit, duke përfshirë shënimet e inspektimit për artikullin e testuar, vihen në dispozicion të AAC-së dhe/ose Agjencisë dhe ruhen në mënyrë që të sigurojnë informacionin e nevojshëm për të garantuar vlefshmërinë ajrore të artikullit dhe produktit me certifikatë tipi, në të

cilin është vendosur.

#### **21.A.615 Inspektimi nga AAC**

Sipas kërkesës së AAC-së dhe/ose Agjencisë, çdo aplikant apo mbajtës i një autorizimi ETSO për një artikull lejon AAC-në dhe/ose Agjencinë:

a) të asistojë në çdo testim.

b) të inspektojë dosjet me të dhënat teknike të atij artikulli.

#### **21.A.619 Kohëzgjatja dhe vazhdueshmëria e vlefshmërisë**

a) Një autorizim ETSO lëshohet për një kohëzgjatje të pakufizuar. Ai mbetet i vlefshëm përveç rasteve kur:

1. Kushtet e kërkuara kur u lëshua autorizimi ETSO nuk vazhdojnë të përmbushen më; ose

2. Detyrimet e mbajtësit, të specifikuara në pikën 21.A.609, nuk plotësohen më; ose

3. Artikulli ka provuar të shkaktojë rreziqe të papranueshme në shërbim; ose

4. Autorizimi është dorëzuar apo revokuar sipas procedurave administrative të zbatueshme, të vendosura nga AAC dhe/ose Agjencia.

b) Mbas dorëzimit apo revokimit, certifikata i kthehet AAC-së.

#### **21.A.621 Transferueshmëria**

Përveç një ndryshimi në pronësinë e mbajtësit, i cili konsiderohet si një ndryshim me rëndësi, dhe prandaj duhet të përputhet me pikat 21.A.147 dhe 21.A.247 sipas rastit të zbatueshmërisë, një autorizim ETSO i lëshuar sipas këtij aneksi I nuk është i transferueshëm.

#### **NËNPJESA P -LEJA PËR FLUTURIM**

#### **21.A.701 Fushëveprimi**

a) Lejet për fluturim lëshohen në përputhje me këtë nën-pjesë për avionët që nuk përmbushin ose nuk kanë demonstruar të përmbushin kërkesat e zbatueshme të vlefshmërisë ajrore, por që janë në gjendje të fluturimit të sigurt nën kushte të përcaktuara dhe për qëllimet e mëposhtme:

1. Zhvillimi;

2. Demonstrimi të përputhshmërisë me rregulloret ose specifikimet e certifikimit;

3. Trajnimi të ekuipazhit të organizatave të projektimit ose prodhimit;

4. Testimi të prodhimit në fluturim për avionët e prodhimit të ri;

5. Fluturimi të avionit ende në prodhim, nga një facilitet prodhues te tjetri;

6. Fluturimi të avionit për praninë nga klienti porosites;
  7. Dërgimi në destinacion ose eksportimi të avionit;
  8. Fluturimi të avionit për praninë nga Autoriteti;
  9. Studimi të tregut përfshirë trajnimin e ekuipazhit të klientit porosites;
  10. Ekspozimi dhe shfaqjeje ajrore;
  11. Fluturimi të avionit deri në vendin ku do të kryhet mirëmbajtja ose rishikimi i vlefshmërisë ajrore, ose në një vend magazinimi;
  12. Fluturimi të një avioni me një peshë që tejkalon peshën maksimale të certifikuar të ngritjes për fluturim përtej diapazonit normal mbi ujë, ose mbi zonat tokësore ku nuk janë në dispozicion pajisjet e duhura të uljes ose nuk është e vlefshme lënda djegëse;
  13. Thyerje rekordi, gara ajrore ose konkurrencë e ngjashme;
  14. Fluturimi të avionit që plotëson kërkesat e zbatueshme të fluturimit, përpara se të jetë konform me kërkesat mjedisore;
  15. Për aktivitetin fluturues jo-komercial me avionë individuale jo-komplekse ose tipa për të cilët nuk kërkohet një certifikatë e vlefshmërisë ajrore ose e kufizuar e vlefshmërisë ajrore.
- b) Kjo nënpjesë vendos procedurën për lëshimin e lejeve për fluturim dhe miratimin e kushteve shoqëruese për fluturim dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e aplikantëve dhe mbajtësve të këtyre lejeve dhe miratimeve të kushteve për fluturim.

#### **21.A.703 Pranueshmëria**

- a) Çdo person fizik ose juridik pranohet si aplikues për leje për fluturim përveç lejes për fluturim kërkuar për qëllimin e pikës 21.A.701 (a) (15) ku aplikuesi duhet të jetë vetë pronari.
- b) Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën të aplikojë për miratimin e kushteve për fluturim.

#### **21.A.705 Autoriteti kompetent**

Pavarësisht pikës 21.1 të këtij aneksi I për qëllime të kësaj nënpjese, "autoriteti kompetent" është:

- a) AAC, si autoriteti i përcaktuar nga shteti i regjistrit, kur shteti i regjistrit është Republika e Shqipërisë, ose sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, autoriteti i përcaktuar nga shteti anëtar i regjistrit të avionit;
- b) Për avionë të paregjistruar, autoriteti i njohur nga

shteti që ka përcaktuar shenjat e identifikimit.

#### **21.A.707 Aplikimi për leje për fluturim**

- a) Në zbatim të pikës 21.A.703 dhe kur aplikantit nuk i është dhënë privilegji që të lëshojë një leje për fluturim, tek autoriteti kompetent bëhet një kërkesë për një leje për fluturim në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga ky autoritet.
- b) Çdo kërkesë për një leje për fluturim përfshin:
  1. Qëllimin (et) i/e fluturimit (eve), në përputhje me pikën 21.A.701;
  2. Mënyrat në të cilat avioni nuk është në përputhje me kërkesat e vlefshmërisë ajrore të zbatueshme;
  3. Kushtet e fluturimit të miratuara në përputhje me pikën 21.A.710.
- c) Kur kushtet e fluturimit nuk janë miratuar në kohën e aplikimit për një leje për të fluturuar, një kërkesë për miratimin e kushteve për fluturim bëhet në përputhje me pikën 21.A.709.

#### **21.A.708 Kushtet e fluturimit**

Kushtet e fluturimit përfshijnë:

- a) Konfigurimin(et) për të cilën(at) kërkohet leja për fluturim;
- b) Çfarëdolloj kushti ose kufizimi të nevojshëm për operimin e sigurt të avionit, duke përfshirë:
  1. Kushtet ose kufizimet të vendosur në itineraret ose hapësirën ajrore, ose të dyja, të nevojshme për fluturim(et);
  2. Çdo kusht ose kufizim të vendosur në ekuipazhin e fluturimit për të fluturuar avionin, përveç atyre të përcaktuar në shtojcën XII të këtij aneksi I (pjesa 21);
  3. Kufizimet në lidhje me transportin e personave të tjerë përveç ekuipazhit të fluturimit;
  4. Kufizimet e operimit, procedurat specifike ose kushtet teknike që duhet të përmbushen;
  5. Programin specifik të testimit në fluturim (nëse është i aplikueshëm);
  6. Udhëzimet specifike të vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore, duke përfshirë udhëzimet e mirëmbajtjes dhe regjimin nën të cilin ato do të kryhen;
- c) Provën se avioni është i aftë për fluturim të sigurt sipas kushteve ose kufizimeve të pikës (b);
- d) Metodën e përdorur për kontrollin e konfigurimit të avionit, në mënyrë që të mbetet brenda kushteve të vendosura.

### **21.A.709 Aplikimi për miratimin e kushteve të fluturimit**

a) Në zbatim të pikës 21.A.707 (c) dhe kur aplikantit nuk i është dhënë privilegji që të miratojë kushtet e fluturimit, bëhet një kërkesë për miratimin e kushteve të fluturimit:

1. Tek AAC dhe/ose Agjencia, kur miratimi i kushteve të fluturimit është i lidhur me sigurinë e projektimit, në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga AAC dhe/ose Agjencia; ose

2. Tek autoriteti kompetent, kur miratimi i kushteve të fluturimit nuk është i lidhur me sigurinë e projektimit, në formën dhe mënyrën e caktuar nga ky autoritet.

b) Çdo kërkesë për miratimin e kushteve të fluturimit përfshin:

1. Kushtet e propozuara të fluturimit;

2. Dokumentacionin në mbështetje të këtyre kushteve; dhe

3. Një deklaratë që avioni është i aftë për fluturim të sigurt, sipas kushteve ose kufizimeve të pikës 21.A.708 (b).

### **21.A.710 Miratimi i kushteve të fluturimit**

a) Kur miratimi i kushteve të fluturimit është i lidhur me sigurinë e projektimit, kushtet e fluturimit miratohen nga:

1. Agjencia kur Republika e Shqipërisë të jetë anëtare e saj dhe/ose AAC; ose

2. Një organizatë projektimi e miratuar siç duhet sipas privilegjit të pikës 21.A.263(c)(6).

b) Kur miratimi i kushteve të fluturimit nuk është i lidhur me sigurinë e projektimit, kushtet e fluturimit miratohen nga autoriteti kompetent, ose nga organizata e miratuar, që do të lëshojë gjithashtu lejen për fluturim.

c) Para miratimit të kushteve të fluturimit, Agjencia dhe/ose AAC apo organizata e miratuar, duhet të jenë të bindur që avioni është i aftë për fluturim të sigurt nën kushtet dhe kufizimet e specifikuar. Agjencia ose AAC mund të bëjnë ose t'i kërkojnë aplikantit për të bërë inspektimet ose testimet e nevojshme për këtë qëllim.

### **21.A.711 Lëshimi i lejes për të fluturuar**

a) Një leje për fluturim (formulari 20a, i Republikës së Shqipërisë, sipas modelit të EASA-s, shih shtojcën III) mund të lëshohet nga autoriteti kompetent sipas kushteve të specifikuar në pikën 21.B.525.

b) Një organizatë projektimi e miratuar siç duhet

mund të lëshojë një leje për fluturim (formulari 20b, i Republikës së Shqipërisë, sipas modelit të EASA-s, shih shtojcën IV) në bazë të privilegjit të dhënë sipas pikës 21.A.263 (c) (7), kur kushtet e fluturimit referuar në pikën 21.A.708 janë miratuar në përputhje me pikën 21.A.710.

c) Një organizatë prodhimi e miratuar siç duhet mund të lëshojë një leje për fluturim (Formulari 20b, i Republikës së Shqipërisë sipas modelit të EASA-s, shih shtojcën IV) në bazë të privilegjit të dhënë sipas pikës 21.A.163 (e), kur kushtet e fluturimit të referuara në pikën 21.A.708 janë miratuar në përputhje me pikën 21.A.710.

d) Një organizatë e menaxhimit të vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore e miratuar siç duhet, mund të lëshojë një leje për fluturim (forma 20b e Republikës së Shqipërisë sipas EASA- s, shih shtojcën IV) në bazë të privilegjit të dhënë sipas pikës M.A.711 të aneksit I (pjesa M) të urdhrit të ministrit nr. 110 datë 2.10.2012, mbi “Vlefshmërinë ajrore të produkteve, pajisjeve aeronautike dhe pjesëve të avionëve, si dhe për miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra” kur kushtet për fluturim referuar në pikën 21.A.708 janë miratuar në përputhje me pikën 21.A.710.

e) Leja për fluturim specifikon qëllimin (et) dhe të gjitha kushtet dhe kufizimet të cilat janë miratuar në përputhje me pikën 21.A.710.

f) Për lejet e lëshuara sipas pikave (b), (c) ose (d), një kopje e lejes për fluturim dhe e kushteve shoqëruese të fluturimit, i dorëzohet autoriteti kompetent në rastin më të parë, por jo më vonë se 3 ditë.

g) Me marrjen e dëshmisë se ndonjë nga kushtet e përcaktuara në pikën 21.A.723 (a) nuk është plotësuar për një leje për fluturim që një organizatë ka lëshuar në përputhje me pikat (b), (c) ose (d), ajo organizatë revokon menjëherë atë leje për fluturim dhe informon pa vonesë autoritetin kompetent.

### **21.A.713 Ndryshimet**

a) Çdo ndryshim që zhvlerëson kushtet e fluturimit ose provën lidhur me to për lejen për fluturim, miratohet në përputhje me pikën 21.A.710. Kur është rasti, bëhet një aplikim në përputhje me pikën 21.A.709.

b) Një ndryshim që ndikon në përmbajtjen e lejes për të fluturuar kërkon lëshimin e lejes së re për të fluturuar në përputhje me pikën 21.A.711.

### **21.A.715 Gjuha**

Manualet, pllakatet, listimet, shënimet e instrumenteve dhe informacionet e tjera të nevojshme të kërkuara nga specifikimet e zbatueshme të certifikimit paraqiten në një ose më shumë nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian të pranueshme nga AAC dhe në gjuhën shqipe. Manualet, apo dokumente të dala nga prodhuesi apo projektuesi pranohen edhe në gjuhën angleze.

### **21.A.719 Transferueshmëria**

- a) Leja për fluturim nuk transferohet.
- b) Pavarësisht pikës (a) për një leje për fluturim lëshuar për qëllim të pikës 21.A.701 (a),(15), nëse pronësia e avionit ka ndryshuar, leja për fluturim transferohet bashkë me avionin, me kusht që avioni të mbetet në të njëjtin regjistër, ose lëshohet vetëm me pëlqimin e Autoritetit Kompetent të shtetit në regjistrin e të cilit ai është transferuar.

### **21.A.721 Inspektimet**

Mbajtësi ose aplikanti për një leje për fluturim i siguron autoritetit kompetent hyrje tek avioni në fjalë, me kërkesë të tij.

### **21.A.723 Kohëzgjatja dhe vazhdueshmëria e vlefshmërisë**

- a) Një leje për të fluturuar, lëshohet për një maksimum prej 12-muajsh dhe mbetet e vlefshme deri kur:
  1. Të jetë në përputhshmëri me kushtet dhe kufizimet e pikës 21.A.711 (d) lidhur me lejen për fluturim;
  2. Leja për fluturim të mos jetë dorëzuar ose revokuar;
  3. Avioni të ketë mbetur në të njëjtin regjistër.
- b) Pavarësisht pikës (a), një leje për fluturim lëshuar për qëllim të pikës 21.A.701(a)(15) mund të lëshohet për kohëzgjatje të pacaktuar.
- c) Me dorëzimin apo revokimin, leja për fluturim i kthehet autoritetit kompetent.

### **21.A.725 Rinovimi i lejes për fluturim**

Rinovimi i lejes për fluturim bëhet si një ndryshim në përputhje me pikën 21.A.713.

### **21.A.727 Detyrimet e mbajtësit të një lejeje për fluturim**

Mbajtësi i lejes për fluturim siguron se janë plotësuar dhe mbajtur të gjitha kushtet dhe kufizimet që lidhen me një

leje për fluturim.

### **21.A.729 Ruajtja e të dhënave**

- a) Të gjitha dokumentet e prodhuara për të përcaktuar dhe justifikuar kushtet për fluturim mbahen nga mbajtësi i miratimit të kushteve të fluturimit në dispozicion të Agjencisë dhe AAC-së dhe duhet të ruhen në mënyrë që të japin informacionin e nevojshëm për të siguruar vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit.
- b) Të gjitha dokumentet që lidhen me lëshimin e lejeve të fluturimit nën privilegjin e organizatave të miratuara, duke përfshirë të dhënat e inspektimit, dokumentet mbështetëse të miratimit të kushteve të fluturimit dhe vetë lejes për fluturim, mbahen nga organizatat përkatëse të miratuara në dispozicion të Agjencisë ose AAC-së dhe ruhen në mënyrë që të japin informacionin e nevojshëm për të siguruar vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit.

NËNPJESA Q - IDENTIFIKIMI I PRODUKTEVE, PJESËVE DHE PAJISJEVE

### **21.A.801 Identifikimi i produkteve**

- a) Identifikimi i produkteve përmban informacionin si në vijim:
  1. Emrin e prodhuesit;
  2. Përcaktimin e produktit;
  3. Numrin e serisë së prodhuesit;
  4. Çdo informacion tjetër që mund t'i nevojitet Agjencisë dhe/ ose AAC-së.
- b) Çdo person fizik apo juridik që prodhon një avion ose motor sipas nënpjesës G ose nënpjesës F, identifikon atë avion ose motor me anë të një pllake rezistente ndaj zjarrit, e cila përmban informacionin e kërkuar në paragrafin (a) të shënuar në të me gërvishtje, stampim, gdhendje, ose me një metodë tjetër të miratuar shënimi zjarrdurrues. Pllaka identifikuese sigurohet në mënyrë që të jetë e arritshme dhe e lexueshme dhe nuk duhet të dëmtohet apo zhvendoset gjatë shërbimit normal, apo të humbasë ose të shkatërrohet në rast aksidenti.
- c) Çdo person fizik apo juridik që prodhon helikë, teh helike, ose bosht helike sipas nënpjesës G ose nënpjesës F, e identifikon atë, me anë të një pllake, nëpërmjet gërvishtjes, stampimit, gdhendjes, ose përmes një metode tjetër të miratuar shënimi, zjarrdurrues që është vendosur në një sipërfaqe jo kritike dhe përmban informacionin e specifikuar në paragrafin (a), dhe nuk ka të ngjarë që të dëmtohet apo të hiqet gjatë shërbimit normal apo të humbasë ose të shkatërrohet në rast aksidenti.
- d) Për balonat e pilotuara me drejtim të lirë, pllaka identifikuese e përcaktuar në paragrafin (b) sigurohet në mbështjellën e balonës dhe vendoset, nëse është praktike, atje ku është e lexueshme për

operatorin, gjatë kohës kur balona është fryrë. Për më tepër koshi i balonës, struktura e mbajtjes së ngarkesës dhe çdo pajisje ngrohëse duhet të jetë e shënuar në mënyrë të qëndrueshme, si dhe duhet të jetë e lexueshme me emrin e prodhuesit, numrin e pjesës, ose ekuivalentin dhe numrin e serisë ose ekuivalentin e tij.

#### **21.A.803 Trajtimi i të dhënave të identifikimit**

a) Asnjë person nuk heq, ndryshon ose vendos informacionin identifikues të referuar në pikën 21.A.801(a) në asnjë avion, motor, helikë, teh helike ose nyje helike ose në pikën 21.A.807(a) për një APU, pa miratimin e Agjencisë dhe/ ose AAC-së.

b) Asnjë person nuk heq ose instalon asnjë pllakë identifikuese të përcaktuar në pikën 21.A.801, ose në pikën 21.A.807 për një APU, pa miratimin e Agjencisë dhe/ ose AAC-së.

c) Duke përjashtuar paragrafët (a) dhe (b), çdo person fizik apo juridik që kryen punë mirëmbajtëse sipas rregullave përkatëse të zbatueshme, në përputhje me metodat, teknikat dhe praktikatat e përcaktuara nga Agjencia dhe/ose AAC:

1. Heq, ndryshon ose vendos informacionin identifikues referuar në pikën 21.A.801(a) në çdo avion, motor, helikë, teh helike ose nyje helike ose në pikën 21.A.807(a) për një APU; ose

2. Heq një pllakë identifikuese të përcaktuar sipas pikës 21.A.801, ose pikës 21.A.807 për një APU, kur është e nevojshme gjatë shërbimeve të mirëmbajtjes.

d) Asnjë person nuk instalon një pllakë identifikuese të hequr në përputhje me nënparagrafin (c)(2), në një avion, motor, helikë, teh helike ose nyje helike, përveç asaj që është hequr.

#### **21.A.804 Identifikimi i pjesëve dhe pajisjeve**

a) Çdo pjesë ose pajisje duhet të shënohet në mënyrë të lexueshme dhe të qëndrueshme me:

1. Një emër, markë tregtare, ose simbol që identifikon prodhuesin në mënyrën e identifikuar nga të dhënat e zbatueshme të projektit; dhe

2. Numrin e pjesës, siç është përcaktuar në të dhënat e zbatueshme të projektit; dhe

3. Shkronjat MEP (Miratimi Evropian i Pjesës) për pjesët ose pajisjet e prodhuara në përputhje me të dhënat e miratuara të projektit që nuk i përkasin mbajtësit të certifikatës së tipit për produktin në fjalë, përveç artikujve ETSO.

b) Duke përjashtuar paragrafin (a), nëse AAC/

Autoriteti Kompetent pranon që një pjesë apo pajisje është shumë e vogël ose nëse në të kundërt është jo praktike për t'u shënuar me ndonjë prej informacioneve të kërkuara në paragrafin (a), dokumenti i autorizuar i lejimit në shërbim që shoqëron pjesën, pajisjen ose kontejnerin e saj duhet të përmbajë informacionin që nuk mund të shënohej në atë pjesë.

#### **21.A.805 Identifikimi i pjesëve kritike**

Përveç kërkesave të pikës 21.A.804, çdo prodhues i një pjese që do të vendoset në një produkt me certifikim të tipit, që është identifikuar si një pjesë kritike duhet ta shënojë atë pjesë në mënyrë të lexueshme dhe të përhershme me një numër pjese dhe një numër serie.

#### **21.A.807 Identifikimi i artikujve ETSO**

a) Çdo mbajtës i një autorizimi ETSO sipas nënpjesës O shënon në mënyrë të përhershme dhe të lexueshme çdo artikull me informacionin e mëposhtëm:

1. Emrin dhe adresën e prodhuesit;

2. Emrin, tipin, numrin e pjesës ose përcaktimin e modelit për artikullin;

3. Numrin e serisë ose datën e prodhimit, ose të dyja, dhe

4. Numrin ETSO të zbatueshëm.

b) Duke përjashtuar paragrafin (a), nëse Agjencia dhe/ose AAC bie dakord se një pjese është shumë e vogël ose ndryshe nuk është praktike për t'u shënuar me çdo informacion të kërkuar në paragrafin (a), dokumenti i autorizuar i lejimit në shërbim që shoqëron pjesën ose kontejnerin e saj duhet të përmbajë informacionin që nuk mund të shënohej në atë pjesë.

c) Çdo person që prodhon një APU sipas nënpjesës G ose nënpjesës F identifikon atë APU me një pllakë rezistente ndaj zjarrit, që ka të gjithë informacionin e kërkuar në paragrafin (a) të shënuar me gërvishtje, stampim, gdhendje ose ndonjë metodë tjetër shënimi zjarrdurus. Pllaka identifikuese sigurohet në mënyrë të tillë që të jetë e qëndrueshme dhe mos të dëmtohet apo zhvendoset gjatë shërbimit normal ose të humbasë apo të shkatërrohet në rast aksidenti.

## SEKSIONI B - PROCEDURAT PËR AUTORITETET KOMPETENTE

### NËNPJESA A - PARIME TË PËRGJITH- SHME

#### 21.B.5 Fushëveprimi

a) Ky seksion përcakton procedurën për Autoritetin Kompetent, kur ushtron detyrat dhe përgjegjësitë e tij që kanë të bëjnë me lëshimin, mirëmbajtjen, amendimin, pezullimin dhe revokimin e certifikatave, miratimeve dhe autorizimeve të referuara në këtë aneks I.

b) AAC adopton specifikimet e certifikimit dhe materialet udhëzuese të hartuara nga Agjencia në zbatimin e këtij seksioni.

#### 21.B.20 Detyrimet e autoritetit kompetent

AAC/ Autoriteti Kompetent është përgjegjës për zbatimin e seksionit A, nënpjesëve F, G, H, I dhe P vetëm për aplikantët ose mbajtësit e autorizimeve, kur vendi kryesor i biznesit të tyre është në territorin e Shqipërisë.

#### 21.B.25 Kërkesat për organizimin e AAC-së

a) Të përgjithshme:

për zbatimin e seksionit A nënpjesëve F, G, H, I dhe P, AAC ka përcaktuar përgjegjësitë, procedurat e dokumentuara, strukturën organizative dhe stafin përkatës.

b) Burimet:

1. Numri i stafit duhet të jetë i mjaftueshëm për të kryer detyrat e përcaktuara.

2. AAC duhet të emërojë një menaxher ose disa menaxherë të cilët janë përgjegjës për zbatimin e detyrave të përcaktuara në kuadër të autoritetit, duke përfshirë komunikimin me Agjencinë dhe autoritetet kombëtare, kur është e përshtatshme.

c) Kualifikimi dhe trajnimi:

I gjithë stafi duhet të kualifikohet në mënyrë të përshtatshme dhe duhet të ketë njohuri të mjaftueshme, eksperiencë dhe trajnim për të kryer detyrat e përcaktuara.

#### 21.B.30 Procedurat e dokumentuara

a) AAC përcakton procedurat e dokumentuara, për të përshkruar organizimin e tij, mjetet dhe metodat për të përmbushur kërkesat e këtij aneksi

I. Procedurat mbahen të përditësuara dhe shërbejnë si dokumente kryesore pune për AAC-në për të gjitha aktivitetet e ndërlidhura.

b) Një kopje e procedurave dhe amendimet e tyre duhet të jenë të disponueshme për Agjencinë.

#### 21.B.35 Ndryshime në organizim dhe procedura

a) AAC njofton Agjencinë për çdo ndryshim të rëndësishëm në organizim dhe procedurat e dokumentuara.

b) AAC përditëson procedurat e tij të dokumentuara që lidhen me çdo ndryshim të rregulloreve, në kohën e duhur, për të garantuar zbatimin efektiv të tyre.

#### 21.B.40 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

a) AAC përcakton një proces për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve brenda procedurave të dokumentuara të organizatës së saj.

b) Nëse ekziston konflikt midis AAC-së dhe autoritetit kompetent të një Shteti të ZPEA-së sipas përcaktimit të marrëveshjes shumëpalëshe, është përgjegjësia e menaxherëve siç përcaktohet në pikën 21.B.25(b)(2) për të ngritur çështjen për ndërmjetësim në Agjenci.

#### 21.B.45 Raportimi/koordinimi

a) AAC siguron koordinim kur është e nevojshme në lidhje me certifikatat, investigimet apo ekipet e autorizimit të këtij autoriteti, me shtetin e ZPEA-së sipas përcaktimit të marrëveshjes shumëpalëshe dhe Agjencinë, për të garantuar shkëmbim efikas të informacionit përkatës, për sigurinë e produkteve, pjesëve dhe pajisjeve;

b) AAC njofton Agjencinë për çdo vështirësi në zbatimin e këtij aneksi I (pjesa 21)

#### 21.B.55 Ruajtja e të dhënave

AAC do të mbajë ose ka qasje në të dhënat përkatëse në lidhje me certifikatat, miratimet dhe autorizimet që ajo ka dhënë në përputhje me rregulloret përkatëse kombëtare dhe për të cilat përgjegjësia mund t'i transferohet Agjencisë, për sa kohë që këto të dhëna nuk janë transferuar në Agjenci.

#### 21.B.60 Direktivat e vlefshmërisë ajrore

Kur AAC merr një direktivë të vlefshmërisë ajrore nga një vend që nuk është i Bashkimit Evropian ose i Zonës së Përbashkët Evropiane sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, kjo direktivë e vlefshmërisë ajrore i transferohet Agjencisë për shpërndarje.

### NËNPJESA B - CERTIFIKATAT E TIPIT DHE CERTIFIKATAT E KUFIZUARA TË TIPIT

Duhet të zbatohen procedurat administrative të vendosura nga Agjencia. AAC duhet të marrë masa për të bërë të zbatueshme procedurat në sistemin kombëtar të aviacionit.

(NËNPJESA C - NUK ËSHTË E ZBATUESHME)  
NËNPJESA D - NDRYSHIME TË  
CERTIFIKATAVE TIP DHE CERTIFIKATAVE TË  
KUFIZUARA TË TIPIT

#### **21.B.70 Miratimi i ndryshimeve në certifikatat e tipit**

Miratimi i ndryshimeve në të dhënat e përshtatshmërisë operationale përfshihet në miratimin e ndryshimit në certifikatën e tipit. Megjithatë, AAC dhe/ose Agjencia përdor një proces të veçantë të klasifikimit dhe të miratimit për administrimin e ndryshimeve në të dhënat e përshtatshmërisë operationale.

#### **NËNPJESA E -CERTIFIKATA TIP PLOTËSUESE**

Duhet të zbatohen procedurat administrative të vendosura nga Agjencia. AAC duhet të marrë masa për të bërë të zbatueshme procedurat në sistemin kombëtar të aviacionit.

**NËNPJESA F - PRODHIMI PA MIRATIMIN E ORGANIZATËS PRODHUESE**

#### **21.B.120 Investigimi**

a) AAC përcakton një ekip investigimi për çdo aplikant ose zotërues të një letër marrëveshjeje, për të kryer të gjitha detyrat përkatëse që lidhen me këtë letër marrëveshje, të përbërë nga lideri i ekipit që drejton dhe udhëheq ekipin e investigimit dhe nëse është e nevojshme, një ose më shumë anëtarë ekipi. Lideri i ekipit i raporton menaxherit përgjegjës për aktivitetin, siç është përcaktuar në pikën 21.B.25 (b)(2).

b) AAC kryen aktivitetet e mjaftueshme investiguese për aplikantin ose zotëruesin e një letre marrëveshjeje, në mënyrë që të justifikohen rekomandimet për lëshimin, mbajtjen, ndryshimin, pezullimin dhe revokimin e letër marrëveshjes.

c) AAC përgatit procedura për investigimin e aplikantëve ose zotëruesve, të një letër marrëveshjeje, si pjesë e procedurave të dokumentuara duke përfshirë të paktën elementet si në vijim:

1. Vlerësimin e aplikimeve të marra;
2. Përcaktimin e ekipit të investigimit;
3. Përgatitjen dhe planifikimin e investigimit;
4. Vlerësimin e dokumentacionit (manuale, procedura, etj.);
5. Auditimin dhe inspektimin;
6. Ndjekjen e veprimeve korrigjuese; dhe
7. Rekomandimin për lëshimin, amendimin,

pezullimin ose heqjen e letër marrëveshjes.

#### **21.B.125 Gjetjet**

a) Kur gjatë auditeve ose nëpërmjet mënyrave të tjera, janë gjetur prova nga AAC, që tregojnë mos-pajtueshmërinë e mbajtësit të një letër marrëveshjeje me kërkesat e zbatueshme të Seksionit A të këtij aneksi, këto gjetje klasifikohen në përputhje me pikën 21.A.125B (a).

b) AAC ndërmerr veprimet e mëposhtme:

1. Për gjetjet e nivelit 1, nga AAC ndërmerret një veprim i menjëhershëm, për të kufizuar, pezulluar ose revokuar letër marrëveshjen tërësisht ose pjesërisht, në varësi me shkallën e gjetjes, derisa të bëhet veprimi korrigjues i suksesshëm nga organizata;

2. Për gjetjet e nivelit 2, AAC lejon një periudhë për veprimet korrigjuese të përshtatshme për natyrën e gjetjes e cila nuk duhet të jetë më shumë se 3 muaj. Në rrethana të caktuara, në fund të kësaj periudhe dhe në funksion të natyrës së gjetjes, AAC mund të zgjasë periudhën 3 mujore me kusht të një plani të veprimit korrigjues të kënaqshëm të ofruar nga organizata.

c) AAC ndërmerr veprime që të pezullojë letrën e marrëveshjes në tërësi ose pjesërisht, në rast të dështimit të mos përmbushjes së afatit kohor të dhënë nga ky organ.

#### **21.B.130 Lëshimi i letër marrëveshjes**

a) Kur është i bindur se prodhuesi ka përmbushur kërkesat e zbatueshme të seksionit A të nënpjesës F, AAC harton një letër marrëveshjeje për të treguar pajtueshmërinë e produkteve të veçanta, pjesëve ose pajisjeve, pa vonesë (forma 65 e Republikës së Shqipërisë sipas modelit të EASA-s).

b) Letër marrëveshja përmban fushëveprimin e marrëveshjes, një datë përfundimi, dhe nëse është e zbatueshme, kufizimet e nevojshme që lidhen me autorizimin.

c) Kohëzgjatja e letër marrëveshjes nuk duhet të tejkalojë një vit.

#### **21.B.135 Ruajtja e letër marrëveshjes**

AAC ruan letër marrëveshjen për aq kohë sa:

a) Prodhuesi përdor në mënyrën e duhur formën 52 të Republikës së Shqipërisë sipas EASA-s (shih shtojcën VIII) si një deklaratë pajtueshmërie për avionin e kompletuar dhe formën 1 të Republikës së Shqipërisë sipas modelit



të EASA-s (shih shtojcën) për produktet e tjera përveç avionëve, si pjesë dhe pajisje, dhe

b) Inspektimet e bëra nga AAC përpara miratimit të formës 52, sipas EASA-s ose formularit 1, sipas EASA-s, sipas pikës 21.A.130(c) nuk tregojnë ndonjë mos pajtueshmëri me kërkesat dhe procedurat që përmban manuali i siguruar nga prodhuesi, ose mungesë pajtueshmërie të produkteve, pjesëve dhe pajisjeve përkatëse. Këto inspektime duhet së paku të kontrollojnë se:

1. Marrëveshja mbulon produktin, pjesën ose pajisjen që po miratohet dhe mbetet e vlefshme.
  2. Manuali i përshkruar në pikën 21.A.125(b) dhe ndryshimet në statusin e tij të referuar në letër marrëveshje, përdoren si një dokument kryesor pune nga prodhuesi; në të kundërt, inspektimi nuk duhet të vazhdojë dhe për rrjedhojë certifikatat e lejimit në shërbim nuk miratohen;
  3. Prodhimi është realizuar sipas kushteve të përshkruara në letrën e marrëveshjes dhe është kryer në mënyrë të kënaqshme;
  4. Inspektimet dhe testimet (përfshi edhe testimet në fluturim, nëse duhen) sipas pikave 21.A.130(b)(2) dhe/ose (b)(3), janë realizuar sipas kushteve të përshkruara në letër marrëveshje dhe janë kryer në mënyrë të kënaqshme;
  5. Inspektimet nga AAC të përshkruara ose përmendura në letër marrëveshje janë kryer dhe konsiderohen të pranueshme;
  6. Deklarata e pajtueshmërisë në përputhje me pikën 21.A.130, dhe informacioni i siguruar nga kjo deklaratë nuk pengon miratimin e saj; dhe
- c) Nuk ka arritur ndonjë datë përfundimi të letër marrëveshjes.

#### **21.B.140 Ndryshimi i një letër marrëveshjeje**

- a) AAC duhet të investigojë, kur është e nevojshme, në përputhje me pikën 21.B.120, çdo ndryshim në letër marrëveshje.
- b) Kur AAC bindet se kërkesat e seksionit A, nënpjesa F, vazhdojnë të jenë në pajtueshmëri me të, ai ndryshon letër marrëveshjen sipas rrethanave.

#### **21.B.145 Kufizimi, pezullimi dhe revokimi i letër marrëveshjes**

a) Kufizimi, pezullimi ose revokimi i letër marrëveshjes i komunikohet me shkrim zotëruesit të letër marrëveshjes. AAC cilëson arsyet për kufizimin, pezullimin apo revokimin dhe informon zotëruesin e letër marrëveshjes

mbi të drejtën e tij për të apeluar.

b) Kur një letër marrëveshje pezullohet, ajo rivendoset vetëm pasi të jetë rivendosur përputhja me seksionin A, nënpjesa F.

#### **21.B.150 Mbajtja e të dhënave**

a) AAC vendos një sistem për ruajtjen e të dhënave, i cili lejon ndjekje të përshtatshme të procesit të lëshimit, ndryshimit, pezullimit ose revokimit të çdo letër marrëveshjeje të veçantë.

b) Të dhënat duhet të përmbajnë më së paku:

1. Dokumentet e siguruar nga aplikanti për letër marrëveshje ose zotëruesi i letër marrëveshjes,
2. Dokumentet e përcaktuara gjatë investigimit dhe inspektimit, në të cilat cilësohen aktivitetet dhe rezultatet përfundimtare të elementëve të përcaktuar në pikën 21.B.120,
3. Letër marrëveshjen, duke përfshirë edhe ndryshimet, dhe
4. Minutat e takimit me prodhuesin.

c) Dokumentet arkivohen për një periudhë minimale prej gjashtë vitesh pas përfundimit të letër marrëveshjes.

d) Gjithashtu AAC ruan të dhënat për të gjithë deklaratat e pajtueshmërisë (forma 52 e Republikës së Shqipërisë, sipas EASA-s, shih shtojcën VIII) dhe certifikatat e autorizuara të lejimit në shërbim (forma 1, e Republikës së Shqipërisë, sipas EASA-s shih shtojcën I) që ka miratuar.

#### **NËNPJESA G - MIRATIMI I ORGANIZATËS PRODHUESE**

##### **21.B.220 Investigimi**

a) AAC cakton një ekip të miratimit të organizatës prodhuese për secilin aplikant ose mbajtës të miratimit të organizatës prodhuese për të kryer të gjitha detyrat përkatëse që lidhen me këtë miratim të organizatës prodhuese, që përbëhet nga një udhëheqës i ekipit për të menaxhuar dhe udhëhequr ekipin e miratimit dhe, nëse kërkohet, një ose më shumë anëtarë të ekipit. Udhëheqësi i ekipit i raporton menaxherit përgjegjës për veprimtarinë e përcaktuar në pikën 21.B.25 (b)(2).

b) AAC kryen aktivitete të mjaftueshme investigimi për një aplikant ose zotërues të një miratimi të organizatës prodhuese për të justifikuar rekomandimet për lëshimin, mirëmbajtjen, ndryshimin, pezullimin ose revokimin e një miratimi.

c) AAC përgatit procedura për hetimin e miratimit të një organizate prodhimi si pjesë e procedurave të dokumentuara që mbulojnë të paktën elementët e mëposhtëm:

1. Vlerësimin e aplikimeve të marra;
2. Përcaktimin e ekipit të miratimit të organizatës prodhuese;
3. Përgatitjen dhe planifikimin e investigimit;
4. Vlerësimin e dokumentacionit (prezantimin e organizatës së prodhimit, procedurat, etj.);
5. Auditimin;
6. Ndjekjen e veprimeve korrigjuese;
7. Rekomandimin për lëshimin, ndryshimin, pezullimin ose revokimin e miratimit të organizatës së prodhimit.
8. Mbikëqyrjen e vazhdueshme.

#### **21.B.225 Gjetjet**

a) Kur gjatë auditëve ose me anë të mjeteve të tjera, nga AAC gjendet evidencë objektive që tregon mos pajtueshmëri të zotëruesit të miratimit të organizatës prodhuese me kërkesat e zbatueshme në seksionin A, kjo gjetje klasifikohet sipas pikës 21 A.158(a).

b) AAC ndërmer veprimet e mëposhtme:

1. Për gjetjet e nivelit 1, nga AAC ndërmerret veprim i menjëhershëm për të kufizuar, pezulluar apo revokuar miratimin e organizatës prodhuese tërësisht ose pjesërisht në varësi të shtrirjes së gjetjes, deri sa nga organizata të jenë përfunduar veprimet korrigjuese me sukses;

2. Për gjetjet e nivelit 2, AAC jep një periudhë për veprimet korrigjuese sipas natyrës së gjetjes që nuk duhet të jetë më shumë se 3 muaj. Në rrethana të caktuara, në fund të kësaj periudhe dhe në varësi të natyrës së gjetjes, AAC mund të zgjasë periudhën 3-mujore, në varësi të një plani të kënaqshëm korrektues të veprimit të ofruar nga organizata.

c) AAC ndërmer veprime që të pezullojë miratimin në tërësi ose pjesërisht, në rast të dështimit të mos përmbushjes së afatit kohor të dhënë nga ky organ.

#### **21.B.230 Lëshimi i certifikatës**

a) Kur bindet se organizata prodhuese ka përmbushur kërkesat e zbatueshme të seksionit A nën pjesa G, autoriteti kompetent i lëshon pa vonesa miratimin e organizatës prodhuese (forma 55 e Republikës së Shqipërisë sipas EASA-s, shih shtojcën X).

b) Në formën 55 të Republikës së Shqipërisë, sipas EASA-s, përfshihet numri i referencës, në mënyrën e përcaktuar nga autoriteti kompetent.

#### **21.B.235 Mbikëqyrja e vazhdueshme**

a) Për të justifikuar mirëmbajtjen e miratimit të

organizatës prodhuese, AAC kryen mbikëqyrje të vazhdueshme:

1. Për të verifikuar se sistemi i cilësisë së zotëruesit të miratimit të organizatës prodhuese është në përputhje me seksionin A nën pjesën G;

2. Për të verifikuar se zotëruesi i miratimit të organizatës prodhuese operon në përputhje me manualin e organizatës prodhuese;

3. Për të verifikuar efektivitetin e procedurave të manualit të organizatës prodhuese; dhe

4. Për të monitoruar sipas mostrave standardet e produktit, pjesëve apo pajisjeve.

b) Mbikëqyrja e vazhdueshme duhet të realizohet në përputhje me pikën 21.B.220.

c) AAC siguron përmes mbikëqyrjes së vazhdueshme të planifikuar, se miratimi i organizatës prodhuese është shqyrtuar plotësisht për pajtueshmëri me këtë aneks I (pjesa 21) gjatë një periudhe prej 24 muajsh. Mbikëqyrja e vazhdueshme mund të përbëhet prej disa aktiviteteve të investigues gjatë kësaj periudhe. Numri i auditëve mund të variojë në varësi të kompleksitetit të organizatës, numrit të vendndodhjeve dhe gjendjes kritike të prodhimit. Si minimum, zotëruesi i miratimit të organizatës prodhuese i nënshtrohet mbikëqyrjes së vazhdueshme nga AAC së paku 1 herë në vit.

#### **21.B.240 Ndryshimi i miratimit të organizatës prodhuese**

a) Autoriteti kompetent monitoron çdo ndryshim të vogël përmes aktiviteteve të mbikëqyrjes së vazhdueshme.

b) Autoriteti kompetent heton sipas rastit në përputhje me pikën 21.B.220 çdo ndryshim të rëndësishëm të miratimit të organizatës prodhuese ose aplikimit nga mbajtësi i një miratimi të organizatës prodhuese për një ndryshim të fushëveprimit dhe kushteve të miratimit.

c) Kur autoriteti kompetent bindet se kërkesat e Seksionit A, nën pjesën G vazhdojnë të jenë në përputhje me të, ai ndryshon respektivisht miratimin e organizatës prodhuese.

#### **21.B.245 Pezullimi dhe revokimi i miratimit të organizatës prodhuese**

a) Në rastin e gjetjeve të nivelit një ose të nivelit dy, autoriteti kompetent kufizon plotësisht ose pjesërisht, pezullon ose revokon miratimin e organizatës prodhuese si në vijim:

1. Në rastin e një gjetjeje të nivelit një, miratimi i organizatës prodhuese kufizohet ose pezullohet menjëherë. Nëse zotëruesi i miratimit të organizatës prodhuese nuk arrin të jetë në pajtueshmëri me pikën 21.A.158(c)(1), miratimi i organizatës prodhuese duhet të revokohet.

2. Në rastin e një gjetjeje të nivelit dy, autoriteti kompetent vendos për ndonjë kufizim të fushëveprimit të miratimit duke pezulluar përkohësisht miratimin e organizatës prodhuese ose pjesëve të saj. Nëse zotëruesi i miratimit të organizatës prodhuese nuk arrin të jetë në pajtueshmëri me pikën 21.A.158(c)(2), miratimi i organizatës prodhuese do të revokohet.

b) Kufizimi, pezullimi ose revokimi i miratimit të organizatës prodhuese i komunikohet zotëruesit të miratimit të organizatës prodhuese në formë të shkruar. Autoriteti Kompetent cilëson arsyet për pezullimin ose revokimin dhe informon mbajtësin e miratimit të organizatës prodhuese mbi të drejtën e tij për apelim.

c) Kur një miratim i organizatës prodhuese pezullohet ai rivendoset vetëm nëse janë përmbushur kërkesat e seksionit A, nënpjesës G.

#### **21.B.260 Mbajtja e të dhënave**

a) Autoriteti kompetent vendos një sistem për ruajtjen e të dhënave, i cili lejon ndjekje të përshtatshme të procesit të lëshimit, ndryshimit, pezullimit ose revokimit të çdo miratimi të veçantë të organizatës prodhuese.

b) Të dhënat duhet të përmbajnë më së paku:

1. Dokumentet e siguruar nga aplikanti ose zotëruesi i miratimit të organizatës së prodhimit;

2. Dokumentet e përcaktuara gjatë investigimit, në të cilat cilësohen aktivitetet dhe rezultatet finale të elementeve të përcaktuar në pikën 21.B.220, duke përfshirë dhe gjetjet sipas pikës 21.B.225;

3. Programin e mbikëqyrjes së vazhdueshme, duke përfshirë të dhënat e investigimeve të kryera.

4. Certifikatën e miratimit të organizatës prodhuese, duke përfshirë dhe ndryshimet.

5. Minutat e takimit me zotëruesin e miratimit të organizatës prodhuese.

c) Të dhënat arkivohen për një periudhë prej të paktën 6 vitesh.

NËNPJESA H- CERTIFIKATAT E VLEFSHMËRISË AJRORE DHE CERTIFIKATAT E KUFIZUARA TË VLEFSHMËRISË AJRORE

#### **21.B.320 Investigimi**

a) Autoriteti kompetent kryen aktivitete të mjaftueshme investiguese për aplikantin ose zotëruesin e një certifikate vlefshmërie ajrore, për të justifikuar lëshimin, mirëmbajtjen, ndryshimin, pezullimin ose revokimin e certifikatës ose lejes.

b) Autoriteti kompetent përgatit procedurat e vlerësimit që mbulojnë së paku elementet e mëposhtëm:

1. Vlerësimin e përshtatshmërisë së aplikantit;

2. Vlerësimin e përshtatshmërisë së aplikimit;

3. Klasifikimin e certifikatave të vlefshmërisë ajrore;

4. Vlerësimin e dokumentacionit të marrë me aplikimin;

5. Inspektimin e avionit;

6. Përcaktimin e kushteve të nevojshme dhe kufizimeve për certifikatat e vlefshmërisë ajrore.

#### **21.B.325 Lëshimi i certifikatave të vlefshmërisë ajrore**

a) Autoriteti kompetent lëshon ose ndryshon një certifikatë vlefshmërie ajrore (forma 25 e Republikës së Shqipërisë sipas EASA-s, shih shtojcën VI), pa vonesa, kur është i bindur se janë plotësuar kërkesat e zbatueshme në pikën 21.B.326 dhe kërkesat e aplikueshme të seksionit A, nënpjesa H të këtij aneksi I.

b) Autoriteti kompetent lëshon ose ndryshon një certifikatë të kufizuar vlefshmërie ajrore (forma 24 e Republikës së Shqipërisë sipas EASA-s, shih shtojcën V), pa vonesa, kur është i bindur se janë plotësuar kërkesat e zbatueshme në pikën 21.B.326 dhe kërkesat e aplikueshme të seksionit A, nënpjesa H të këtij aneksi I.

c) Për avionët e rinj apo të përdorur që vijnë nga një vend tjetër, krahas certifikatës së vlefshmërisë ajrore sipas pikës (a) apo (b), autoriteti kompetent lëshon një certifikatë fillestare të rishikimit të vlefshmërisë ajrore (EASA forma 15a, shih shtojcën II).

#### **21.B.326 Certifikata e vlefshmërisë ajrore**

AAC lëshon një certifikatë të vlefshmërisë ajrore:

a) për avionët e rinj:

1. pas paraqitjes së dokumentacionit të kërkuar nga pika 21.A.174 pikën (b) (2);

2. kur AAC është bindur që avioni përputhet me një projekt të miratuar dhe është në një gjendje për operimin e sigurt. Kjo mund të përfshijë inspektimet nga AAC;

b) për avionët e përdorur:

1. pas paraqitjes së dokumentacionit të kërkuar nga pika 21.A.174 (b)(3) duke demonstruar se:

i) avioni përputhet me një projekt tip të miratuar nën një certifikatë tip dhe çdo certifikatë tipi plotësuese, ndryshim ose riparim të miratuar në pajtim me këtë aneks I (pjesa 21); dhe

ii) janë përmbushur direktivat e zbatueshme të vlefshmërisë ajrore; dhe

iii) avioni inspektohet në përputhje me dispozitat e zbatueshme të aneksit I (pjesa M) të urdhrit të ministrit nr. 110, datë 2.10.2012 “Për miratimin e rregulloreve mbi vlefshmërinë ajrore të produkteve, pajisjeve aeronautike dhe pjesëve të avionëve, si dhe miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra;

2. Kur AAC është bindur që avioni është në përputhje me një projekt të miratuar dhe është në një gjendje për operimin e sigurt. Kjo mund të përfshijë inspektimet nga AAC.

#### **21.B.327 Certifikata e kufizuar e vlefshmërisë ajrore**

a) AAC lëshon një certifikatë të kufizuar të vlefshmërisë ajrore për:

1. avionët e rinj:

i) pas paraqitjes së dokumentacionit të kërkuar nga pika 21.A.174(b)(2);

ii) kur AAC bindet që avioni përputhet me një projekt të miratuar nga AAC ose Agjencia, sipas një certifikate të tipit të kufizuar ose në përputhje me specifikimet e veçanta të vlefshmërisë ajrore, dhe është në gjendje për operim të sigurt. Kjo mund të përfshijë inspektimet nga AAC;

2. avionët e përdorur:

i) pas prezantimit të dokumentacionit që kërkohet nga pika 21.A.174(b)(3), duke demonstruar që:

A) avioni përputhet me një projekt të miratuar nga AAC/Agjencia sipas një certifikate të kufizuar të tipit ose në përputhje me specifikimet e veçanta të vlefshmërisë ajrore, dhe me çdo certifikatë të tipit plotësuese për ndryshime apo riparime të miratuara në pajtim me aneksin I (pjesa 21); dhe

B) janë përmbushur direktivat e zbatueshme të vlefshmërisë ajrore; dhe

C) avioni inspektohet në përputhje me dispozitat e

zbatueshme të aneksit I (pjesa M) të urdhrit të ministrit nr. 110, datë 2.10.2012 “Për miratimin e rregulloreve mbi vlefshmërinë ajrore të produkteve, pajisjeve aeronautike dhe pjesëve të avionëve, si dhe miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra”;

ii) Kur AAC bindet që avioni është në përputhje me projektin e miratuar dhe është në gjendje për operimin e sigurt. Kjo mund të përfshijë inspektimet nga AAC;

b) Për një avion që nuk është në përputhje me kërkesat bazë të përmendura në udhëzimin e ministrit nr. 3, datë 7.2.2011 për “Rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil” dhe i cili nuk plotëson kushtet për një certifikatë tipi të kufizuar, nëse është e nevojshme AAC/Agjencia, sipas nevojës, për të marrë parasysh devijimet nga këto kërkesa bazë:

1. Lëshon dhe kontrollon pajtueshmërinë me specifikimet e veçanta të vlefshmërisë ajrore duke garantuar sigurinë e përshtatshme në lidhje me përdorimin e synuar, dhe

2. Përcakton kufizimet për përdorimin e këtij avioni.

c) Kufizimet për përdorim shoqërohen me certifikata të kufizuara të vlefshmërisë ajrore, duke përfshirë kufizime të hapësirës ajrore, si të nevojshme për të marrë parasysh devijimet nga kërkesat bazë të përcaktuara në udhëzimin e ministrit nr. 3, datë 7.2.2011 për “Rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”.

#### **21.B.330 Pezullimi dhe revokimi i certifikatave të vlefshmërisë ajrore dhe certifikatave të vlefshmërisë ajrore të kufizuara**

a) Nëse sipas evidencave nuk është përmbushur ndonjë nga kushtet e përmendura në pikën 21.A.181(a), AAC pezullon ose revokon një certifikatë vlefshmërie ajrore.

b) Pas nxjerrjes së njoftimit për pezullimin dhe revokimin e certifikatës së vlefshmërisë ajrore ose certifikatës së kufizuar të vlefshmërisë ajrore AAC cilëson arsyet për pezullimin ose revokimin dhe informon zotëruesin e certifikatës mbi të drejtën për apelim.

#### **21.B.345 Ruajtja e të dhënave**

a) AAC vendos një sistem për ruajtjen e të dhënave që lejon ndjekjen e përshtatshme të procesit të lëshimit, ndryshimit, pezullimit ose

revokimit të çdo certifikate të veçantë të vlefshmërisë ajrore.

b) Të dhënat përmbajnë të paktën:

1. Dokumentet e dërguara nga aplikanti;
2. Dokumentet e përcaktuara gjatë investigimit, në të cilat cilësohen aktivitetet dhe rezultatet finale të elementeve të përcaktuara në pikën 21.B.320(b); dhe
3. Një kopje të certifikatës ose lejes, duke përfshirë dhe ndryshimet.

c) Të dhënat arkivohen për një periudhë prej të paktën 6 vitesh pas heqjes nga regjistri kombëtar.

**NËNPJESA I - CERTIFIKATAT E ZHURMËS**

#### **21.B.420 Investigimi**

a) AAC kryen aktivitete investiguese të mjaftueshme për një aplikant ose zotërues të certifikatës së zhurmës për të argumentuar lëshimin, ndryshimin, pezullimin ose revokimin e certifikatës.

b) AAC përgatit procedurat e vlerësimit, si pjesë e procedurave të dokumentuara që përfshijnë të paktën elementet në vijim:

1. Vlerësimin e pranueshmërisë;
2. Vlerësimin e dokumentacionit të marrë me aplikimin;
3. Inspektimin e avionëve.

#### **21.B.425 Lëshimi i certifikatave të zhurmës**

AAC, sipas rastit, lëshon ose ndryshon certifikatat e zhurmës (forma 45 e Republikës së Shqipërisë sipas EASA-s, shih shtojcën VII) pa vonesa, nëse është i bindur se janë plotësuar kërkesat e seksionit A nënpjesa I.

#### **21.B.430 Pezullimi dhe revokimi i certifikatës së zhurmës**

a) Nëse sipas evidencave nuk janë përmbushur disa prej kushteve të përcaktuara në pikën 21.A.211(a), AAC pezullon ose revokon certifikatën e zhurmës.

b) Pas nxjerrjes së njoftimit për pezullimin dhe revokimin e një certifikate të zhurmës, AAC tregon arsyet për pezullim ose revokim dhe informon mbajtësin e certifikatës mbi të drejtën për ankesë.

#### **21.B.445 Ruajtja e të dhënave**

a) AAC, vendos një sistem për ruajtjen e të dhënave me kritere minimale të mbajtjes, që lejon gjurmueshmërinë e përshtatshme të procesit për lëshimin, mirëmbajtjen, ndryshimin, pezullimin ose revokimin e çdo certifikate zhurme individuale.

b) Të dhënat përmbajnë si minimum:

1. Dokumentet e siguruar nga aplikanti;
2. Dokumentet e krijuara gjatë investigimit, në të cilat cilësohen aktivitetet dhe rezultatet finale të elementeve të përcaktuara në pikën 21.B.420(b) dhe;
3. Një kopje të certifikatës dhe lejes, duke përfshirë dhe ndryshimet.

c) Të dhënat arkivohen për një periudhë prej të paktën 6 vitesh pas daljes nga regjistri kombëtar.

**NËNPJESA J - MIRATIMI I ORGANIZATËS PRODHUESE**

Zbatohen procedurat administrative të përcaktuara nga EASA. AAC duhet të marrë masa për t'i bërë të zbatueshme në sistemin kombëtar këto procedura.

**NËNPJESA K - PJESËT DHE PAJISJET**

Zbatohen procedurat administrative të përcaktuara nga EASA. AAC duhet të marrë masa për t'i bërë të zbatueshme në sistemin kombëtar këto procedura.

(NËNPJESA L - NUK ËSHTË E ZBATUESHME)

**NËNPJESA M - RIPARIMET**

Aplikohen procedurat administrative të vendosura nga EASA. AAC duhet të marrë masa për t'i bërë të zbatueshme në sistemin kombëtar këto procedura.

(NËNPJESA N - NUK ËSHTË E ZBATUESHME)

**NËNPJESA O - AUTORIZIMET E URDRIT EVROPIAN TË STANDARDEVE TEKNIKE**

Aplikohen procedurat administrative të vendosura nga EASA. AAC duhet të marrë masa për t'i bërë të zbatueshme në sistemin kombëtar këto procedura.

(NËNPJESA P - LEJA PËR FLUTURIM)

#### **21.B.520 Investigimi**

a) AAC kryen veprimtari të mjaftueshme investiguese për të justifikuar lëshimin, apo revokimin e lejes për fluturim.

b) AAC përgatit procedurat e vlerësimit që mbulojnë të paktën elementet e mëposhtëm:

1. Vlerësimin e pranueshmërisë së aplikantit;
2. Vlerësimin e pranueshmërisë së aplikimit;
3. Vlerësimin e dokumentacionit të marrë me aplikimin;
4. Inspektimin e avionit;
5. Miratimin e kushteve të fluturimit në përputhje me pikën 21.A.710 (b).

### **21.B.525 Lëshimi i lejeve për fluturim**

AAC lëshon një leje për fluturim (forma 20a, e Republikës së Shqipërisë sipas EASA-s, shih shtojcën III) pa vonesë të panevojshme:

- a) me paraqitjen e të dhënave të kërkuara nga pika 21.A.707; dhe
- b) kur kushtet e fluturimit të referuara në pikën 21.A.708 janë miratuar në përputhje me pikën 21.A.710; dhe
- c) kur ky autoritet, përmes investigimeve të veta, të cilat mund të përfshijnë inspektimet, ose nëpërmjet procedurave të dakordësuara me aplikantin, bindet që avioni përputhet me projektin e përcaktuar sipas pikës 21.A.708 para fluturimit.

### **21.B.530 Revokimi i lejeve për fluturim**

- a) Kur ekziston një dëshmi se ndonjë nga kushtet e përcaktuara në pikën 21.A.723(a) nuk është plotësuar për një leje për fluturim të lëshuar nga ai, AAC revokon atë leje për fluturim.
- b) Pas nxjerrjes së njoftimit të revokimit të lejes për të fluturuar AAC deklaron arsyet për revokim dhe informon mbajtësin e lejes për fluturim për të drejtën për ankimim.

### **21.B.545 Mbajtja e dokumentacionit**

- a) AAC përdor një sistem të mbajtjes së dokumenteve që siguron gjurmueshmërinë e duhur të procesit për lëshimin dhe revokimin e çdo lejeje individuale për fluturim.
- b) Dokumentacioni përmban si minimum:
  1. Dokumentet e siguruar nga aplikanti;
  2. Dokumentet e krijuara gjatë investigimit, ku janë deklaruar aktivitetet dhe rezultatet përfundimtare të elementeve të përcaktuar në pikën 21.B.520 (b); dhe
  3. Një kopje të lejes për fluturim.
- c) Të dhënat mbahen për një minimum prej gjashtë vitesh, pasi leja pushon së qenuri e vlefshme.

### **NËNPJESA Q - IDENTIFIKIMI I PRODUKTEVE, PJESËVE DHE PAJISJEVE**

Aplikohen procedurat administrative të vendosura nga EASA. AAC duhet të marrë masa për t'i bërë të zbatueshme në sistemin kombëtar këto procedura.

#### **SHTOJCAT**

Format e Republikës së Shqipërisë sipas modeleve të EASA-s

*Format e këtij aneksi p'ërfshijnë dhe përkthimin në gjuhën angleze*

Format e cituara në shtojcat e kësaj pjese kanë tiparet e mëposhtme detyruese. Republika e Shqipërisë dhe shteti i ZPEA-së sipas përcaktimit të marrëveshjes shumëpalëshe garantojnë që formularët të cilët ata publikojnë janë të identifikueshëm, si dhe ata janë përgjegjës për printimin e këtyre formave.

Shtojca I - Forma 1 e RSH-së sipas EASA-s  
Certifikata e autorizuar e lejimit në shërbim

Shtojca II - Forma 15a e RSH-së sipas EASA-s  
Certifikata e rishikimit të vlefshmërisë ajrore

Shtojca III - Forma 20a e RSH-së sipas EASA-s  
Leja për fluturim

Shtojca IV - Forma 20b e RSH-së sipas EASA-s  
Leja për fluturim (lëshuar nga organizatat e miratuara)

Shtojca V - Forma 24 e RSH-së sipas EASA-s  
Certifikata e kufizuar e vlefshmërisë ajrore

Shtojca VI - Forma 25 e RSH-së sipas EASA-s  
Certifikata e vlefshmërisë ajrore

Shtojca VII - Forma 45 e RSH-së sipas EASA - s  
Certifikata e zhurmës

Shtojca VIII - Forma 52 e RSH-së sipas EASA- s  
Deklarata e pajtueshmërisë së avionit

Shtojca IX- Forma 53 e RSH-së sipas EASA-s  
Certifikata e lejimit në shërbim

Shtojca X - Forma 55 e RSH-së sipas EASA-s  
Certifikata e miratimit të organizatës prodhuese

Shtojca XI - Forma 65 e RSH-së sipas EASA-s  
Letër marrëveshja për prodhim pa miratim të organizatave prodhuese

Shtojca XII - Kategoritë e testeve të fluturimit dhe kualifikimi i ekuipazhit përkatës të testimit të fluturimit.

## SHTOJCA I

Certifikata e autorizuar e lejimit në shërbim — Forma 1 e RSH-së sipas EASA-s referuar në aneksin I (pjesa 21)

<b>1. Autoriteti Kompetent i Miratimit/Shqipëria</b> <b>Approving Competent Authority/Albania</b>		<b>2.CERTIFIKATË E AUTORIZUAR E LEJIMIT NË SHËRBIM</b> <b>AUTHORISED RELEASE CERTIFICATE</b> <b>EASA FORM 1</b>			<b>3. Numri i ndjekjes së Formës</b> <b>Form tracking Number</b>	
<b>4. Emri dhe Adresa e Organizatës: Organization Name and Address:</b>					<b>5.Urdhri i punës/Kontrata/Fatura Work</b> <b>Order/Contract/Invoice</b>	
<b>Artikulli</b> <b>Item</b>	<b>7. Përshkrimi</b> <b>Description</b>	<b>8.Nr. i Pjesës</b> <b>Part No.</b>	<b>9.Sasia</b> <b>Quantity</b>	<b>10.Nr. Serisë</b> <b>Serial No.</b>	<b>11.Statusi/puna</b> <b>Satus/Work</b>	
12.Vërejtje Remarks						
13a.Certifikon se artikujt e identifikuar më sipër ishin prodhuar në përputhje me: Certifies that items identified above were manufactured  in conformity to: <input type="checkbox"/> Të dhënat e miratuara të projektit dhe janë në kushte për operim të sigurt Approved design data and are in condition for safe operation <input type="checkbox"/> Të dhëna jo të miratuara të projektit të specifikuar në bllokun 12 Non-approved design data specified in block 12			14a. <input type="checkbox"/> Lejimi në shërbim sipas Pjesës 145.A.50 Part 145.A.50 Release to Service <input type="checkbox"/> Rregullore tjetër e specifikuar në bllokun 12 Other regulation specified in block 12  Vërteton se nëse nuk është specifikuar ndryshe në bllokun 12, puna e identifikuar në bllokun 11 dhe e përshkruar në bllokun 12 është kryer në përputhje me Pjesën 145 dhe në lidhje me atë punë artikujt konsiderohen të gatshëm për t'u lejuar në shërbim. Certifies that unless otherwise specified in block 12, the work identified in block 11 and described in block 12, was accomplished in accordance with Part 145 and in respect to that work the items are considered ready for release to service.			
13b. Firma e autorizuar Authorised Signature		13c. Miratimi/Numri i autorizimit Approval/Authorisation Number		14b.Firma e autorizuar Authorised Signature		14c. Certifikata/Nr. Referencës së miratimit Certificate/Approval ref. No.

13d.Emri Name	13e. Data (dd mmm vvv) Date (dd mmm yyy)	14d. Emri Name	14e. Data (dd mmm vvv) Date (dd mmm yyy)
<p><b>PËRGJEGJËSITË E PËRDORUESIT/INSTALUESIT</b></p> <p>Kjo Certificate nuk jep automatikisht autoritetin për të instaluar artikullin (artikujt).</p> <p>Kur përdoruesi/instaluesi kryen punë në pajtim me rregullat e një autoriteti të vlefshmërisë ajrore, ndryshe nga autoriteti i vlefshmërisë ajrore të përcaktuar në bllokun 1, është thelbësore që përdoruesi/instaluesi të sigurojë që autoriteti i tij i vlefshmërisë ajrore të pranojë artikujt nga autoriteti i vlefshmërisë ajrore të specifikuar në bllokun 1.</p> <p>Deklaratat në blloqet 13a dhe 14a nuk përbëjnë certifikimin e instalimit. Në të gjitha rastet të dhënat e mirëmbajtjes së avionëve duhet të përmbajnë një klasifikim të instalimit të lëshuar në pajtim me rregulloret kombëtare nga përdoruesi / instaluesi përpara se avioni të fluturojë.</p> <p>This Certificate does not automatically constitute authority to install the item(s).</p> <p>Where the user/installer performs work in accordance with regulations of an airworthiness authority different than the airworthiness authority specified in block 1, it is essential that the user/installer ensures that his/her airworthiness authority accepts items from the airworthiness authority specified in block 1.</p> <p>Statements in blocks 13a and 14a do not constitute installation certification. In all cases aircraft maintenance records must contain an installation classification issued in accordance with the national regulations by the user/installer before the aircraft may be flown.</p>			



Udhëzimet për përdorimin e formës 1 të Republikës së Shqipërisë, sipas EASA-s

‘Këto udhëzime kanë të bëjnë vetëm me përdorimin e formës 1 të RSH-së sipas EASA-s për qëllime prodhimi. Vëmendje i kushtohet shtojcës II të aneksit I (pjesa M) të urdhrimit të ministrit nr. 110, datë 2.10.2012 “Për miratimin e rregulloreve mbi vlefshmërinë ajrore të produkteve, pajisjeve aeronautike dhe pjesëve të avionëve, si dhe miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra”, që mbulon përdorimin e formës 1 të RSH-së sipas EASA-s për qëllime të mirëmbajtjes’.

## 1. QËLLIMI DHE PËRDORIMI

1.1 Qëllimi primar i certifikatës është të deklarojë vlefshmërinë ajrore të produkteve, pjesëve dhe pajisjeve të reja të aviacionit (“artikullit (artikujve)”).

1.2 Një lidhje e ndërsjellët duhet të vendoset midis certifikatës dhe artikullit (artikujve). Hartuesi duhet të mbajë një certifikatë në një formë që lejon verifikimin e të dhënave origjinale.

1.3 Certifikata është e pranueshme për shumë autoritete të vlefshmërisë ajrore, por mund të varet nga marrëveshjet dypalëshe dhe/ose politikat e vlefshmërisë ajrore të autoritetit.

1.4 Certifikata nuk është një dokument dërgese apo ngarkimi.

1.5 Avionët nuk lejohen në shërbim duke përdorur certifikatën.

1.6 Certifikata nuk përbën miratimin për të instaluar artikullin në një avion, motor ose helikë të veçantë, por ndihmon përdoruesin e fundit të përcaktojë statusin e miratimit të vlefshmërisë ajrore .

1.7 Në të njëjtën certifikatë nuk lejohet përzjerja e lejimit në shërbim të produktit dhe lejimit në shërbim të mirëmbajtjes.

1.8 Në të njëjtën certifikatë nuk lejohet një përzjerje e artikujve të certifikuar në përputhje me “të dhëna të miratuara” dhe “të dhëna jo të miratuara”.

## 2. FORMATI I PËRGJITHSHËM

2.1 Certifikata duhet të përputhet me formatin e bashkangjitur duke përfshirë numrat e bllokut dhe vendndodhjen e secilit bllok. Sidoqoftë, madhësia e secilit bllok mund të ndryshojë për t’iu përshtatur aplikimit individual, por jo në masën që do ta bënte certifikatën të panjohshme.

2.2 Certifikata duhet të jetë në formatin ‘peizazh’, por madhësia e përgjithshme mund të rritet ndjeshëm ose

zvogëlohet për aq kohë sa certifikata mbetet e njohur dhe e lexueshme. Nëse ka dyshime, duhet bërë konsultimi me AAC-në.

2.3 Deklarata e përgjegjësisë së përdoruesit/ instaluesit mund të vendoset në të dyja anët e formës.

2.4 Të gjitha printimet duhet të jenë të qarta dhe të lexueshme për të lejuar lexim të lehtë.

2.5 Certifikata mund të jetë e parashtypur ose e gjeneruar nga kompjuteri, por në secilin rast printimi i vijave dhe i shkronjave duhet të jetë i qartë dhe i lexueshëm dhe në përputhje me formatin e përcaktuar.

2.6 Certifikata duhet të jetë në gjuhën angleze, dhe nëse është e përshtatshme, dhe në gjuhën shqipe.

2.7 Detajet që futen në certifikatë mund të jenë të shkruara me makinë/kompjuter ose të shkruara me dorë duke përdorur shkronja kapitale dhe duhet të lejojnë lexim të lehtë.

2.8 Kufizoni përdorimin e shkurtimeve në minimum, për të ndihmuar qartësinë.

2.9 Hapësira e mbetur në anën e pasme të certifikatës mund të përdoret nga hartuesi për çdo informacion plotësues, por nuk duhet të përfshijë ndonjë deklaratë certifikimi. Çdo përdorim i anës së pasme të certifikatës duhet të referohet në bllokun e duhur në anën e përparme të certifikatës.

## 3. KOPJET

3.1 Nuk ka ndonjë kufizim në numrin e kopjeve të certifikatës që i dërgohet klientit ose mbahet nga hartuesi i saj.

## 4. GABIMET NË NJË CERTIFIKATË

4.1 Nëse një përdorues gjen një gabim në një certifikatë, ai duhet ta identifikojë atë me shkrim të hartuesi i saj. Hartuesi mund të lëshojë një certifikatë të re nëse ai mund të verifikojë dhe korrigjojë gabimin.

4.2 Certifikata e re duhet të ketë një numër të ri të ndjekjes, nënshkrimit dhe datës.

4.3 Kërkesa për një certifikatë të re mund të përmbushet pa bërë rivefikimin e kushtit të artikullit. Certifikata e re nuk është një deklaratë e gjendjes aktuale dhe duhet t’i referohet certifikatës së mëparshme në bllokun 12 me deklaratën e mëposhtme: “Kjo certifikatë korrigjon gabimin në bllokun [fut bllokun e korrigjuar] të certifikatës [shëno numrin origjinal të ndjekjes] të datës

[vendos datën origjinale të lëshimit] dhe nuk mbulon pajtueshmërinë/kushtet/lejimin në shërbim”. Të dy certifikatat duhet të mbahen në përputhje me periudhën e ruajtjes të shoqëruar me të parën.

## 5. PLOTËSIMI I CERTIFIKATËS NGA HARTUESI

Blloku 1	Autoriteti Kompetent i Miratimit/Shteti Shënoni emrin dhe vendin e autoritetit kompetent nën juridiksionin e të cilit lëshohet kjo certifikatë. Kur autoriteti kompetent është Agjencia, duhet të deklarohet vetëm ‘EASA’.
Blloku 2	Titulli i Formës 1 të RSH-së sipas EASA-s ‘CERTIFIKATË E AUTORIZUAR E LEJIMIT NË SHËRBIM FORMA 1 EASA’
Blloku 3	Numri i Ndjekjes së Formës Shkruani numrin unik të krijuar nga sistemi/procedura numerike e organizatës së identifikuar në bllokun 4; kjo mund të përfshijë karaktere alfa/numerikë.
Blloku 4	Emri dhe adresa e organizatës Shkruani emrin dhe adresën e plotë të organizatës prodhuese (referojuni formës 55 të RSH-së sipas EASA-s fleta A) që lejon artikullin në shërbim të mbuluar nga kjo certifikatë. Logot etj., të organizatës janë të lejuara nëse ato mund të përmbahen brenda bllokut.
Blloku 5	Urdhri i punës/kontrata/fatura Për të lehtësuar gjurmueshmërinë e artikullit, shkruani numrin e porosisë së punës, numrin e kontratës, numrin e faturës ose numrin e referencës së ngjashme.
Bloke 6	Artikulli Shkruani numrat e artikullit. Ky bllok lejon ndërlidhjen e lehtë me vërejtjet në bllokun 12.
Bloke 7	Përshkrimi Shkruani emrin ose përshkrimin e artikullit. Preferenca duhet t’i jepet termit të përdorur në udhëzimet për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore ose të dhënat e mirëmbajtjes (p.sh. Katalogu i Ilustruar i Pjesëve, Manuali i Mirëmbajtjes së Avionëve, Buletini i Shërbimit, Manuali i Mirëmbajtjes së Komponentëve).
Bloke 8	Numri i Pjesës Shkruani numrin e pjesës siç duket në artikull ose etiketë/paketim. Në rast të një motori ose helike mund të përdoret projekti i tipit.
Blloku 9	Sasia Shënoni sasinë e artikujve.
Blloku 10	Numri i serisë Nëse nga rregullorja kërkohet që artikulli të identifikohet me një numër serie, shkruani këtu numrin e serisë. Përveç kësaj, gjithashtu mund të shkruhet çdo numër tjetër serie që nuk kërkohet nga rregullorja. Nëse në artikull nuk ka të identifikuar numër serie, shkruani ‘N/A’.
Blloku 11	Statusi/puna Shkruani ose TROTOTIP’ ose ‘I RI’. Shkruani TROTOTIP’ për: i) prodhimin e një artikulli të ri në përputhje me të dhënat e projektit të pa miratuara; ii) ricertifikimin nga organizata e identifikuar në bllokun 4 të certifikatës së mëparshme pas punimeve të ndryshimit ose korigjimit në një artikull, para hyrjes në shërbim (p.sh. pas inkuorporimit të ndryshimit të një projekti, korigjimit të një defekti, inspektimi ose

testimi, ose rinovimi të afatit të ruajtjes.) Detajet e lejimit origjinal në shërbim dhe punimet e ndryshimit ose korigjimit duhet të futen në bllokun 12.

Shkruani 'I RI' për:

i) prodhimin e një artikulli të ri në përputhje me të dhënat e miratuara të projektimit;  
ii) ricertifikimin nga organizata e identifikuar në bllokun 4 të certifikatës së mëparshme pas punimeve të ndryshimit ose korigjimit në një artikull, para hyrjes në shërbim (p.sh. pas inkorporimit të ndryshimit të një projekti, korigjimit të një defekti, inspektimi ose testimi, ose rinovimi të afatit të ruajtjes). Detajet e lejimit origjinal në shërbim dhe punimet e ndryshimit ose korigjimit duhet të futen në bllokun 12.

iii) ricertifikimin nga prodhuesi i produktit ose organizata e identifikuar në bllokun 4 të certifikatës së mëparshme të artikujve nga 'prototipi' (konform vetëm me të dhënat e pa miratuara) në 'të reja' (konform me të dhënat e miratuara dhe në kushte për operim të sigurt), pas miratimit të të dhënave të projektimit të aplikueshme, me kusht që të dhënat e projektimit të mos ndryshojnë. Deklarata e mëposhtme duhet të futet në bllokun 12: 'RICERTIFIKIMI I ARTIKUJVE NGA 'PROTOTIP' NË 'I RI': KY DOKUMENT VËRTETON MIRATIMIN E TË DHËNAVE TË PROJEKTIT [SHKRUAJ NUMRIN E TC/STC, NIVELIN E RISHIKIMIT, DATË [SHKRUAJ DATËN NËSE ËSHTË E NEVOJSHME PËR IDENTIFIKIMIN E STATUSIT TË RISHIKIMIT], NË TË CILËN KY ARTIKULL (KËTO ARTIKUJ) ËSHTË (JANË) PRODHUAR.'

Kutia "të dhënat e miratuara të projektit dhe janë në gjendje për operim të sigurt" duhet të shënohet në bllokun 13a;

iv. ekzaminimin e një artikulli të ri të lejuar në shërbim përpara hyrjes në shërbim në përputhje me standardin e specifikuar ose specifikimet e klientit (detajet e të cilave dhe të lejimit origjinal në shërbim duhet të shkruhen në bllokun 12) ose për të vendosur vlefshmërinë ajrore (shpjegimi i bazës së lejimit në shërbim dhe detajet e lejimit origjinal në shërbim shkruhen në bllokun 12).

Blloku 12

Vërejtje

Përshkruani punën e identifikuar në bllokun 11, direkt ose duke iu referuar dokumentacionit mbështetës, të nevojshëm për përdoruesit ose instaluesin për të përcaktuar vlefshmërinë ajrore të artikullit (artikujve) në lidhje me punën që është certifikuar. Nëse është e nevojshme, mund të përdoret një fletë e veçantë dhe referencat nga forma 1 e RSH-së sipas EASA-s. Çdo deklaratë duhet të identifikojë qartë se cilit nga artikujt në bllokun 6 i referohet ajo. Nëse nuk ka asnjë deklaratë, shkruaj 'Asnjë'. Shkruani në bllokun 12 justifikimin për lejimin në shërbim për të dhënat e pa miratuara të projektit (p.sh. certifikatën e tipit në pritje, vetëm për testim, në pritje të të dhënave të miratuara).

Nëse të dhënat janë printuar nga një Formë elektronike 1, të dhënat që nuk janë të përshtatshme në blloqet e tjera duhet të futen në këtë bllok.

Blloku 13a

Shënoni vetëm një nga dy kutitë:

1. Shënoni kutinë e 'të dhënat e miratuara të projektit dhe janë në gjendje për operim të sigurt' nëse artikulli (artikujt) është (janë) prodhuar duke përdorur të dhëna të miratuara të projektit dhe janë gjetur në gjendje për operim të sigurt.

2. Shënoni kutinë e 'të dhënat e pa miratuara të projektit të specifikuar në kutinë e bllokut 12' nëse artikulli (artikujt) është (janë) prodhuar duke përdorur të dhëna të zbatueshme jo të miratuara të projektit. Identifikoni të dhënat në bllokun 12 (p.sh. certifikata e tipit në pritje, vetëm për testim, në pritje të të dhënave të miratuara). Përzierjet e artikujve të lejuar në shërbim kundrejt të dhënave të miratuara dhe jo të miratuara të projektit nuk lejohen në të njëjtën certifikatë.

Blloku 13b

Nënshkrimi

i

Autorizuar

Kjo hapësirë plotësohet me nënshkrimin e personit të autorizuar. Vetëm personat e autorizuar posaçërisht sipas rregullave dhe politikave të autoritetit kompetent, lejohen të nënshkruajnë këtë bllok. Për të ndihmuar njohjen, mund të shtohet një numër unik që identifikon personin e autorizuar.

Blloku 13c Numri i miratimit/autorizimit  
Shkruani numrin/referencën e miratimit/autorizimit. Ky numër ose referencë lëshohet nga autoriteti kompetent.

Blloku 13d Emri  
Shkruani emrin e personit që firmos në bllokun 13b në një formë të lexueshme.

Blloku 13e Data  
Shkruani datën në të cilën është firmosur blloku 13b, data duhet të jetë në formatin dd = dita me dy numra, mmm = 3 germat e para të muajit, yyyy = viti me 4 shifra.

Blloku 14a-14e Kërkesat e përgjithshme për blloqet 14a-14e:

Nuk përdoren për lejimin në shërbim të produktit. Errësojeni, shënojeni në mënyrë për të parandaluar përdorimin e paligjshëm ose të paautorizuar.

Përgjegjësitë e përdoruesit / instaluesit

Vendosni deklaratën e mëposhtme në certifikatë për të njoftuar përdoruesit e fundit që nuk janë çliruar nga përgjegjësitë e tyre në lidhje me instalimin dhe përdorimin e çdo artikulli të shoqëruar me formën:

‘KJO CERTIFIKATË NUK JEP AUTOMATIKISHT AUTORITETIN PËR INSTALIM.

